



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Botim jubilar me rastin e pesëvjetorit të botimit
të numrit të parë të revistës
«Policimi dhe siguria»
(2015-2020)

Nr. 20
TETOR
2020

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2019



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi dhe **SIGURIA**

Botim jubilar,
me rastin e pesëvjetorit të revistës “Policimi dhe siguria” (2015-2020)

B O T I M P E R I O D I K
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR **20**
TETOR
2020

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

“POLICIMI DHE SIGURIA”

Viti V i botimit

NR **20**
TETOR
2020

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Redaktor shkencor
Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike
Andi OSMANI

Realizimi teknik
*Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë*

Revista shkencore **“Policimi dhe siguria”**, botohet nga “Qendra Kërkimore Shkencore” e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P Ë R M B A J T J A

1. **Drejtues Madhor Ardi VELIU**
Revista «Policimi dhe siguria», një forum i denjë diskutimi 8
2. **Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ**
Botimet shkencore të AS-së, tregues i vizionit të policisë
për kërkimin shkencor 10
3. **Prof. Dr. Ismet ELEZI**
Disa mendime e propozime për revistën “Policimi dhe siguria” 12
4. **Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI**
Roli kërkimor-shkencor i revistës «Policimi dhe siguria» 18
5. **Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI**
Duke përshëndetur jubileun e revistës «Policimi dhe siguria» 24
6. **Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ**
Revista “Policimi dhe siguria” - inspiruese e rikonceptimit dhe
e ridimensionimit të sektorit të sigurisë publike 28
7. **Dr. Xhavit SHALA**
Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës
“Policimi dhe siguria” 32
8. **Dr. Albert HITOALIAJ**
Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë,
kontribut i genësishëm akademik në fushën e sigurisë 91
9. Bordet shkencore të konferencave kombëtare
dhe ndërkombëtare të organizuara nga Qendra e Kërkimeve
Shkencore, Akademia e Sigurisë, 2015-2020 106
10. **Dr. Albert HITOALIAJ**
Bibliografi e shkrimeve të botuara në revistën “Policimi dhe siguria”, gjatë
viteve 2015-2020 118
- Shtojcë dokumentesh 148**



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Revista «Policimi dhe siguria», një forum i denjë diskutimi



Drejtues Madhor Ardi VELIU
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Revista "Policimi dhe siguria" është një revistë e cila publikon kërkime e studime origjinale, artikuj konceptorë, botime konferencash etj. Duke qenë se ajo reflekton në mënyrë të vazhdueshme e të pandërprerë prej pesë vitesh, artikuj të vlefshëm për policinë dhe artikuj në lidhje me praktikën e mira dhe evoluimin e çështjeve të sigurisë publike, mund të thuhet se, revista jo vetëm e ka realizuar qëllimin e krijimit të saj, por hap pas hapi po ndërton një praktikë të qëndrueshme të kërkimit shkencor.

Jemi të gjithë dëshmitarë se ajo është përpjekur që të inkurajojë të gjithë kërkuesit e mundshëm, që mund të gjenden në radhët e policisë e më gjerë, për të publikuar shkrimet e tyre kërkimore. Janë kërkuar e publikuar artikuj me fokusin te hetimi, kiberkrimi, menaxhimi policor, parandalimi i krimit, policimi, kërcënimet për sigurinë e brendshme, kombëtare dhe deri te kërcënimet për sigurinë ndërkombëtare etj. Një pjesë e mirë e temave e kapërcejnë interesin dhe sferën e policimit dhe janë një kontribut për fushën e sigurisë që u vlen edhe institucioneve të tjera.

Revista ka qenë një forum i denjë diskutimi, në të cilin është përkrahur jo vetëm identifikimi i problematikave, por është synuar edhe sjellja e zgjidhjeve e rekomandimeve të ndryshme. Shembull i qartë për këtë, janë botimet e përfundimeve të konferencave,

krahas artikujve individualë. Këto përfundime kanë qenë sinteza të mendimit të përgjithshëm dhe të problematikave të ndryshme me fushën e sigurisë, të cilat janë paraqitur në konferencat e organizuara nga Qendra e Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë. Revista dhe bordi i saj editorial kanë ndjekur një praktikë shumë korrekte botimi. Pavarësisht se është lejuar që mendimi kritik të shfaqet si një e drejtë e autorëve dhe si një domosdoshmëri për kërkimin shkencor, nuk ka asnjë rast, që revista të ketë lejuar shkrime me orientime preferenciale politike, komente me natyrë politike apo të zhveshur nga elementi kërkimor. Ky mund të konsiderohet një prej elementeve më të mira dhe që duhet ruajtur në vazhdimësi.

Në këtë mënyrë, shihet se autorët kanë trajtuar me objektivitet tematika të cilat i kanë pasur familjare, të punës së tyre dhe që kanë qenë edhe të përfshirë. Nxjerrja e përfundimeve të paanshme në këto punime është padyshim një meritë e autorëve, por reflekton njëkohësisht edhe qëndrimin redaktorial të revistës "Policimi dhe siguria". Një tjetër detaj tjetër, që ka jo pak rëndësi, është edhe fakti se artikujt fokusohen në urën e komunikimit kërkues-praktikues. Synohet vazhdimisht, në një pjesë të madhe të punimeve, që të ketë zgjidhje e rekomandime të zbatueshme në praktikë. Duke ardhur në fund të kësaj përshëndetje të shkurtër me rastin e botimit të numrit të njëzetë të revistës "Policimi dhe siguria", uroj që të ruhet niveli i arritur i këtij botimi serioz dhe të mund të zgjerohet kapaciteti i zhvillimit të tematikave të vlefshme, për punën e policisë e të institucioneve të sigurisë në përgjithësi.

Veliu, A.

« Revista
"Policimi dhe
siguria", një
forum i denjë
diskutimi »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Botimet shkencore të AS-së, tregues i vizionit të policisë për kërkimin shkencor



Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ
REKTOR / DREJTOR I AKADEMISË SË SIGURISË

Pas një periudhe disavjeçare, në vitin 2015, Akademia e Sigurisë filloi botimin e një reviste shkencore, të titulluar “Policimi dhe Siguria” dhe tani kam kënaqësinë të shprehem me këto rreshta për një arritje të madhe të Akademisë dhe policisë shqiptare. Natyrisht, 5 vjet janë shumë pak për një revistë, por materialet e botuara në të janë një set dijesh për punonjësit e policisë dhe jo vetëm. Në këtë moment përsosjeje të revistës mund të shprehemi se ajo ka krijuar një profil të sajën, tashmë të qëndrueshëm të lexuesit e vet. Botimi në tërësi, sidomos botimet shkencore në veçanti, janë një sfidë për ata që angazhohen në këtë drejtim.

Të shkruash është sfidë për individin, por të botosh është sfidë për botuesin apo institucionin që e merr përsipër. Pavarësisht të gjitha vështirësive, mungesave apo mangësive që mund të ketë pasur botimi i revistës “Policimi dhe siguria”, mund të thuhet në mënyrë të sigurt, se sfida e Akademisë së Sigurisë, si institucioni botues i kësaj reviste, u përballua me sukses. Kjo revistë ka lënë një gjurmë serioze të punës sonë. Ajo dëshmon një përpjekje të dukshme për ndërtimin e një hapësire ku të diskutohet mendimi shkencor policor.

Policia si institucioni kryesor i sigurisë publike është vazhdimisht e sfiduar nga një sërë problematikash dhe dilema. Sfidat kërkojnë zgjidhje dhe vendosin përpara saj imperativet të cilët më shumë se veprim të menjëhershëm, kërkojnë njohje të thellë të problematikës së sigurisë së ndërlikuar publike, përmes analizave shumë disiplinore. Sidoqoftë, më shumë sesa vetëm të njohë nevojat e qytetarëve dhe t’u përgjigjet në mënyrë të njëshme, policia e ka për detyrë dhënien e përparësisë për zbatimin e

Memaj, B.
« Botimet shkencore të AS-së, tregues i vizionit të policisë për kërkimin shkencor »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

filozofisë së policimit në komunitet. Në thelb siguria publike nuk arrihet dhe nuk mund të jetë atribut vetëm i policisë, por i të gjithë komunitetit.

Mbi të gjitha, dhe në radhë të parë, nevojitet që të ketë një ndryshim filozofik, një zhvendosje filozofike dhe metodologjike, lidhur me mënyrën se si duhet të zhvillohet policimi në të ardhmen. Kjo nuk mund të arrihet pa përpunuar format e reja të policimit ku revista ka dhe do të ketë objektin e saj të punës.

Nga ana tjetër, duhet të ketë një filozofi se si mund të përdoren metodat kërkimore shkencore të orientuara, të policisë, nga komuniteti. Kjo do të krijonte një mënyrë të re për vlerësimin e përparimit dhe efektivitetit të punës së saj me qytetarët të cilëve policia u shërben. Kjo që po sjell në plan të dukshëm, është nevoja e një avancimi në drejtim të kërkimit shkencor në polici, me qëllim që shërbimi ndaj komunitetit, të ofrohet edhe në këtë mënyrë. Me anë të punimeve kërkimore, projekteve, studimeve, hulumtimeve të orientuara edhe drejt nevojave të komunitetit. Kërkimet do i shërbenin policisë në vetvete për qëllimet e saja kërkimore, por edhe shoqërisë në tërësi. Për këtë gjë nevojitet që të fuqizohet aspekti kërkimor në polici dhe të hidhen hapat të tjerë para, si dhe të fuqizohet bashkëpunimi me institucionet kërkimore të arsimit të lartë e jo vetëm.

Akademia e Sigurisë mund ta çojë akoma më tej këtë rrugë të kryer deri tani në drejtimin e kërkimit shkencor. Shembulli i revistës “Policimi dhe siguria” dhe i aktivitetit kërkimor të realizuar përmes Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ka rezultuar pozitiv. Botimi i njëzet numrave të revistës “Policimi dhe siguria” dhe realizimi i pesë konferencash ndërkombëtare dhe dy konferencash të spikatura kombëtare, janë tregues real i punës së kryer.

Tashmë, duke qenë se është krijuar një traditë e kësaj natyre, duhet synuar që revista “Policimi dhe siguria” të ngrihen në një nivel edhe më të avancuar. Revista mund të shndërrohet në një forum diskutimi shkencor për çështje me rëndësi dhe nga ekspertë të njohur të fushës së sigurisë. Gjithashtu, akademja mund të trajtojë, përmes kërkimit shkencor, çështje të cilat kanë një interes të spikatur për komunitetin që lidhen me sigurinë dhe jo vetëm.


Kam qenë mbështetës i hershëm i zgjerimit të botimeve periodike shkencore në gjuhë të huaj dhe i ambicies që kemi pasur si institucion për realizimin e një reviste rajonale, ndërkombëtare, shkencore që të trajtojë sfidat të shumta të sigurisë publike. Janë projekte që do të realizohen në të ardhmen, por është e sigurt që ne duhet t’i japim më shumë hapësirë analizave në gjuhë të huaj, pasi edhe nevoja për informacion dhe shkëmbim mendimi mes ekspertësh ndërkombëtarë, sa vjen e rritet.

Kalimi në këtë nivel, pra te kërkimet shkencore për interesa të komunitetit, nga policia, do të forconte pozitën e policisë si një institucion i cili investon vetveten në çdo mënyrë, me qëllim përmirësimin e sigurisë publike. Eksperienca e revistës “Policimi dhe siguria” dhe e botimeve të punimeve të konferencave shkencore të realizuara nga AS-ja, ka hedhur hapin e parë në këtë drejtim. Mjafton të përmendim këtu se tema të tilla si: siguria kibernetike, siguria mjedisore, vetëvrasja, arsimimi në fushën e sigurisë, terrorizmi, narkotrafiku, drejtësia etj., prekin gjithë shoqërinë. Pra qasja që është bërë përmes punimeve shkencore të revistës “Policimi dhe siguria” është një qasje e cila duhet të zgjerohet në të ardhmen, me qëllim që policia të ketë një rol më të gjerë në kërkimin shkencor. Nëse ka diçka për të cilën duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të kënaqur që ka ndodhur, është pikërisht shembulli që ka dhënë revista “Policimi dhe Siguria”, e cila dashur padashur, sjell shembullin më të mirë se si mund të kalojmë nga policimi në komunitet te kërkimi shkencor policor për interesa të komunitetit me qëllim final të transformojmë policinë në një polici moderne dhe të pëlqyer nga qytetarët.

Memaj, B.
« Botimet shkencore të AS-së, tregues i vizionit të policisë për kërkimin shkencor »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Disa mendime e propozime për revistën “Policimi dhe siguria”



Prof. Dr. Ismet ELEZI*

Anëtar i bordit editorial të revistës “Policimi dhe siguria”

Botimi i revistës “Policimi dhe siguria” ka rëndësi të madhe shkencore e praktike jo vetëm për policinë, por edhe për përhapjen e kulturës juridike, profesionale e të profilit të caktuar, në të gjithë nivelet e shtetit të së drejtës që po ndërtojmë. Revista “Policimi dhe siguria” nderon Akademinë e Sigurisë, si një institucion shkencor, rrit prestigjin dhe autoritetin e saj dhe shërben si model për Akademinë e Shkencave dhe fakultetet e Drejtësisë në drejtimin dhe organizimin e konferencave shkencore me nivel të lartë, që përbëjnë burimin kryesor të revistës “Policimi dhe siguria”. Duke analizuar artikujt e botuar në disa revista (numrat 15-19) mendoj të parashtroj mendimet e mia për karakteristikat kryesore.

Karakteristika e parë kryesore e kësaj reviste është se ruan e mbron mendimin shkencor e profesional të saj, pa u ndikuar e komanduar nga kultura politike partiake, e trashëguar nga e kaluara, dhe që vazhdon në forma e mënyra të ndryshme të veprorë.

Karakteristikë tjetër kryesore është se në qendër të përmbytjes së saj është vënë siguria kombëtare (ashtu siç thuhet dhe në titullin e saj), duke i dhënë përparësi luftimit

Elezi, I.

« Disa mendime e propozime për revistën “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

* Kryetari i komiteteve shkencore, të së gjitha konferencave kombëtare e ndërkombëtare, të zhvilluara nga Akademia e Sigurisë në periudhën 2015-2020.

të kriminalitetit dhe parandalimit të tij, bazuar në orientimet e Këshillit të Evropës. Ky orientim konkretizohet në tematikën e përzgjedhur, duke i dhënë përparësi luftimit të terrorizmit, si dhe kundër krimit të organizuar e korrupsionit, që përbëjnë objektivin kryesor të reformës në drejtësi. Në këtë kuadër janë botuar artikuj kundër pastrimit të parave, kanabisit etj., që përbëjnë probleme shqetësuese për shtetin në tërësi dhe policinë në veçanti. Me vlera të mëdha për këtë qëllim janë artikujt: “Siguria dhe antiterrorizmi – sfida emergjente”; “Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit”. Në kuadër të reformës në drejtësi është botuar artikulli: “Policia gjyqësore të bëhet pjesë e reformës në drejtësi; reforma dhe lufta kundër korrupsionit, garanci e funksionimit të shtetit të së drejtës”.

Karakteristikë kryesore e kësaj reviste është se artikujt e botuar janë kryesisht referatat shkencore të mbajtura në konferencat shkencore ndërkombëtare, të drejtuara e të organizuara nga bordi i editorial i revistës, kryesuar nga dr. Xhavit Shala dhe nga bordet e konferencave.

Funksionimi i rregullt e me cilësi i bordit, ka siguruar pjesëmarrje të kualifikuar në këto konferenca, që kanë zhvilluar referate shkencore me cilësi të lartë, të cilat janë përzgjedhur dhe botuar në revistë. Kjo metodologji e ndjekur nga Akademia e Sigurisë dhe bordi i saj editorial, është origjinale dhe ka pasur sukses nga pikëpamja teoriko-shkencore dhe profesionale.

Karakteristikë kryesore dalluese e konferencave shkencore dhe e artikujve të botuar nga referatat që mbahen në të, është pjesëmarrja e ndërkombëtarëve dhe sidomos e shkencëtarëve të njohur të Kosovës, të cilët me referatat e tyre sjellin risi në shkencën shqiptare. Këtu mjafton të përmendim artikujt e botuar në revistë nga Blerim Krasniqi dhe Blerim Olluri, me tema të reja: shkenca e forenzikës në shtetin e ri të Kosovës, e cila luan rol të pazëvendësueshëm në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore (kompiuterit, celularit etj.) për zbulimin e fajtorëve dhe arritjen e rezultateve pozitive në mbledhjen e provave bindëse për fajësinë e të akuzuarve.

Me këto shkrime hapen horizonte të reja në shkencën shqiptare dhe ata janë kontribut i rëndësishëm në modernizimin e veprimtarisë zbuluese të policisë shqiptare. Këtu meriton të theksohet se vetë pjesëmarrja e ekspertëve ndërkombëtarë në konferencat shkencore dhe botimi i referateve të kualifikuara të tyre është arritje e madhe pozitive në zhvillimin e mendimit teoriko-profesionale të policisë shqiptare.

Karakteristikë tjetër dalluese e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe e referateve të botuara të tyre shërben drejtpërdrejt në përmirësimin e përsosjes e metodave që përdoren nga policia shqiptare kundër kriminalitetit edhe për krimet e tjera. Kështu p.sh. një numër i posaçëm i revistës i është kushtuar artikujve për veprat penale në sigurinë rrugore dhe parandalimin e tyre. Në këto artikuj analizohen tërë aspektet e nevojshme të veprimtarisë së policisë rrugore e deri te vetë shtetasit.

Temë aktuale që lidhet me policinë janë edhe dhuna në familje, vrasjet e plagosjet midis anëtarëve të familjes, që janë bërë problem aktual shqetësues, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Së fundi, karakteristika e përgjithshme që del nga analiza e përmbajtjes së artikujve të botuar në revistën “Policimi dhe siguria” është se ata bazohen në parimet kushtetuese dhe në ligjet në fuqi si dhe rekomandimet që bëhen janë me karakter progresiv e ligjor. Qëllimi im kryesor është paraqitja e vlerave teoriko-shkencore dhe profesionale të artikujve të botuar në revistë, pa hyrë në analizën kritike të tyre.

Megjithatë, pa e cenuar përmbajtjen e revistës në tërësi, dëshiroj të shfaq një mendim

Elezi, I.

« Disa mendime e propozime për revistën “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

dhe dëshirë, se në tërë artikujt mungon analiza statistikore e kriminalitetit, nuk përdoren statistikat e tij: as të policisë, as të prokurorisë dhe as të gjykatës. Mirëpo kjo mangësi serioze dëmton nivelin shkencor të botimeve. Jam i mendimit dhe propozoj që të vihen në plan të parë statistikat dhe analiza kriminologjike e kriminalitetit, mbi bazën e të cilave të trajtohen problemet dhe nxirren konkluzionet. Kjo kërkesë është universale dhe jo imja personale.

Disa propozime për tematikën e ardhshme të revistës “Policimi dhe siguria”

Duke qenë se policia është e pandarë nga sistemi i drejtësisë penale, lind nevoja që krahas problemeve të tjera, në revistën “Policimi dhe siguria” të zënë vend kryesor edhe tema që kanë lidhje me reformën në drejtësi, bazën juridike të saj (“Kodin e procedurës penale” të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017), “Kodin penal” të ndryshuar deri në vitin 2020, “Kushtetutën” e ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, ligjin nr. 97/2016 “Për prokurorinë”, ligjin nr. 84/2016 “Për vettingun” etj.

Tematika që do përzgjidhet për botim, të ketë si qëllim kryesor sqarimin e këtyre ligjeve për t’i zbatuar në praktikë nga institucionet përkatëse, ku një rol të veçantë ka edhe policia gjyqësore, duke vënë si objektiv kryesor atë që është përcaktuar në ligjin e vettingut - SPAK-, luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit në organet e drejtësisë dhe të policisë, si dhe në tërë institucionet qendrore e vendore të shtetit.

Revista “Policimi dhe siguria” ka si mision të trajtojë gjerësisht edhe reformën në polici, duke u përqendruar në problemet më të rëndësishme që paraqiten sot dhe në të ardhmen. Me shumë kujdes meritojnë të trajtohen institucionet e reja që u krijuan nga reforma në drejtësi: SPAK, BKH, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjykata e Posaçme, si dhe reformimi i institucioneve ekzistuese; Formimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm (reduktimi i kompetencave të tij), organizimi dhe funksionimi i gjykatave, organizimi dhe funksionimi i policisë gjyqësore (ligj nr. 25/2019).

Në plan të parë tematika e revistës “Policimi dhe siguria” t’i kushtohet bazës juridike të reformës në drejtësi e posaçërisht “Kodit të procedurës penale”, të ndryshuar, i cili ka rëndësi të dorës së parë për përgatitjen profesionale të policisë gjyqësore dhe të policisë në përgjithësi, e që kanë për detyrë zbatimin në praktikë të parimit të ligjshmërisë, në procesin hetimor, për grumbullimin e provave, cilësimet e sakta juridike të veprave penale.

Kuptohet se studimi e publikimi i shkrimeve për “Kodin e procedurës penale” janë të pandara nga studimi dhe njohja e kodit penal, sepse këta janë të lidhur organikisht me njëri tjetrin e nuk mund të konceptohet kodi i procedurës penale i ndarë nga kodi penal, ku përcaktohen parimet kryesore të ligjshmërisë, të fajësisë, të përgjegjësisë penale, të elementëve përbërës të veprës penale, të dënimit penal.

Që këtë del nevoja e luftimit të vazhdueshëm të temave nga kodi i procedurës penale dhe kodi penal, për luftimin e kriminalitetit në tërësi e të krimit të organizuar dhe korrupsionit në veçanti në sistemin e drejtësisë, në polici, në tërë administratën publike dhe në organet e pushtetit qendror e vendor.

Është e domosdoshme dhe shumë e dobishme që në revistë të zërë një vend të veçantë shkencë e kriminologjisë, duke trajtuar tema të veçanta aktuale. Kështu p.sh. në “Kodin penal” bëhen ndryshime të shpeshta, të improvizuara, siç janë ato për qarkullimin e automjeteve etj., pa bërë analiza kriminologjike të këtij lloji kriminaliteti,

pa iu referuar gjendjes së tij (mbi bazën e statistikave gjyqësore), shkaqet dhe kushtet që e favorizojnë, analizës së personave që i kryejnë këto vepra penale. Nga analiza kriminologjike e krimeve në grup ose të veçanta, tani që do përgatitet “Kodi penal” i ri, mund të bëhen propozime e ndryshime në mënyrë që kodi të jetë sa më i plotë dhe efektiv.

Veç këtyre tematikave, në kohën e sotme ka dalë në plan të parë edhe lënda e politikës penale (politika e luftimit të kriminalitetit dhe parandalimit të tij). Në fakultetet e drejtësisë ka disa vite që kjo lëndë është përfshirë në planin mësimor dhe janë në qarkullim tekstet përkatëse. Revista “Policimi dhe siguria” mund, e duhet, të shfrytëzojë në maksimum tematika të larmishme nga kjo lëndë, e sidomos të përqendrohet në parandalimin e kriminalitetit, si kryefjala e shtetit të së drejtës që duam të ndërtojmë.

Për fat të keq në mentalitetin e zyrtarëve të shtetit vazhdojnë të mbeten konceptet e trashëguara nga e kaluara dhe preferohen *sanksionet penale* në vend që të vihet në plan të parë *parandalimi i kriminalitetit*. Shembull pozitiv të koncepteve të drejta dhe të zbatimit në praktikë të koncepteve të parandalimit shërben mjekësia që në çdo rast i jep përparësi parandalimit të sëmundjeve.

Mjafton të merret si shembull pozitiv rasti i koronavirusit, kundër të cilit u morën masa parandaluese me kohë, për të frenuar përhapjen e tij dhe arritur rezultate pozitive. Në udhëzimin e Këshillit të Evropës, thuhet shprehimisht se: “Në luftimin e kriminalitetit kryesorja është parandalimi i tij”. Ky orientim shërben si udhëheqës për veprim dhe në tematikën e artikujve të revistës. Revista meriton t’i kushtojë përparësi trajtimit të kësaj tematike për kriminalitetin në tërësi dhe për krime në veçanti, përfshirë krimin e organizuar, pa u kushtëzuar nga organizimi i konferencave shkencore.

Tema të veçanta në revistë mund të jenë pjesë nga *penalogjia* dhe *viktimologjia*, si shkenca të reja, për të cilat janë botuar edhe libra e jepen si lëndë në kurse të posaçme në Fakultetin e Drejtësisë.

Të gjitha këto, të marra veç e veç dhe së bashku, forcojnë kulturën juridike profesionale dhe të profilit të caktuar për policinë, sipas sektorëve të veçantë ku punohet. Kultura juridike profesionale dhe ajo e profilit të caktuar, janë të domosdoshme e të nevojshme, jo vetëm për gjyqtarët e prokurorët, për policinë, por për të gjithë funksionarët e shtetit, të niveleve të ulëta e të larta, se pa kulturë juridike të standardeve evropiane nuk mund të pretendojmë të jemi anëtarë të Bashkimit Evropian. Filozofi Aristotel ka thënë: “Njeriu i kulturuar ndryshon nga ai i pakulturuari, si i gjalli nga i vdekuri”.

Në revistë mund të ketë vend edhe për tema mbi rolin e kulturës juridike dhe të edukimit ligjor publik, që përmban reforma në drejtësi.

Në përfundim propozohet:

1. Botimi i revistës të mos kushtëzohet nga konferencat shkencore, sepse organizimi dhe zhvillimi i tyre është tepër i vështirë dhe kërkon kohë të gjatë, por të orientohet edhe në botimin me artikuj të kërkuar ose të paraqitur nga studiues të ndryshëm, për probleme të veçanta. Kjo metodë do të rrisë numrin e botimeve të revistës dhe do të përfshijë një gamë të gjerë temash, mjafton të jenë me cilësi, në nivel shkencor e profesional.

2. Propozoj që në të ardhmen konferencat shkencore të Akademisë së Sigurisë të organizohen e të drejtohen në bashkëpunim të ngushtë me Kosovën, ku niveli i shkencave është shumë i lartë dhe ka ekspertë të kualifikuar në fusha të ndryshme të

Elezi, I.

« Disa mendime e propozime për revistën “Policimi dhe siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

shkencës. Veç referateve që ata mund të paraqesin në konferenca, mund të kërkohen artikuj të veçantë, pa pritur konferencat e radhës, të cilat zhvillohen p.sh. një herë në vit. Bashkëpunimi me shkencëtarët e Kosovës dhe me policinë e saj, kanë rëndësi jetike jo vetëm për zhvillimin e shkencës dhe rritjen e nivelit profesional, por edhe për kombin shqiptar.

3. Të zgjerohet e azhurnohet tematika e revistës “Policimi dhe siguria”, duke pasur parasysh objektivat strategjikë të reformës në drejtësi dhe të reformës në polici.

4. Në tematikë t’i jepet përparësi problemeve kryesore që dalin nga praktika lidhur me zbatimin e “Kodit të procedurës penale” e të “Kodit penal” si dhe të ligjeve të tjera të posaçme.

5. T’i kushtohet vëmendjen e veçantë temave për kriminologjinë dhe kriminalistikën, nisur nga problemet e mprehta aktuale të kriminalitetit.

6. Meritojnë të bëhen objekt shkrimesh edhe politika penale e viktimologjia.

7. Ligjet pas reformës në drejtësi kanë vlera të shumta dhe sipas nevojës, mund të jenë objekt shkrimesh nga autorë kompetentë.

Elezi, I.

« Disa
mendime
e propozime
për revistën
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020



Elezi, I.

« Disa mendime
e propozime
për revistën
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Roli kërkimor-shkencor i revistës «Policimi dhe siguria»



Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Anëtar i bordit editorial të revistës “Policimi dhe siguria”
Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike,
Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Revista “Policimi dhe siguria”, është një revistë shkencore e Akademisë së Sigurisë, në të cilën kam nderin të jam anëtar i bordit botues të saj, që prej numrit të katërt të botimit. Tashmë, revista ka arritur në numrin e saj të 20-të dhe jam tejte i lumtur që kam arritur të jap kontributin tim në vazhdimësinë e saj. Punimet shkencore që janë prezantuar në këtë revistë prej fillit e deri tani, janë të një niveli shumë të lartë shkencor dhe mjaft të dobishme për sektorin e sigurisë në Shqipëri, Kosovë, por edhe më gjerë, duke përfshirë edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Punimet e kësaj reviste, të ofruara nga hulumtues shkencorë si dhe specialistë të ndryshëm të fushës së sigurisë, janë burim i besueshëm shkencor, pikë reference për ekspertë të sigurisë të niveleve më të larta, për politikat rajonale dhe globale që zhvillohen në kuadër të Evropës Juglindore.

Duke qenë anëtar i bordit botues të kësaj reviste, kam lexuar me interes dhe kërkshëri të shtuar punimet e dërguara nga autorë të ndryshëm, që në një mënyrë apo tjetër janë pjesëtarë të sektorit të sigurisë dhe përballen çdo ditë me problemet reale. Shtjellimi i këtyre problematikave me të cilat përballen, i bëjnë këta autorë që me një kujdes të shtuar të grumbullojnë literaturën e duhur shkencore, të analizojnë bazën ligjore të vendit që marrin si model të punimit të tyre, duke rekomanduar ndryshime ligjore dhe

Gashi, B.
« Roli
kërkimor-
shkencor
i revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

ndryshimin e politikave shtetërore në arritjen e rezultateve të duhura në dobi të shoqërisë të cilës i përkasin.

Sjellja e përvojave personale gjatë punës së tyre, shtjellimi i problematikave të vështira dhe të rëndësishme për funksionimin e sistemit të sigurisë, dhe përballja e tyre me fenomenet e ndryshme gjatë punës dhe vëzhgimi deri në detaje i këtyre fenomeneve, i japin vlerë dhe i bëjnë shumë të rëndësishme këto punime. Shtjellimi i fenomeneve të caktuara për numra të caktuar të revistës, ka bërë që të kemi punime shkencore shumë cilësore, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në sektorin e sigurisë. Përgjatë këtyre pesë viteve, janë trajtuar tema të rëndësishme, prandaj e shoh të udhës të përmend ato më të rëndësishmet:

1. Ballkani Perëndimor – kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike dhe sfidat e përballjes me to

Punimet shkencore të ofruara nga: Bilbil Memaj, Snezana Mojsoska dhe Nikola Dujovaski, Frank Harris, Sandër Lleshi, Bejtush Gashi, Ruzhdi Kuçi, Mareglen Kasmi dhe Kristaq Xharo, Pandeli Taçi, Qetësor Gurra dhe Jonida Gurra, Xhavit Shala dhe Eros Shala, Riza Shillova, Irvin Faniko, Anisa Agastra, Elerta Shanaj, Agron Rukiqi, Ajdin Mroja, Nebi Halili, Myzafer Elezi, i dhanë një tjetër kuptim këtij fenomeni rajonal.

Duke na ofruar një këndvështrim personal të fenomenit të gërshetuar me problematikat nga vendet e tyre, autorët kanë arritur të na japin një larmi të kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë publike për rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke na ofruar një referencë të mirë për të ditur nga t'i qasemi dhe si të jemi të përgatitur për t'u ballafaquar dhe për t'u përballur me këto sfida. Vendosja në plan të parë e arsimimit dhe nxjerrjes së specialistëve të shkolluar në sektorin e sigurisë, zbërthimi i koncepteve të sektorit të sigurisë, problemi i trafikimit ndërkombëtar - duke ofruar në punimet e tyre shtjellimin e rasteve konkrete, rëndësia e programeve të duhura arsimore dhe ngritja e kapaciteteve policore, etj., janë tema me interes të veçantë dhe që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në reformimin e sektorit të sigurisë në të gjithë rajonin tonë.

2. Shtjellimi i fenomenit të vetëvrasjes, trajtimet analitike dhe politikat vendimmarrëse në këtë drejtim

Punimet shkencore të cilat u publikuan nga autorët: Nazira Artykova dhe Gazmend Bejtja, Alban Ylli, Merita Poni, Zihni Sula, Anisa Agastra, Stavri Sinjari, Bledar Xhemali dhe Zija Ismaili, Ilirjan Mandoro dhe Ajdin Mbroja, Bilbil Mema, ishin mjaft frytdhënëse në trajtimin e këtij fenomeni. Shtjellimi i çrregullimeve të shëndetit mendor dhe roli që luajnë këto çrregullime në fenomenin e vetëvrasjeve, sjellja e shifrave apo e trajtimit të këtij fenomeni në mbarë Evropën apo në ambientin shqiptar, i dhanë një vlerë të shtuar trajtimit të këtij fenomeni. Zbërthimi i mjaft faktorëve që ndikojnë në shtimin e numrit të vetëvrasjeve dhe paraqitja e këtij fenomeni si një sfida për të ardhmen, i dhanë një ngjyrim pozitiv trajtimit të këtij fenomeni.

3. Impakti i shkencave të forenzikës në sektorin e sigurisë publike.

Është interesante të thuhet se në këtë temë kemi pasur një trajtim të gjerë nga shumë autorë, ku mund të përmendim: Snazana Mojoska dhe Nikolin Dujovski, Xhavit Shala, Admir Sinamati dhe Bardhyl Çipi, Valbona Muça, Eglantina Dervishi dhe Elizabeta Kafia, Luan Veliqoti, Ilirjan Mandro, Xhemajl Ademaj dhe Blerim Olluri, Milazim Tahirukaj, Vladimir Ikonimi dhe Viktor Hajdari, etj. Larmia e temave të shtjelluara

Gashi, B.
« Roli kërkimor-shkencor i revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

nga këta autorë është mjaft kontribuuese në sistemin e sigurisë publike dhe jep një kontribut të drejtpërdrejtë në këtë drejtim. Shtjellimi shkencor i forenzikës dhe gërshtimi i saj me sistemin ligjor të shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipërisë, Kosovës e shteteve tjera), i bën mjaft të dobishme këto punime.

4. Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Trajtimi i këtij fenomeni nga autorët dhe profesionistët shumë të njohur të fushës së sigurisë, është për t'u përshëndetur. Mund të përmendim këtu autorët: Xhavit Shala, Besnik Muçi, Sajmir Vishaj, Bilbil Dervishi, Andja Levanaku, Ervind Çobaj, Merita Poni, Dorina Arapi, Anisa Agastra, Qetësor Gurra, Besnik Shehaj, Anisa Hysenaj dhe Skënder Kalemi; Irvin Faniko dhe Shpëtim Karakushi etj. Një nga fenomenet më problematike që po merr përmasa shqetësuese gjithnjë e më shumë, është dhuna në familje, duke shtuar këtu edhe rritjen e saj të vazhdueshme edhe nëpër botë (sidomos tani gjatë kohës së pandemisë COVID-19 flitet për shifra alarmante nëpër gjithë botën). Gjithsesi, mund të themi se në Ballkanin Perëndimor, duke e personifikuar në niveli lokal (Shqipëri dhe Kosovë), ky fenomen është mjaft shqetësues. Temat e zgjedhura nga këta autorë, prekin vetë fenomenin, por tregojnë edhe se si rregullohet ai me legjislacion, ku duhet të kemi ndryshim të këtij të fundit dhe si mund të veprohet për parandalimin e tyre.

5. Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare

Një nga fenomenet më shqetësuese në të gjithë botën, është rreziku i krijuar nga kërcënimi kibernetik që mund t'i bëhet individit, por sidomos sistemeve të sigurisë kombëtare të shteteve. Shumica e njerëzve kanë njohuri mbi sigurinë kibernetike, mirëpo shumë pak prej tyre dinë se si të reagojnë përballë tyre. Kërcënimet kibernetike vënë në rrezik jo vetëm institucionet publike, organizatat dhe korporatat, por edhe përdoruesit e zakonshëm të internetit. Përfshirja e studiuesve të tillë si: Chelsey Slack, Tanel Sepp, Emilio Coppa, Daniela Cono D'Elia, Camil Demetrescu, Alberto Maruhotti Spaccamela dhe Paolo Prinetto, Marco Saracchi, por edhe i autorëve tanë, si: Xhavit Shala, Vilma Tomoço dhe Klorenta Pashaj, Bajram Ibraj, Mimoza Xharo, Flora Dako, Hergis Jica e të tjerë, i japin një tjetër vlerë të shtuar kësaj reviste. Shtjellimi i mbrojtjes së NATO-s nga krimi kibernetik, i shteteve të tilla, si: Estonia, Shqipëria apo edhe të tërë sistemit mbrojtjes kibernetikë në Ballkanin Perëndimor, e bëjnë të veçantë rëndësinë e revistës dhe vënë në pah kontributin e saj për rajonin, e veçanërisht për vendet tona.

Estonia është shembulli më i mirë që duhet ndjekur nga Kosova dhe Shqipëria. Por, si hyri Estonia te "peshat e rënda" të sigurisë kibernetike? Në 2007-ën pas një përplasje me Rusinë për një monument ushtari sovjetik, Estonia u vendos në qendër të sulme kibernetike dhe kjo njihet ndryshe edhe si lufta e parë kibernetike. Këto sulme arritën pikën kulmore kur 58 faqe interneti estoneze ranë, përfshirë faqet qeveritare, gazetat dhe bankat. Përpara incidentit, sulmet kibernetike nuk konsideroheshin kërcënim për shtetin. Konkretisht nuk shihej si sulm dhe nuk dihej se me çfarë mënyrash një shtet duhej të kundërpërgjigjej. Por, Estonia mësoi dhe fitoi eksperiencë dhe 10 vite më pas është një prej vendeve me sistemet më të sofistikuar të sigurisë kibernetike. Vendi nënshkroi marrëveshje me Austrinë, Luksemburgun, Korenë e Jugut dhe NATO-n për të realizuar trajnimet në këtë fushë. Në dhjetor të 2016-ës NATO-ja organizoi stërvitjen më të madhe të sigurisë kibernetike në Estoni, ku 700 mbrojtës kibernetikë, ekspertë

ligjorë, zyrtarë qeveritarë, oficerë ushtarakë, akademikë dhe përfaqësues të industrisë morën pjesë. Por si u bë Estonia e tillë?

Sipas shefit të CERT-EE, përgatitja e Estonisë për t'u ballafaquar me sulme të tilla është rritur dekadën e fundit. Vendi ka krijuar sistem për gjurmimin e ndërhyrjeve dhe sisteme mbrojtjeje, e ka shndërruar në praktikë bashkëpunimin mes institucioneve private dhe publike, si dhe ka rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve. Siguria kibernetike e Estonisë është rritur falë një infrastrukture tejte funksionale të e-qeverisë (qeverisjes elektronike), një sistemi digjital të qëndrueshëm të identitetit, kërkesë bazë sigurie kjo, për të gjitha institucionet qeveritare si dhe, një sistem qendror për monitorimin e raportimin e incidenteve.

Çdo muaj Estonia regjistron 300 incidente sigurie. Në fokus të trajnimit të ekspertëve të sigurisë është mbrojtja e sistemit kombëtar të IT-së. Organizuar që nga 2010-ta, nga CCD COE, në Talin, kryhet stërvitja më e madhe dhe më komplekse e sigurisë kibernetike. Në 2017-ën morën pjesë 900 pjesëmarrës nga 25 shtete të cilët kishin për detyrë të mbronin sistemet e një bazë ushtarake dhe të përballeshin me një skenar sulmi ndaj sistemit elektrik, sistemit të kontrollit, komandës ushtarake dhe infrastrukturave të tjera operationale.

Estonia është një prej vendeve që investon më së shumti në rritjen e ndërgjegjësimit dhe kompetencës së qytetarëve rreth sigurisë kibernetike dhe këtë e bën në mënyrë sistematike. Me rritjen e sulmeve kibernetike të motivuara politikisht, e kanë bërë sigurinë kibernetike më të rëndësishme se kurrë më parë për sistemin privat dhe atë publik.

6. Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare

Në këto kohë është bërë domosdoshmëri mbrojtja e ambientit, siguria mjedisore që sigurisht lidhet me sigurinë kombëtare. Shtjellimi i këtij fenomeni, nëpërmjet temave të ndryshme nga autorë të tillë, si: Xhavit Shala, Adrian Nessel, Artur Beu dhe Ariana Nepravishta, Dhurata Milori, Gjon Vorfi, Silvana Jaka, Anisa Hysesani, Tonin Prendi, Albert Hitoaliaj, Petrit Imeraj, Qetësor Gurra dhe Jonida Gurra, i japin rëndësi të veçantë revistës sonë. Tema të tilla që lidhen me trajtimin e krimeve mjedisore zhvillohen edhe në formën e trajnimeve të vazhdueshme e të specializuara, si: rëndësia e mbrojtjes juridiko-penale të mjedisit, kuptimi i veprave penale kundër mjedisit dhe figura e përgjithshme e tyre, llojet e veprave penale kundër mjedisit, veprimet e punonjësit të policisë në rastet e konstatimit të veprave penale kundër mjedisit dhe ndërtimeve pa leje, veçoritë e hetimit të veprave penale që cenojnë regjimin juridik të tokës etj. Gjithashtu, edhe trajtimi i mbrojtjes mjedisore sipas legjislacionit kombëtar dhe përshtatja e atij legjislacioni me standardet e Bashkimit Evropian, ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë kombëtare. Duke parë rëndësinë dhe kontributin e madh që po jep revista "Policimi dhe siguria", me publikimet e saj, mendojmë që edhe në të ardhmen duhet të vazhdojë me tematika që kanë të bëjnë me sfidat tradicionale të sigurisë. Duke u fokusuar kryesisht në:

- *sigurinë njerëzore*: kryesisht në këndvështrimin e sigurisë ekonomike, sociale, shëndetësore, varfërisë, niveli arsimor e kulturor, përgatitjes dhe aftësimit tekniko-profesional, sigurisë në punë, etj.;

- *rreziqet hibride* dhe sfidat e institucioneve të sigurisë në përbalimin e tyre;

- *lufta kibernetike*, e cila është trajtuar edhe më parë: mund të shikohet problemi profesional në goditjet e hakerëve në sistemin energjik dhe ekonomik;

Gashi, B.
« Roli kërkimor-shkencor i revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

- *terrorizmi tradicional*, si dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore për rehabilitimin e pjesëmarrësve që kanë qenë në strukturat e ndryshme të grupeve terroriste;

- *siguria e regjimit* dhe problematikat e *legjitimitetit* të pushtetit politik;

- siguria dhe kujdesi nga *sëmundjet infektive* dhe *pandemitë*;

- masat dhe siguria ndaj *fatkeqësive natyrore* (tërmeti, përmbytjet, rrëshqitjet, etj.);

- *ndryshimi i klimës*, problematikat dhe kujdesi për ndotjen e ambientit dhe ngrohjen globale në territorin tonë;

- *një gjeneratë e re* duhet përgatitur në strukturat e sigurisë kombëtare, që t'i përgjigjen një "rendi të ri" Ballkanik, duke u ballafaquar me qasjet realiste, liberale, konstruktive, etj., në marrëdhëniet midis shteteve dhe kulturave tona.

Si përfundim, shpreh edhe njëherë konsideratën time për cilësinë e punimeve të botuara në revistën shkencore "Policimi dhe siguria", në të 20-të numrat e saj, dhe për arritjen e qëllimeve për të cilat është themeluar kjo revistë.

Gashi, B.

« Roli

kërkimor-

shkencor

i revistës

"Policimi dhe

siguria" »

Policimi

dhe

Siguria

nr.20, 2020



Gashi, B.

« Roli kërkimor-
shkencor
i revistës
“Policimi
dhe siguria” »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

Duke përshëndetur jubileun e revistës «Policimi dhe siguria»



Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Anëtar i bordit editorial të revistës “Policimi dhe siguria”
Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë

Dinamika e botës sot, moderniteti, nën vrullin galopant të globalizmit për nevojat dhe urinë e zhvillimit, progresit dhe prosperitetit, ka kërkuar me etje, dhe gjetur, fusha, fenomene, dukuri dhe instrumente të reja e të panjohura më parë që do t'i shërbenin këtij qëllimi. Kibernetika, nanoteknologjia, bioteknologjia, mekanika kuantike, nanomaterialet e shumë gjetje të tjera janë tanimë realitetet e përditshmërisë humane, të botës në të cilën jetojmë. Dhe siç mund të ndodhë, si një ligjësi e brendshme e zhvillimeve shoqërore, të gjitha këto arritje janë shoqëruar nga një numër dukurish dhe fenomenesh të cilat kërcënojnë dhe sfidojnë rrugën e progresit të shoqërive moderne.

Krimi kibernetik, kërcënimet e ekosistemeve (ngrohja globale), trafiqet e lëndëve narkotike, psikotrope dhe të qenieve njerëzore, legalizimi dhe transferimi i aseteve kriminale, nxitja, mbështetja dhe financimi i ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit me baza nacionale, religjioze, ideologjike, racore etj., ku më shumë e ku më pak, janë dhe do të jenë të pranishme kudo; edhe në terrenin shqiptar.

Lufta për parandalimin dhe zbulimin e autorëve dhe grupeve kriminale të shtrira në

Koçollari, I.
«Duke
përshëndetur
jubileun e
revistës
“Policimi dhe
siguria”»

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

këto lëmë, nuk mund të bëhet me diletantizëm dhe diletantë. Ajo kërkon kulturë dhe dije të thella shkencore, profesionale dhe mobilizim të mendimit dhe fuqisë intelektuale. Për këtë qëllim, institucionet e specializuara në luftë kundër krimit, me kohë, kanë ftuar kërkimin shkencor që të gjejë rrugë dhe t'u japë zgjidhje një numri çështjesh graviteti, për të trajtuar sfidat e mëdha të kësaj përballjeje. Pa mëdyshjen më të vogël, kërkimi shkencor, puna kërkimore, është instrumenti më i rëndësishëm, është mendimi më i arrirë profesional, është shuma e eksperiencave teorike dhe praktike që mund të gjejë zgjidhje dhe ofrojë alternative për t'ju përgjigjur sfidave, fenomeneve kriminale apo dukurive kriminale, globale apo rajonale, kolektive apo individuale me gjetje, me mënyra, mjete dhe metodologji të reja, rentabël, me produkte dhe ide që zgjidhin kërkesat dhe dilemat me të cilat përballen shoqëritë e kohëve tona.

Duke ndjekur me kujdes punën e bërë nga Akademia e Sigurisë, duke iu referuar pesëvjeçarit të parë të botimeve të suksesshme të periodikut "Policimi dhe siguria", do të thosha se ky produkt ndoshta është një nga prurjet më serioze dhe më të rëndësishme të mendimit shkencor që ka elaboruar institucioni i Ministrisë së Rendit.

Tematikat që ajo ka ofruar dhe trajtuar, pa mëdyshjen më të vogël, janë subjektet që shoqërojnë dhe shqetësojnë shoqërinë e sotme shqiptare; shkrime dhe studime me format serioz shkencor, sikundër: "Krimi financiar", "Pastrimi i parave", "Asetet kriminale dhe strategjia kundër e luftës këtij produkti potencialisht të rrezikshëm", "Sfidat e një bote në ndryshim - konceptet e reja të sigurisë nacionale", "Krimi i vrasjes", "Gjakmarrrja", "Krimi apo dhuna në familje", "Krimi kibernetik" etj.

Unë mendoj se ky lloj produkti i "prodhuar" nga ky institucion është një lloj prurje që asnjë strukturë tjetër nuk mund t'i ofrojë politikbërësve dhe institucioneve që hartojnë politikat shtetërore, për një rend kushtetues dhe siguri, është një lloj "brumi" i veçantë për "shëndetin" dhe "ushqimin" e një shoqërie të sigurt dhe, garanci për gjeneratat që vijnë.

Sigurisht, ky periodik dinjitoz që e ka marrë rrugën e tij të mbarë, mbart kontributin e drejtuesve të akademisë, të stafit të Qendrës së Kërkimeve Shkencore dhe të bordit të revistës.

Duke i parë në tërësi arritjet dhe nivelet shkencore të punës tuaj, do të më lejoni të shpreh dy mendime për punën e kërkimit shkencor dhe për periodikun shkencor të profilizuar, "Policimi dhe siguria", lidhur me të ardhmen.

- Mendoj se ka ardhur koha, apo jeni tamam në kohë, për të ballafaquar mendimin tuaj mjaft të pjekur shkencor në fushën e policimit dhe të sigurisë, me institucionet simotra në rajon, Ballkan, e pse jo edhe Evropë, në një apo disa konferenca shkencore të përbashkëta. Merreni Ju iniciativën dhe bëhuni promotori i një apo disa konferencave të tilla.

- Merrni iniciativën dhe tërhiqni në konferenca shkencore, institute apo qendra kërkimore-shkencore jashtë apo brenda vendit, me të cilat mund të bashkëbisedoni, të dëgjoni dhe të këmbeni mendimin e profilizuar për fusha me interes specifik për ju, sikundër: Akademinë e Shkencave, fakultetet e drejtësisë në Tiranë, Shkodër, Korçë, Vlorë, etj.

- Ftoni personalitete të njohura të fushës së studimit të krimit, kriminologë, kriminalistë, psikologë, ekspertë të analizës dhe prognozës, profesionistë të luftës kundër terrorit, personalitete të fushës së policimit, etj.

- Nxiteni dhe mbështeteni edhe më tej studimin dhe kërkimin shkencor tek njerëzit e thjeshtë, në strukturat e bazës, dhe gjeni rrugët që periodiku juaj, të studiohet masivisht

Koçollari, L.
« Duke
përsëndetur
jubileun e
revistës
"Policimi dhe
siguria" »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

si nevojë për aftësim profesional e shkencor, për ta. Kjo do të rrisë cilësisht performancën e profesionistëve në terren dhe bashkë me të, rezultatet e punës së tyre.

Përballja me mendimet dhe teoritë alternative i vendos institucionet në sinkron të lëvizjes dhe të rezultatit. Ju kini shumë ç't'u tregoni strukturave simotra, sikundër kemi edhe ne ç'të marrim prej tyre.

Edhe një herë, uroj sinqerisht punë të mbarë, suksese dhe rrugë të mbarë në punën Tuaj kërkimore shkencore, me periodikun aq simpatik dhe me vlera, "Policimi dhe siguria", të cilin ju e ofroni për mendimin teorik dhe praktik të luftës kundër krimit, për sigurinë publike dhe për rendin kushtetues!

Koçollari, I.
« Duke
përsëritur
jubileun e
revistës
"Policimi dhe
siguria" »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020



Koçollari, L.
« Duke
përhëndetur
jubileun e
revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

Revista “Policimi dhe siguria” - inspiruese e rikonceptimit dhe e ridimensionimit të sektorit të sigurisë publike



Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ*

Anëtar i bordit editorial të revistës “Policimi dhe siguria”

Botimi shkencor periodik “Policimi dhe siguria”, në pesëvjetorin e publikimit të numrit të parë të tij, meriton, dhe ka të drejtën e pamohueshme, për të qenë krenar për rrugëtimin që ka bërë dhe rezultatet e arritura në këto pesë vite. Mirënjohje dhe vlerësim i thellë i takon në radhë të parë stafit shkencor të Qendrës së Kërkimeve Shkencore, drejtuesve të Akademisë së Sigurisë dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të kësaj reviste, të cilët ideuan dhe mundësuan botimin e saj, e transformuan atë në një platformë profesionale duke shpalosur mendimin e tyre përparimtar dhe reformatör për çështje me interes të lartë publik e kombëtar.

Përmbajtja e artikujve të botuar në këtë medium, pasqyrimi i aktiviteteve të shumta shkencore dhe rezultateve të tyre, tematikat e trajtuara dhe thellësia mendimit shkencor, paanësia dhe objektiviteti i trajtesave, e kanë bërë revistën “Policimi dhe siguria” një faktor të rëndësishëm edukimi dhe një opinionbërës përparimtar për komunitetin policor

Drejtor i Strategjive dhe politikave të rendit e të sigurisë publike në Ministrinë e Brendshme dhe, bashkëpunëtor i rëndësishëm i revistës “Policimi dhe siguria”

Haxhijaj, I.
« Revista
“Policimi
dhe siguria” -
inspiruese e ri-
konceptimit dhe
e ridimensionimit
të sektorit
të sigurisë
publike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.20, 2020

e më gjerë, në fushën e sigurisë. Ekspertët dhe specialistët kanë gjetur në këtë, organ tribunën për të shprehur mendimin dhe idetë e tyre, analistët dhe kërkuesit shkencorë kanë arritur të publikojnë gjetjet dhe rekomandimet e munguara, dhe drejtuesit e niveleve të ndryshme, kanë paraqitur e shpalosur platforma e vizione për të ardhmen e institucioneve e strukturave që ata drejtojnë.

Në kuadër të politikëbërjes sektoriale dhe në interes të marrjes së vendimeve sa më të drejta, Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë, shpeshherë kanë gjetur çelësin e duhur dhe përgjigjet e kërkuara, duke angazhuar pikërisht institucionet akademike, qendrën kërkimore dhe publikimet e saja, për të çuar përpara procese e reforma me rëndësi. Një ndër epërsitë dhe aftësitë e mediumit “Policimi dhe siguria” është pikërisht trajtimi i çështjeve të sigurisë publike në mënyrë gjithnjë e më gjithëpërfshirëse, aftësia për të dalë nga modelet tradicionale – dhe nganjëherë të papërshtatshme për kohën, njohja dhe prezantimi i hershëm i modeleve Perëndimore dhe vlerësimi i mundësisë së aplikimit të tyre në vendin tonë.

Në një mjedis dinamik sigurie, ku ndryshimi është i vetmi normalitet i ditëve tona, zgjidhjet dhe opsionet vendimmarrëse për ekspertët e sigurisë dhe për leadershipin janë të kufizuara dhe jo aq të shumta. Në këtë kuadër, duke vlerësuar dhe besuar se mendimi akademik dhe rezultatet e kërkimit shkencor, ashtu si në të gjitha vendet e civilizuar Perëndimore, do të jenë një nga faktorët dhe aktorët e rëndësishëm në bërjen e politikave të zhvillimit institucional, roli dhe rëndësia e kësaj reviste do të konsolidohen gjithnjë e më shumë, duke e kthyer atë në një institucion me influencë.

Sfidat e ardhshme me të cilat përballet sektori i sigurisë publike, ndryshimet e mëdha në spektrin e rrezeve e kërcënimeve në këtë sektor, redimensionimi i disa rrezeve të reja në krahasim me ato tradicionale, mundësitë teknologjike dhe shfrytëzimi i tyre nga elementët kriminalë, burimet e kufizuara kombëtare dhe konkurrenca për përdorimin e tyre në sektorët publik më jetësor, përbëjnë kërkesa të reja për të gjithë komunitetin e sigurisë, ekspertët e kësaj fushe por në veçanti për leadershipin politik e profesional.

Sa më lart, rritja e rolit të kësaj reviste shihet si e lidhur ngushtë me mjedisin ku jetojmë, pjesë e pandarë e proceseve transformuese, por edhe si një element përbërës i një panorame më të plotë institucionale. Akademia e Sigurisë është e angazhuar tashmë në një proces binjakëzimi me institucione simotra Perëndimore, nga i cili do të transformohet, me synim rritjen e kapaciteteve të saja për të përmbushur në mënyrë më të plotë përgjegjësitë dhe misionin e saj. Nga ana tjetër, në kushtet e vendit tonë, me mundësi të kufizuara financiare e njerëzore, por edhe për arsye të një efektiviteti dhe përdorimi racional të këtyre burimeve, qeveria shqiptare ka planifikuar që t'i besojë Akademisë së Sigurisë, përgatitjen dhe trajnimin e punonjësve edhe për institucionet e tjera të sigurisë, të cilat janë po aq të rëndësishme e me ndikim në garantimin e sigurisë publike.

Strukturat dhe organizimet “evropiane” të dala nga procesi i binjakëzimit në akademi, balancimi i pritshëm dhe i domosdoshëm i peshës mes komponentëve të edukimit, trajnimit, doktrinės e kërkimit shkencor, si pjesë e misionit të saj, do të favorizojnë rritjen e rolit të kërkimit shkencor, të botimeve e publikimeve dhe rrjedhimisht, edhe të infrastrukturës organizative, intelektuale e akademike të këtyre funksioneve.

Në këtë kuadër, perspektiva dhe e ardhmja e revistës “Policimi dhe siguria” duket e qartë dhe e garantuar – pjesë dhe zëdhënëse e një institucioni të konsoliduar, në përbërje të Akademisë së Sigurisë, me kapacitete të kërkimit shkencor, të koncepteve e doktrinae,

Haxhijaj, I.

« Revista “Policimi dhe siguria” - inspiruese e ri-konceptimit dhe e ridimensionimit të sektorit të sigurisë publike »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

të metodave aplikative, etj. Një perspektivë të tillë, për kapacitetet e sipërpërmendura, e mbështesin edhe përpjekjet për transformimin real të Akademisë së Sigurisë, në një institucion të arsimit të lartë, ku komponentët e mësipërm kërkimorë janë kusht dhe kërkesë bazë e ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.

Duke mos u ndalur në radhitjen e fakteve të shumta, argumenti më i fortë dhe më i rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve shkencore-akademike, kërkimore e botuese, është vet interesi i Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera të sigurisë. Konsolidimi i institucioneve të mirëafirmuara, të akredituara dhe me standarde, të integruara në rrjetet evropiane homologe, do të shërbenin si urë lidhëse me mbarë publikun vendas, por edhe më gjerë, e do tu jepnin institucioneve tona “fytyrë” evropiane, duke rritur reputacionin e institucioneve shqiptare.

Filozofia e policimit dhe organizimi policor janë dhe duhen trajtuar si një shkencë e veçantë, dhe si e tillë, ajo duhet studiuar e zhvilluar me të gjithë mekanizmat përkatës dhe në çdo komponent përbërës. Në çdo lloj aspekti që të trajtohet, qoftë si një shkencë administrative apo e studimeve qeverisëse, e deri tek metodat e praktikat policore, ajo kërkon nevojën e kapaciteteve kërkimore, të trajtimit teorik dhe të aplikimeve praktike. Revista “Policimi dhe siguria”, edhe në të ardhmen, do të kontribuojë në konsolidimin e një epoke të re, që policia dhe policimi në vendin tonë të jenë të organizuara dhe të pozicionuara drejtë dhe veprimtaria e tyre, të bëhet bazuar në fakte e të dhëna sistematike.

Pikërisht në këtë kontekst, kjo revistë do të ketë një rol të rëndësishëm: jo në betejën midis të vjetrës e të resë, por në fitoren e kësaj të fundit mbi të parën.

Haxhijaj, I.

“ Revista

“Policimi

dhe siguria” -

inspiruese e ri-

konceptimit dhe

e ridimensionimit

të sektorit

të sigurisë

publike »

Policimi

dhe

Siguria

nr.20, 2020



Haxhiaj, I.

« Revista

“Policimi dhe siguria” -
inspiruesë e ri-
konceptimit dhe
e ridimensionimit
të sektorit
të sigurisë
publike »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria”



Dr. Xhavit SHALA

Kryetari i bordit editorial të revistës “Policimi dhe siguria”
Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë



Gjatë kësaj periudhë pesëvjeçare janë përgatitur dhe botuar 20 numra të revistës “Policimi dhe siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë.

Këto botime kanë pasur ndikim, dhe kanë ngjallur interes, jo vetëm në qarqet akademike dhe intelektuale në vend e në rajon, por edhe në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit e të strukturave të tjera të sigurisë. Në këto botime, gjithnjë e më tepër, po publikojnë shkrimet e tyre studiues e kërkues shkencorë, studentë e pedagogë të Akademisë së Sigurisë si dhe punonjës nga sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit e të strukturave të tjera të sigurisë. Përveç botimeve *hard copy* të revistës “Policimi dhe siguria”, ka vazhduar publikimi i tyre edhe *online*. Për këtë janë njoftuar të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të pasur qasje te to. Në këto 20 numra të revistës “Policimi dhe siguria”, në përputhje dhe me misionin e saj, janë publikuar e shpërndarë edhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore shkencore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

1. Botimi i revistës “Policimi dhe siguria” në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi të Qendrës së Kërkimeve Shkencore

Revista shkencore “Policimi dhe siguria” është organ periodik, teoriko-shkencor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, e cila shërben për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të kësaj akademie në fushën e policimit dhe sigurisë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm¹.

Vetë Qendra Kërkimore Shkencore (në vijim QKSH) është një ndër njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë². E organizuar në formën e një institucioni të lartë kërkimor-shkencor, QKSH është struktura që realizon përgjegjësitë institucionale të Akademisë së Sigurisë dhe Policisë së Shtetit në një fushë specifike, në atë të kërkimit dhe përgjithësisht shkencor.

Misioni i QKSH-së është qe: “Me resurset e veta dhe në bashkëpunim me pjesëtarë të stafit akademik të AS-së dhe specialistë të strukturave qendrore e vendore të policisë, të organizojë e realizojë projekte kërkimore e studimore-shkencore në fushën e policimit për rendin, sigurinë publike dhe luftën ndaj krimit; të realizojë botime shkencore të karakterit profesional për përvojat e përparuara të Policisë shqiptare dhe policive perëndimore, si dhe të propozojë hartimin e projekteve dhe programeve për parandalimin e kriminalitetit dhe fenomeneve regresive sociale”³.

Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë është strukturë që kryen veprimtari me karakter kërkimor, studimor e botues, në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi të saj. Botimi i revistës “Policimi dhe siguria” është në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi të Qendrës Kërkimore Shkencore.

Ndërsa qëllimi i botimit të revistës “Policimi dhe siguria”, është ofrimi i një platforme studimore, debati shkencor e profesional për studiues të ndryshëm, brenda organizatës së Policisë së Shtetit, por dhe më gjerë, ku të shkëmbehen mendime në lidhje me policimin, rendin e sigurinë publike dhe jo vetëm si dhe luftën ndaj krimit e çështje të tjera të lidhura me to. Realizimi i botimit të revistës menaxhohet nga sektori i botimeve të QKSH-së.

Revista “Policimi dhe siguria” është regjistruar në qendrën ndërkombëtare të ISSN-ve dhe është arritur marrja e numrit standard ISSN, me numrin : ISSN 2413-1334. Veprimtaria për botimin e revistës “Policimi dhe siguria” është përgjegjësi e bordit editorial të saj, i cili përgjigjet për realizimin nga revista të standardeve shkencore e akademike dhe për orientimin e botimeve në përmbushje të nevojave të zhvillimit të Policisë së Shtetit⁴.

Tashmë Revista “Policimi dhe siguria” drejtohet nga një bord ndërkombëtar të

¹ Botimi i Revistës “Policimi dhe Siguria”, bazohet në urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, nr. 639, datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”.

² Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 22.5.2015.

³ Rregullore e QKSH, miratuar nga senati akademik i Akademisë së Sigurisë, në mbledhjen e datës 29.1.2016, neni 6.

⁴ Bordi editorial është ngritur më urdhër të drejtorit të Akademisë datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”, neni 3.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

përbërë⁵ nga: dr. Xhavit Shala (kryetari i bordit); anëtarë: prof. dr. Ilirjan Mandro, prof. dr. Ismet Elezi, prof. dr. Irakli Koçollari, prof. dr. Giovanni Arcudi, prof. dr. Laura Tafaro, prof. asc. dr. Snezana Mojsoska, prof. asc. dr. Bejtush Gashi, prof. asc. dr. Ferdinand Elezi, prof. asc. dr. Idriz Haxhija, dr. Frank Harris dhe dr. Albert Hitoaliaj (njëkohësisht edhe redaktor shkencor i revistës). Revista ka të përcaktuar tërësinë e rregullave dhe kriterëve që duhet të respektohen në procesin e botimit, të cilat përbejnë standardet dhe kërkesat themelore që ajo duhet të përmbushë. Respektimi i tyre, gjatë procesit të botimit dhe publikimit të artikujve e punimeve studimore shkencore, është i detyrueshëm, ashtu sikurse shkelja e tyre është e ndëshkueshme.

Kjo reviste botohet në mënyrë periodike, (rreth 4 numra në vit), në formatin fizik (*print*) dhe në atë elektronik (*online*), në faqen e internetit të Akademisë së Sigurisë dhe jo vetëm. Revista i përmbahet standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare “ISSN” dhe “ISBN”, dhe është e hapur për bashkëpunëtorë shkencorë dhe kontribute nga studiues vendas e të huaj. Autorët e shkrimeve në revistën “Policimi dhe siguria” gëzojnë liri të plotë akademike në shprehjen e mendimeve dhe pikëpamjeve, me kusht që, kur shkruajnë të zbatojnë të gjithë kërkesat e legjislacionit të komunikimit edhe legjislacionit profesional. Pikëpamjet e shprehura në revistën “Policimi dhe siguria” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimin zyrtar të Akademisë së Sigurisë dhe Policisë së Shtetit.

Bordi editorial, sektori i botimeve të QKSH-së, dhe redaktori shkencor gjatë procesit të botimit të revistës respektojnë në vazhdimësi kërkesat e shtruara për paraqitjen e revistës, në të gjithë elementet përbërës të saj, si kopertinën dhe përmbajtjen (brendinë).

Bazuar në karakterin akademik, shkencor e profesional të revistës, artikujt kanë trajtuar në përgjithësi tematikat e mëposhtme: rendi dhe siguria publike, siguria kombëtare, terrorizmi dhe lufta kundër tij, parandalimi i radikalizmit të terrorizmit, droga dhe lëndët narkotike, trafikimi dhe goditja e fenomenit droge, parandalimi i kultivimit të lëndëve narkotike, kriminologjia, kriminalistika, mjekësia ligjore, siguria kibernetike, policimi në komunitet, menaxhimi policor, arsimimi dhe trajnimi policor, parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar, etj.

Bordi editorial është kujdesur që artikujt dhe shkrimet që vijnë për botim në revistë të jenë në përputhje me standardet e shkrimit akademik dhe të ndërtuar sipas kërkesave metodike shkencore të parashtrimit dhe trajtimit të çështjeve dhe ideve. Revista përdor sistemin *peer review* për botim, me qëllim që të mos lejohet botimi i artikujve që përmbajnë plagjiaturë, apo që përdorin ide ose pjesë nga publikimet e personave të tjerë, pa referencat përkatëse. Nëpërmjet udhëzimeve metodike, bordi ka përcaktuar kriteret e kërkesat metodike që duhen respektuar nga autorët e artikujve apo punimeve shkencore e akademike, stafi i sektorit të botimeve dhe redaktori përgjegjës, për paraqitjen dhe pranimin për shqyrtim të materialeve. Këto udhëzime, së bashku me ftesën apo thirrjen për pjesëmarrje të sa më shumë autorëve me artikuj apo punime, janë bërë të njohura nëpërmjet mjeteve të komunikimit e publikimit.

2. Pesë vite kërkime shkencore, në 20 numra të revistës “Policimi dhe siguria”

Në të njëzetë numrat e revistës “Policimi dhe siguria” janë publikuar e shpërndarë

⁵ Ndërkombëtarizimi i bordit editorial të revistës është bërë më urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 236, datë 26.1.2017.

edhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore shkencore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore, në fushën e policimit dhe sigurisë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Kjo veprimtari kërkimore shkencore e QKSH-së gjatë këtyre pesë viteve, e publikuar dhe shpërndarë nëpërmjet revistës “Policimi dhe siguria”, është mbështetur në tre shtylla kryesore dhe konkretisht te:

- kërkimi shkencor përmes projekteve;
- kërkimi shkencor përmes aktiviteteve;
- realizimi i botimeve shkencore për finalizimin e punës e kërkimore-shkencore si

dhe shpërndarja e njohurive shkencore.

(a) *Kërkimi shkencor përmes projekteve*, përfshin projekte kërkimore të realizuara për qëllime apo kërkesa të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. QKSH-ja ka krijuar një eksperiencë të mirë dhe me kërkuesit e saj ka realizuar gjatë kësaj periudhe dhjetë projekte kërkimore shkencore. Këto projekte janë realizuar sipas kërkesave të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, e në funksion të politikëbërjes të organizatës sonë policore.

(b) *Kërkimi shkencor përmes aktiviteteve*, përfshin organizimin, koordinimin e bashkëpunimin me institucione të tjera, për organizimin e konferencave shkencore me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të mendimit më të kualifikuar shkencor në nivel kombëtar e më gjerë, në funksion të luftës kundër krimit dhe kërcënimeve më të reja të sigurisë. Këto konferenca shkencore janë të natyrës kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre pesë viteve, QKSH-ja, në bashkëpunim me universitetet e institucione të tjera kërkimore-shkencore, brenda e jashtë vendit, ka realizuar pesë konferenca shkencore ndërkombëtare, me tematikë të fushës së rendit e të sigurisë, si dhe dy konferenca shkencore.

(c) *Realizimi i botimeve shkencore*. Këto botime janë të karakterit shkencor e të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Nëpërmjet publikimit të arritjeve shkencore në këto botime, finalizohet jo vetëm puna e kërkimit shkencor, por mundësohet edhe shpërndarja e njohurive shkencore për gjithë punonjësit e organizatës policore, e jo vetëm. Gjithashtu, publikimi i thirrjeve për botim të artikujve në revistën shkencore na mundëson në vazhdimësi thithjen e mendimit të kualifikuar të punonjësve të policisë dhe të strukturave të tjera të sigurisë, në funksion të një policimi nxitës (proaktiv).

Gjatë kësaj periudhë janë përgatitur dhe botuar 20 numra të revistës “Policimi dhe siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë. Këto botime kanë pasur ndikim dhe kanë ngjallur interes jo vetëm në qarqet akademike dhe intelektuale, në vend e rajon, por edhe në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këto botime, gjithnjë e më tepër, po publikojnë shkrimet e tyre studiues e kërkues shkencorë nga sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Përveç botimeve *hard copy* të revistës “Policimi dhe siguria”, ka vazhduar publikimi i tyre edhe *online*. Për këtë janë njoftuar të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të pasur qasje te to.

Gjithashtu, është përgatitur, miratuar dhe botuar fjalori shqip-anglisht, me terminologji policore, në shërbim të punonjësve të policisë që janë në vijën e parë të kontaktit me të huajt që vijnë në vendin tonë, si dhe një album i Akademisë së Sigurisë.

Për realizimin e veprimtarisë të mësipërme në fushën e kërkimit Qendra e Kërkimeve Shkencore ka bashkëpunuar me:

- institucione të arsimit të lartë brenda vendit si, Universiteti i Tiranës, universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit, universiteti “Luarasi”, universiteti “Zonja e Këshillit”,

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Akademikë e Forcave të Armatosura etj.;

- institute të ndryshme studimore brenda vendit si, Instituti i Policisë Shkencore, Instituti i Studimeve të Transportit, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Instituti Shëndetit Publik etj.;

- institucione të ndryshme brenda vendit si, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës etj.;

- projekte dhe misione policore që asistojnë Policinë e Shtetit dhe Akademikë e Sigurisë si, PAMECA, ICITAP etj.;

- institucione të larta arsimore jashtë vendit si, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Akademia e Sigurisë Shkup, Maqedoni, universiteti i Romës “Tor Vergata”, universiteti i Barit “Aldo Moro” etj.;

- institucione ndërkombëtare sigurie dhe jo vetëm, si, Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, NATO (Divizioni i Sigurisë Kibernetike).

3. Projektet kërkimore shkencore të realizuara nga QKSH-ja gjatë pesë viteve të aktivitetit të saj, të publikuara e të shpërndara nëpërmjet revistës “Policimi dhe siguria”

Gjatë kësaj periudhe Qendra e Kërkimeve Shkencore ka realizuar me stafin e saj dhjetë projekte kërkimore, duke vënë në shërbim të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Brendshme dhe palëve të interesuara, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave, të konkretizuara në studimet si më poshtë.

3.1 Projekti kërkimor shkencor “Mbi menaxhimin e karrierës e të sistemit tonë arsimor policor”:

ndikimi i tyre në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë të aftë si dhe trajtimi i problemeve e sfidave me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes për rishikimin dhe formësimin e politikave të nevojshme, dhe për përmirësimin e menaxhimit të zhvillimit të karrierës, duke synuar rritjen e treguesve e përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit, në luftën kundër krimit. Në këtë studim u përcaktua edhe niveli mesatar vjetor i nevojave të pranimeve të kandidatëve në Akademikë e Sigurisë, për periudhën në vazhdim.

Projekti mbuloi kërkimet për një periudhë gati 10-vjeçare (2006-2015), procesin e ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor, si dhe, menaxhimin e këtij procesi. Mbështetur në hulumtime, analiza e sinteza, u arrit në përfundimin se, shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar, drejt standardeve euroatlantike. Ndërsa, sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, keqmenaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë, që të zotërojnë aftësitë parësore, të kërkuara dhe të jenë të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës e për t’u përballur me sfidat e kohës. Këto pasoja janë ndër një në përgjithësi në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit e, në veçanti, në strukturat e hetimit të krimeve. Përveç përfundimeve, në studim janë dhënë dhe rekomandimet përkatëse

Shala, Xh.
« Pesë vite
kërkime
shkencore,
në njëzet
numra
të revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

për këtë çështje, si dhe është bërë një prognozë për të ardhmen.

Përmes një analize të thellë, të integruar dhe sintetike, projekti ia arriti objektivit të përcaktuar për evidentimin, sipas strukturave policore, të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor gjatë periudhës analizuuese dhe vlerësimin e ecures së tyre në karrierë; vlerësimin e ndikimit të ecures në karrierë të punonjësve të policisë të kësaj kategorie në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë të aftë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive të vendit të punës; përcaktimin e nivelit mesatar të nevojave të organizatës për punonjës policie të gradës nënkomisar, identifikimin e problematikave që lidhen me krijimin dhe konsolidimin e një sistemi arsimor policor bashkëkohor në mbështetje të zhvillimit të karrierës dhe krijimit, identifikimit dhe promovimit të sistemit më të mirë të vlerave të individit e të strukturave brenda organizatës policore si dhe përcaktimin e nivelit të rekrutimeve vjetore për në Akademinë e Sigurisë.

Në përfundim të këtij projekti, pas studimit për një periudhë thujse dhjetëvjeçare (2006-2015), të procesit të ecures në karrierë të punonjësve të policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor si dhe menaxhimin e këtij procesi, mbështetur në hulumtime, analiza e sinteza, u arrit në përfundimet e mëposhtme.

3.2 Përfundimi kryesor i këtij projekti

Shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike, ndërsa sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, keqmenaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara dhe të jenë të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës e për t'u përballur me sfidat e kohës, pasoja, të cilat janë ndërjetë të përgjithshme në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit, e në veçanti, në strukturat e hetimit të krimeve.

Në këtë mënyrë u provua plotësisht hipoteza e ngritur në fillim të projektit se, shkollimi bazë policor ka luajtur një rol pozitiv në përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike, ndërsa sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë për në nivelin e parë të drejtimit (gradën e nënkomisar), menaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë kanë krijuar një vakum në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara, dhe të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës e për t'u përballur me sfidat e kohës.

3.3 Përfundime të tjera

- Shkollimin bazë policor, për periudhën analizuuese, e kanë përfunduar 7720 punonjës policie. Zhvillimi i programit të shkollimit bazë policor është një arritje e madhe për organizatën tonë policore.

- Impakti pozitiv i shkollimit bazë policor është ndërjetë shumë në strukturën e sigurisë publike dhe parandalimit të krimit, në atë të kufirit dhe migracionit si dhe më pak në atë të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar.

- Punonjësit e policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor i përkasin më shumë strukturës së sigurisë publike dhe parandalimit të krimit, të kufirit dhe migracionit dhe më pak në atë të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

- Raporti që zënë punonjësit që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, sipas strukturave policore të cilave ju përkasin, me numrin total të punonjësve të policisë të vetë strukturës së tyre është më i madh në strukturën e sigurisë publike dhe parandalimit të krimit, pastaj të kufirit dhe migracionit dhe më pak në atë të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar.

- Zhvillimi i "Programit të trajnimit për karrierë dhe udhëheqje", si pjesë e sistemit të trajnimit në Policinë e Shtetit, i aplikuar për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, rezulton i suksesshëm brenda nivelit bazë.

- Zhvillimi i "Programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues për gradën nënkomisar", pjesë e "Programit të trajnimit për karrierë dhe udhëheqje", i aplikuar për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, ka mundësuar plotësimin e vetëm 25% të nevojave, në personel të Policisë së Shtetit, për specialistë të gradës "nënkomisar".

- Nevojat mesatare vjetore të organizatës sonë policore janë për 61 punonjës policie të gradës "nënkomisar".

- Zhvillimi i "Programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues për gradën nënkomisar", i aplikuar për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor ka arritur të përbushë vetëm 1/4 e nevojave të organizatës me punonjës policie të gradës nënkomisar.

- Zhvillimi i "Programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues për gradën nënkomisar", i aplikuar për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, ka penguar plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara, të aftë për funksionet që do të kryejnë, përgjegjësitë mbikëqyrëse dhe menaxhuese që ata ushtrojnë si dhe për të përbushur përgjegjësitë e vendit të punës.

- Mangësitë në përgatitjen e nënkomisarëve, në sasi dhe cilësi, përveç sistemit arsimor të përzgjedhur, janë pasojë dhe e keqmenaxhimit të implementimit të programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues.

- Keqmenaxhimi dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, si institucion i arsimit të lartë policor, thelloi pasojat e implementimit të gabuar të programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues.

- Themelimi i Akademisë së Sigurisë si institucion i arsimit të lartë, shënon një moment të rëndësishëm kthese për mundësinë e përmirësimit të menaxhimit të procesit të ecurisë në karrierë, të punonjësve të Policisë së Shtetit.

- Niveli mesatar vjetor i rekrutimeve në Akademinë e Sigurisë është i njëjtë me nevojat vjetore të Policisë së Shtetit, me specialistë policie të gradës nënkomisar për gjithsej 61 kandidatë. Në vitin akademik 2015-2016 përllogaritjet janë për 195 kandidatë.

3.4 Rekomandime

Në përfundim të këtij projekti u përshinë dhe këto rekomandime për përmirësimin e politikave në këtë fushë:

a. *Hartimi i strategjisë "Për menaxhimin procesit të zhvillimit të karrierës në Policinë e Shtetit për vitet 2016-2020"* si dhe e planit të veprimit në zbatim të saj. Ky dokument duhet të përfshijë si objektiva sa më poshtë, dhe jo vetëm:

- Hartimin dhe zhvillimin e politikave të studiuara, afatgjata dhe transparente në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit të karrierës.

- Menaxhimin cilësor të karrierës dhe zhvillimin e saj brenda fushës së shërbimit të

punonjësve, për të siguruar ekspertë me cilësi e aftësi të veçanta.

- Menaxhimin cilësor të burimeve njerëzore, promovimin e punonjësve me rezultate të larta, me integritet moral e profesional, duke u ofruar atyre shanse për ngritje në detyrë e gradë, brenda fushës së shërbimit.

- Krijimin dhe konsolidimin e një sistemi të lartë arsimor policor bashkëkohor të standardeve euroatlantike si dhe trajnim profesional të vazhdueshëm, për t'u siguruar që të gjithë punonjësit kanë dhe ruajnë aftësitë e duhura për përmbushjen e detyrave.

- Menaxhimin e punës për eliminimin sa më parë të pasojave të ardhura nga mbyllja e Akademisë së Policisë dhe moszbatimi i standardeve ligjore për zhvillimin e "Programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues për gradën nënkomisar". Për këtë, të përfshijë dhe mundësinë e kalimit në një proces shkollimi, pa shpëputje nga puna, të punonjësve të Policisë së Shtetit të cilët gjatë kësaj periudhe janë certifikuar në "Programin për shkollimin në nivelin e parë drejtues për gradën nënkomisar", pjesë e "Programit të trajnimit për karrierë dhe udhëheqje", që të zotërojnë më mirë aftësitë parësore të kërkuara dhe të bëhen më të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës.

b. Hartimi i strategjisë "Për zhvillimin dhe konsolidimin e Akademisë së Sigurisë për vitet 2016-2020" si dhe e planit të veprimit në zbatim të saj, si një dokument që synon të mbështesë rrugëtimin e Akademisë së Sigurisë drejt një akademie moderne dhe të zhvilluar, për të trajnuar dhe arsimuar punonjësit e Policisë së Shtetit dhe jo vetëm ata.

Kjo strategji të përfshijë ndërmjet të tjerave edhe këto objektiva e nënobjektiva strategjikë:

- zhvillimin e kurrikulave për të gjitha nivelet e arsimit që ofrohen në Akademinë e Sigurisë;

- zhvillimin e kapaciteteve të personelit akademik të Akademisë së Sigurisë dhe të ecurisë së punës së tyre për të arritur qëllimet e AS;

- organizimin e brendshëm infrastrukturor dhe funksionalizimin e tyre për të mundësuar plotësimin e nevojat për zbatimin e misionit të Akademisë së Sigurisë;

- përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë;

- funksionalizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe hartimi i strategjisë "Për veprimtarinë kërkimore-shkencore për vitet 2016-2020";

- reformimin e sistemit të trajnimit dhe zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë policor të bazuar në standardet e vendeve euroatlantike me qëllim që të përgatisë punonjës policie të aftë profesionalisht për t'i ofruar publikut një shërbim cilësor dhe demokratik;

- zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit me palët e interesit, pjesëtarë shtetërorë apo privatë të komunitetit të sigurisë, për të parë mundësinë e përfshirjes së tyre në të tre niveleve e sistemit të arsimit të lartë që do të zhvillohet në Akademinë e Sigurisë – kjo do ta kthente Akademinë e Sigurisë në një institucion lider në zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë në vend si dhe do fuqizonte buxhetin e saj;

- hartimin e politikave për zhvillimin e një sistemi trajnimi të bazuar në parimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të shanseve të barabarta për të gjithë punonjësit e policisë;

- mbështetjen e politikave për zhvillimin e ecurisë në karrierë nëpërmjet shkollimit dhe trajnimit;

- zhvillimin e kapaciteteve të qëndrueshme dhe përmirësimin e standardeve për trajnimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të policisë;

- përmirësimin e kapaciteteve pritëse në fakultete, në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tyre;

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

- përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve mësimdhënëse, si klasat, sallat e leksioneve, mjetet mësimore e didaktike, etj.;

- forcimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e integritetit të testimeve për pranimet në Akademinë e Sigurisë;

- zbatimin e kartës evropiane për rekrutimin e personelit akademik dhe kërkuesve shkencorë.

c. Për zhvillimin e kapaciteteve të reja të shkollimit bazë policor:

- konsolidimi i kapaciteteve ekzistuese dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja në Shkollën Bazë të Policisë, për të mësuar dhe edukuar në mënyrë të organizuar punonjësit e rinj të policisë me njohuritë bazë policore;

- zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme për përmirësimin e programit, kurrikulave dhe proceseve që lidhen me shkollimin bazë policor;

- bashkëpunimi me strukturat policore në qarqe dhe qendër, me qëllim marrjen në dinamikë të informacioneve mbi efektivitetin e “Patrullës së përgjithshme” me qëllim rivlerësimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve të shkollimit bazë policor;

- përmirësimi i standardeve dhe elementëve të rregullit dhe disiplinës në shkollimin bazë policor, nëpërmjet rritjes së ecurisë së personelit dhe pjesëmarrësve në atë shkollim;

- zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme dhe përmirësimi i standardeve, për trajnimin në terren, të punonjësve të policisë, të cilët kanë përfunduar programin e shkollimit bazë policor;

- vlerësimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të instruktorëve dhe të oficerëve të trajnimit në terren;

- përmirësimi i kapaciteteve pritëse në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tyre.

- përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve mësimdhënëse, si klasat, sallat e leksioneve, mjetet mësimore e didaktike etj.;

- rritja e shkallës së besimit të komunitetit ndaj policisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i imazhit të saj në publik, forcimi i partneritetit me komunitetin dhe sidomos më brezin e ri, si mundësi potenciale për të rritur konkurrencën dhe cilësinë e rekrutimeve për në Policinë e Shtetit;

- përmirësimi i vazhdueshëm i fushatave reklamuese për rekrutimin e kandidatëve për në Shkollën Bazë të Policisë;

- forcimi i vazhdueshëm dhe ruajtja e integritetit të testimeve për në Shkollën Bazë të Policisë;

- vazhdimi i rekrutimit të punonjësve femra sipas kritereve ligjore;

- hartimi i politikave për nxitjen e rekrutimeve sidomos nga kandidatë me arsim të lartë;

- konsolidimi i kapaciteteve ekzistuese dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja për të realizuar të gjitha programet e nevojshme për trajnimin e specializuar dhe trajnimin e avancuar të punonjësve të policisë të nivelit bazë;

- rishikimi i politikave për ndarjen e gradave brenda niveleve për të mundësuar përfshirjen e më shumë se një grade në nivelin bazë, me qëllim nxitjen e ecurisë në karrierë edhe brenda këtij niveli;

- të hartohen politika për realizimin e akreditimit të Shkollës Bazë të Policisë si Kolegi Profesional i Lartë, pranë Akademisë së Sigurisë, mundësi që e ofron dhe ligji i ri “Mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Në përfundim të këtij projekti u përcaktuar dhe një prognozë e përafërt për të ardhmen: Pas një periudhe afatmesme 3-5vjeçare, do të fillojë të ndihet impakti pozitiv i fillimit të ndikimit të arsimit të lartë policor në ecurinë në karrierë të punonjësve që kanë kryer shkollimin bazë policor dhe i plotësimit të nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomsarë me aftësi parësore të përmirësuara e të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës.

3.2 Projekti kërkimor shkencor “Vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave (fokusi në vitet 2005-2015)”

Duke marrë shkas nga tendenca në rritje e dukurisë së vetëvrasjeve, vëmendja e madhe dhe përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me raste të tilla, si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfillt në këtë fushë u propozua dhe u realizua projekti kërkimor “Mbi trajtimin e dukurisë komplekse e gjithëpërfshirëse të vetëvrasjes”. Kjo u bë në një këndvështrim psikosocial, statistikor, historik dhe analitik duke evidentuar problematikat, faktorët nxitës, nivelin e riskut të vetëvrasjes, grupet potencialisht më të rrezikuara në shoqërinë shqiptare, si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalim dhe reduktim të vetëvrasjes. Projekti u mbyll me një studim të veçantë, i cili përfshiu një periudhë relativisht të gjatë (1945-2016), duke u fokusuar sidomos në vitet 2005-2015. Një kapitull i veçantë i këtij studimi i është kushtuar studimit dhe analizimit të rasteve të vetëvrasjeve nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Në këtë studim u arrit në përfundimin se, në Shqipëri, dukuria e vetëvrasjes ka një prirje në rritje, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit. Grupet potencialisht më të rrezikuara rezultojnë të jenë nga mosha e mesme; me arsim 8 ose 9-vjeçar; janë më shumë meshkujt; ekziston një prirje rritëse tek femrat të vetëvrasjeve të mbetura në tentativë; me tendencë në rritje drejt zonave urbane; me shpërndarje gjeografike më shumë në qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, Shkodër; më shtrirje stinore kryesisht në muajt e verës dhe pranverës.

Faktorë që lidhen me shëndetin mendor si depresioni, gjendjet e ankthit e vetmisë, izolimi, humbja e shpresës, stresi, problemet mendore dhe moskurimi e mostrajtimi në mënyrën e duhur; faktorë lidhur me problemet sociale si konfliktet në çift, çështja e ruajtjes së nderit, humbja e partnerit, lidhje të dobëta shoqërore, dhuna në familje, këndvështrimi i errët për jetën, abuzimi me alkoolin e drogën, paragjykimin e stigmatizimi, predikimet fetare si dhe faktorët ekonomikë si, futja në borxhe, stresi si pasojë e punës apo profesionit, konfliktet për pronën, etj., konsiderohen si faktorët kryesorë të riskut të cilët nxisin predispozitën për vetëvrasje në vendin tonë.

Ndërsa, dukuria e vetëvrasjes në radhët e punonjësve të policisë, është në shifra të ulëta në raport me numrin e vetëvrasjeve në vend dhe krahasuar me përhapjen e këtij fenomeni në organizatat policore të disa vendeve të tjera. Shihet një tendencë në rritje sidomos vitin e fundit të periudhës analizuese (2015). Rastet e ndodhura i përkasin kryesisht punonjësve të policisë me gradë inspektor dhe në funksione bazë në polici (roje, patrullë).

Në përfundim, në përputhje dhe me qëllimin e realizimit të këtij projekti, për parandalimin dhe reduktimin fenomenit të vetëvrasjeve, sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj saj si një problem me tendencë në rritje si dhe në shërbim të një policimi më efektiv në raport me këtë dukuri, u dhanë

Shala, Xh.
« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

rekomandimet për përmirësimin e politikave në këtë fushë, si deh një prognozë për të ardhmen si më poshtë.

3.2.1 Rekomandime të përgjithshme të këtij projekti

a. *Hartimi i strategjisë kombëtare* për parandalimin e vetëvrasjeve si dhe e *Planit të veprimit* në zbatim të saj. Ky dokument duhet të përfshijë si objektiva, këto më poshtë e jo vetëm:

- hartimin dhe zhvillimin e politikave të studiuara afatgjata për sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj fenomenit të vetëvrasjeve si një problem shëndetësor me tendencë në rritje, për dhënien e informacionit të duhur mbi faktorët e rrezikut për vetëvrasje, për çrregullimet psikiatrike, veçanërisht çrregullime të humorit e të skizofrenisë si dhe trajtimin e tyre, me qëllim që kërkesa për ndihmë mjekësore psikiatrike, të jetë sa më e shpejtë dhe më efikase;

- hartimin dhe zhvillimin e politikave të studiuara afatgjata për nxitjen, krijimin dhe konsolidimin e një bashkëpunimin ndërinstitucional mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe strukturave të saja vartëse, Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, të institucioneve të tjera që do të përfshihen në këtë proces si dhe të organizatave të shoqërisë civile, nën drejtimin e një organizmi koordinues kombëtar, me synim kryesor parandalimin e vetëvrasjeve, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave që kanë tentuar vetëvrasjen dhe të atyre të rrezikuarve;

- hartimin nga Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të “Strategjisë kombëtare për parandalimin e vetëvrasjeve”, të politikave sektoriale për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor si një pjesë e rëndësishëm e sigurisë shëndetësore e asaj njerëzore, për bashkëpunimin e domosdoshëm mes personelit mjekësor, - sidomos strukturave të mjekut të familjes e atij psikiatër, vetë familjes ku jetojnë personat e rrezikuar si dhe sensibilizim në përgjithësi të gjithë strukturave mjekësore, për të shtrirë në mënyrë më efikase shërbimet e specializuara për trajtim e parandalim e vetëvrasjeve;

- politikat sektoriale për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor të përfshijnë objektiva dhe aktivitete si më poshtë e jo vetëm:

- për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth problematikave të shëndetit mendor dhe vetëvrasjes;

- për të nxitur dhe punuar për një kulturë më të gjerë të shqiptarëve për kontrole mjekësore, për terapi, konsulta, etj., për ata që kanë jo vetëm probleme apo çrregullime mendore, por edhe për ata që pësojnë kriza të lehta emocionale apo psikologjike si pasojë e ndonjë ngjarjeje problematike apo traumave;

- për të luftuar depresionin, sëmundjet, çrregullimet mendore;

- për të luftuar stigmatizimin e përhapur në vend për këto sëmundje;

- për të rritur efikasitetin dhe profesionalizmin në përcaktimin e diagnozave e të kurave, në mënyrë që trajtimi të ndikojë pozitivisht te individit, pasi, në jo pak raste, edhe pse nën efektin e trajtimeve dhe medikamenteve, shumë persona kanë përfunduar sërish në vetëvrasje;

- për një vëmendje më të shtuar ndaj shëndetit mendor të femrave, si më të priat drejt tentativave të vetëvrasjes;

- për një vëmendje më të shtuar ndaj grupeve sociale potencialisht të rrezikuara, që sipas gjetjeve të studimit janë mosha e mesme (e re dhe e vjetër), me arsim 8 ose 9-vjeçar, - më shumë meshkujt, por me prirje rritëse të femrave, - me një përhapje drejt

Shala, Xh.
« Pesë vite
kërkime
shkencore,
në njëzet
numra
të revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

zonave urbane dhe sidomos në qytetet me numër më të lartë të rasteve të vetëvrasjeve si Tirana, Durrësi e Lezha, e me shtrirje stinore në muajt e verës e pranverës;

- hartimin nga ana e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Vetëvrasjeve, të politikave sektoriale që synojnë një përfshirje më të madhe të strukturave sociale për të zbutur problemet socio-ekonomike, si faktorë të rëndësishëm rreziku për vetëvrasjet;

- hartimin nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, në zbatim të “Strategjisë kombëtare për parandalimin e vetëvrasjeve”, të politikave sektoriale që synojnë sensibilizimin e strukturave përkatëse edukuese, dhe ndërgjegjësimin për fenomenin e vetëvrasjes, si një problem shëndetësor me tendencë në rritje, si dhe përfshirjen në kurrikula mësimore sipas niveleve të njohurive e të informacionit të nevojshëm për çrregullimet psikiatrike, veçanërisht mbi çrregullimet e humorit dhe të skizofrenisë, me rreziqshmëri të lartë për fenomenin e vetëvrasjeve.

b. Rekomandime specifike për Policinë e Shtetit për trajtimin e vetëvrasjes si një çështje të shëndetit mendor me ndikime edhe në sigurinë publike.

Në funksion të trajtimit të vetëvrasjeve si çështje të shëndetit mendor, me ndikime edhe në sigurinë publike, rekomandohet hartimin nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit), në zbatim të “Strategjisë kombëtare për parandalimin e vetëvrasjeve”, të politikave sektoriale me synim:

- dhënien e informacionit të nevojshëm dhe ndërgjegjësimin e strukturave policore për fenomenin e vetëvrasjes, si një problem shëndetësor me tendencë në rritje që i përket edhe strukturave policore;

- rishikimin e akteve normative e të procedurave të strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve dhe në përgjithësi të strukturave të tjera të Policisë së Shtetit, për trajtimin dhe parandalimin e fenomenit të vetëvrasjeve, dhe trajtimin e tyre jo vetëm si një çështje të shëndetit mendor, por me ndikime dhe në sigurinë publike;

- përmirësimin e programeve mësimore e të kurrikulave për kursantët e Shkollës Bazë të Policisë, për studentët e Akademisë së Sigurisë si dhe për trajnimet që zhvillojnë strukturat e trajnimit të vazhdueshëm profesional, lidhur me shtimin e njohurive teorike dhe profesionale për fenomenin e vetëvrasjes si dhe parandalimin e hetimit e saj, duke filluar nga pajisja me njohuritë e nevojshme:

- mbi mënyrës e kujdesit për veten,
- mbi njohjen e shenjave paralajmëruese të vetëvrasjes,
- mbi njohjen e grupeve potencialisht më të rrezikuara nga vetëvrasja,
- mbi njohjen e shkaqeve ndikuese në vetëvrasje;

- përfshirjen në programet dhe kurrikulat e rishikuara të njohurive të plota për mekanizmin e vetëvrasjeve, duke filluar nga krijimi i kushteve dhe mjeteve të vetëvrasjes, të tentativave për vetëvrasje, paravetëvrasje e deri te vetëdëmtimi, dallimi i vetëvrasjes nga vrasja, vdekja natyrale, vdekja aksidentale, vetëvrasja nga pakujdesia, bashkëpunimi në vetëvrasje, shtytja në vetëvrasje, shkaktimi i vetëvrasjes, vetëvrasja si pasojë e një veprimtarie kriminale, si dhe shenjat kryesore që duhet të gjenden tek viktimat dhe vendi i ngjarjes sipas mënyrës së realizimit të vetëvrasjes;

- përgatitjen e oficerëve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, që në rastin e vetëvrasjeve, të mos kufizohen vetëm me veprimtarinë rutinë, duke plotësuar dosjen e viktimës dhe duke ia nisur atë prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, por të ndërmarrin hetime të thelluara për çdo rast, duke përfshirë këtu sa më poshtë, dhe jo

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

vetëm:

- rritjen e profesionalizmit për këqyrjen e vendit të ngjarjes;
- marrjes me hollësi të deklarimeve personave që kanë qenë të pranishëm në ngjarje, familjarëve ose personave të tjerë që kanë pasur lidhje me viktimën;
- verifikimet e hollësishme në lidhje me viktimën, personalitetin e tij (saj), si dhe identifikimin e motiveve të vetëvrasjes;
- verifikimin e plotë të të gjitha pretendimeve që ngrihen nga familjarët apo persona të tjerë, në lidhje me vetëvrasjen e personit apo dyshimet që ata paraqesin dhe bashkëpunimin me ta për sqarimin e çdo rrethane;
- sigurimin e mbështetjes profesionale në raste të tilla nga specialistë të formimit në shkencë sociale (psikolog, punonjës social, sociolog, etj.) për procesin më eficient të hetimit gjatë pyetjes së dëshmitarëve apo vetë viktimën që ka tentuar vetëvrasjen;
- plotësimin e një pyetësoi të standardizuar profesional, të hartuar paraprakisht nga një grup pune profesionistësh të fushës së psikologjisë, sociologjisë, mjekësisë, etj., me qëllim marrjen e një informacioni të plotë, dhe me një natyrë të gjithanshme, rreth motiveve, faktorëve ndikues, vetë personit, veçorive e karakteristikave të tij, detajeve të tjera të ngjarjes apo historikut familjar, etj., për ndërtimin e një baze të dhënash më të specifikuar, për fusha të ndryshme si ato sociale, mjekësore e policore, që mund të vihen në përdorim të Policisë së Shtetit apo institucioneve të tjera, në kuadër të bashkëpunimit për kryerjen e studimeve të vazhdueshme dhe më të hollësishme rreth vetëvrasjes;
- përfshirja e punonjësve të policisë në programe trajnuese dhe pajisja e tyre me njohuritë e duhura:
- për njohjen dhe menaxhimin e depresionit,
- për aftësitë ndërpersonale,
- për zgjidhjen e konflikteve,
- për aftësitë e komunikimit,
- për dhunën në familje,
- për dhunën lidhur me përdorimin e armëve, drogës apo alkoolit;
- trajtimin dhe vlerësimin e vetëvrasjes si kategori më vete të krimeve kundër jetës dhe nxjerrjen e statistikave të vazhdueshme rreth saj;
- rritjen e bashkëpunimit me prokurorinë dhe realizimin e analizave të përbashkëta me të, për ecurinë e hetimeve në rastet e vetëvrasjeve;
- trajnimin e punonjësve të policisë për përballjen dhe menaxhimin e situatave me personat që kanë probleme mendore, çrregullime mendore, dhe çrregullime të personalitetit;
- hartimin e procedurave dhe trajnimin e punonjësve të policisë për përballjen dhe menaxhimin e situatave se si duhet të veprojnë konkretisht punonjësi i policisë kur dikush tenton të vrasë veten, shpejtësinë e veprimeve për parandalimin e ngjarjes së vetëvrasjes duke bërë rolin e ndërmjetësit nga ana e forcave policore dhe ndërtimin e komunikimit në mënyrë që të arrijnë të parandalojnë efektivisht vetëvrasjen;
- mundësinë e krijimit të një strukture të posaçme me psikologë, sociologë dhe specialistë të hetimit, të cilët të jenë përgjegjës për asistimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë sipas niveleve, për trajtimin e rasteve të vetëvrasjes;
- bashkëpunimin me struktura të tjera shtetërore, shoqërinë civile dhe komunitetin për parandalimin e vetëvrasjeve si dhe rehabilitimi e riintegrimi i personave që kanë tentuar vetëvrasjen, ndërmjet implementimit të policimit në komunitet e të praktikave

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

pozitive botërore lidhur me:

- identifikimin e faktorëve të riskut dhe shenjave paralajmëruese që janë tregues të prirjes për vetëvrasje;

- mundësinë për linja telefonike për të ofruar ndihmë në momentin që ndihen nën depresion apo të gatshëm për të vrarë veten, në mënyrë që të krijohet hapësirë për asistencë për parandalimin e vetëvrasjes;

- menaxhimi i një faqeje *online* për dhënien e këshillave etj., për parandalimin e vetëvrasjes në vendin tonë, sipas modeleve të vendeve me eksperiencë në këtë fushë;

- programe këshillimi për konfliktet në çifte, për mbështetje të të martuarve etj.;

- këshillime për periudhën para daljes në pension;

- zhvillimin e modeleve të autopsive psikologjike;

- mbështetjen dhe riintegrimin e të mbijetuarve nga vetëvrasja;

- vlerësimet e ndërhyrjeve dhe shërbimeve parandaluese;

- ndërtimin, në zbatim të strategjisë së policimit në komunitet, të urave lidhëse, kontakteve dhe takimeve të punonjësve të policisë me shoqërinë civile e me shkollat, me mësues e me prindër, me struktura të posaçme mjekësore apo të çështjeve sociale, me specialistë të çështjeve të dhunës në familje etj.;

- organizimi në komunitet i takimeve, mbledhjeve, trajtimit të rasteve të vetëvrasjes me më shumë prioritet, nën moton: “Aty ku ka një problem, duhet të ndihmojmë ta zgjidhin të gjithë aktorët”;

- ndërtimin e besimit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për t’iu drejtuar forcave policore në momentin që ndihen nën depresion apo të gatshëm për të vrarë veten, në mënyrë që të krijohet hapësirë për parandalim;

- hartimin e politikave dhe procedurave që kufizojnë mundësinë e sigurimit të mjeteve që do të shërbenin për realizimin e vetëvrasjeve si të helmeve bujqësore, medikamenteve mjekësore etj.

- krijimin e një bazë me të dhëna të sakta për vetëvrasjet dhe vetëvrasjet e mbetura në tentativë të e cila do të krijojë mundësinë:

- për të njohur me nivelin e kësaj veprë në raport dhe me kriminalitetin në përgjithësi;

- për identifikimin e komuniteteve apo grupeve shoqërore që ndikohen më së shumti nga vetëvrasja, si dhe shkaktarët e rrethanat ndikuese, në mënyrë që ky informacion të jetë në dispozicion të strukturave policore, të institucioneve të tjera dhe të organizatave të specializuara të shoqërisë civile, në kuadër të parandalimit të vetëvrasjes;

- për të ndjekur dinamikën e këtij fenomeni;

- për të konstatuar nivelin e rrezikshmërisë dukurisë së vetëvrasjeve, nëpërmjet hetimeve të thelluara të vetëvrasjeve apo të vetëvrasjeve të mbetura në tentativë si dhe të analizave statistikore të dinamikës së përhapjes së këtij fenomenit në shoqërinë tonë;

- për të rritur bashkëpunimin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit me institucione të tjera kompetente profesionale për marrjen e masave në kuadër të parandalimit të kësaj dukurie;

- për nxjerrjen e statistikave të vazhdueshme për këtë fenomen.

c. Rekomandime specifike për parandalimin e vetëvrasjes brenda organizatës policore

Në funksion të minimizimit dhe të parandalimit të dukurisë së vetëvrasjes brenda organizatës policore rekomandohet hartimi i politikave që të përfshijnë si më poshtë

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

dhe jo vetëm:

- *Trajnimin e drejtuesve të policisë për t'i pajisur ata me njohuritë e aftësitë e duhura që të kuptojnë se kur punonjësi i policisë ka shqetësime dhe sjellje të rrezikshme, të cilat dëshmojnë për mendime apo tentative vetëvrasjeje, apo se kur punonjësit e policisë përballen me probleme të ndryshme të jetës, dhe mënyra se si duhet t'u vijnë atyre në ndihmë, duke iu kushtuar një rëndësi të veçantë dhe përzgjedhëse, në planin e trajtimit të sugjeruar për parandalimin e vetëvrasjes së personave, apo të punonjësve të policisë, të rrezikuar nga kjo dukuri;*

- identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe shenjave paralajmëruese që janë tregues të prirjes për vetëvrasje brenda organizatës policore;

- përcaktimin e nivelit të rrezikut të vetëvrasjes për komunitetin policor, si dhe të shkaktarëve e të rrethanat ndikuese, në mënyrë që ky informacion të jetë në dispozicion të strukturave drejtuese policore në kuadër të organizimit të punës për parandalimin e kësaj dukurie brenda organizatës policore;

- ndërtimin e strukturave dhe shërbimeve të posaçme për të mbështetur detyra të caktuara dhe trajtimin e problemeve serioze, siç është vetëvrasja;

- përfshirjen dhe vlerësimin e shqyrtimit psikologjik në kriteret e rëndësishme të përzgjedhjes, qysh në rekrutimin e kandidatëve për oficerë policie;

- zhvillimin e trajnimeve për menaxhimin e stresit dhe për matjen e nivelit të stresit;

- identifikimin dhe pikasjen e punonjësve me rrezik të lartë vetëvrasjeje;

- aplikimin e shërbimeve psikologjike dhe kryerjen e vlerësimeve psikologjike për detyra speciale dhe me rrezikshmëri të lartë në polici;

- përfshirjen e shërbimeve ndërhyrëse (parandaluese) të ngjarjeve dhe të incidenteve kritike e emergjente, sipas modeleve të huaja, me funksion informativ dhe mbështetës për njësitë policore;

- aplikimin e shërbimeve psikologjike;

- përfshirjen në strukturat organike të njësive kryesore policore të punonjësve sociologë, psikologë si elementë të rëndësishëm, në zbatimin e politikave në funksion të minimizimit dhe të parandalimit të dukurisë së vetëvrasjes brenda organizatës policore;

- përforsimin e strukturave të shërbimit shëndetësor në organizatën policore në nivel qendror, por edhe në njësitë kryesore vendore me punonjës që zotërojnë aftësitë dhe informacionin e duhur mbi faktorët e riskut për vetëvrasje, për çrregullimet psikiatrike, veçanërisht çrregullime të humorit e të skizofrenisë si dhe trajtimin e tyre, me qëllim që kërkesa për ndihmë mjekësore psikiatrike për punonjësit e policisë të jetë sa më e shpejtë dhe sa më efektive;

- hartimin e politikave dhe të procedurave që normojnë bashkëpunimin e ndërsjellë mes strukturave të kujdesit shëndetësor, të punonjësve sociolog-psikolog dhe të drejtuesve të njësive policore, në funksion të zbatimit të masave për minimizimin dhe parandalimin e dukurisë së vetëvrasjes në organizatën policore.

Në përfundim të projektit është vlerësuar se gjetjet, analizat dhe rekomandimet e këtij studimi janë të vlefshme edhe për institucione të tjera shtetërore apo organizata jofitimprurëse e për shoqërinë civile, të cilat kanë interes për trajtimin dhe parandalimin e dukurisë së vetëvrasjes në Shqipëri.

Përcaktimi i një prognoze të përafërt për ecurinë e kësaj dukurie

Dukuria e vetëvrasjes në vendin tonë do të vazhdojë të ketë një trend në rritje. Kjo për shkak të tranzicionit të tejzgatur dhe të problemeve të mëdha social-ekonomike,

mangësive në përgatitjen e shoqërisë shqiptare për t'u ballafaquar me këtë dukuri si dhe të mangësive të theksuara të kujdesit ndaj shëndetit mendor. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së rekomanduar për parandalimin e vetëvrasjeve do mundësojë, që të paktën dhe për një periudhë afatmesme, 3-5 vjeçare, shoqëria shqiptare të fillojë të ndërgjegjësohet e të ballafaqohet seriozisht me pasojat e kësaj dukurie. Ky do të jetë fillimi i një investimi të madh për parandalimin e kësaj dukurie në të ardhmen.

3.3 Projekti kërkimor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016”

Duke marrë shkas nga perceptimi i një tendence në rritje të dhunës dhe të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, vëmendja e madhe e përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me raste të tilla, ndikimi i tyre në çështjet e rendit dhe të sigurisë në vendin tonë si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfilltë e të thelluar në këtë këndvështrim, Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë, planifikoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016”.

Qëllimi i këtij projekti kërkimor-shkencor ishte trajtimi i problemit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, në këndvështrim historik, ligjor, kronologjik, social e psikosocial, analitik e statistikor, duke u përqendruar në dhjetëvjeçarin 2007-2016. Tjetër qëllim ishte realizimi i një analize krahasuese me periudha të mëparshme me synim evidentimin e problematikave, faktorët nxitës si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e dukurisë së vrasjeve, për shkak të marrëdhënieve familjare dhe menaxhimit të konflikteve e dhunës, në shërbim të përmirësimit të mëtejshëm të procesit të një policimi komunitar, të ndërthurur me atë të bazuar në inteligjencë, në lidhje me këtë çështje.

Bazuar në treguesit objektivë, është arritur në përfundimin se, ndryshe nga sa perceptohet, për periudhën analizuese 2007-2016, ka një tendencë të theksuar në rënie të numrit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare. Kjo është evidentuar pas vitit 2013, sidomos në vitet 2014-2016. Në vitin 2016 (viti i fundit i periudhës analizuese) kanë ndodhur 16 vrasje (së bashku me ato të mbetura në tentativë) ose 2.68 herë më pak se në vitin 2007 (vit i parë i periudhës analizuese) dhe 3.3 herë më pak se në vitin 2012, i cili shënon nivelin më të lartë të vrasjeve për shkak të rrethanave familjare të kësaj periudhe analizuese.

Në përfundim të këtij projekti, në përputhje me qëllimin e realizimit të tij, për trajtimin, parandalimin dhe reduktimin e dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, si dhe zanafillës së tyre, dhunës e konflikteve, ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj tyre si një problem shqetësues dhe i vazhdueshëm, pavarësisht shifrave aktuale në rënie të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si dhe në shërbim të një policimi më efektiv në raport me këtë dukuri, janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e politikave në këtë fushë si në vijim.

a. Rekomandime të përgjithshme të këtij projekti

- Hartimi dhe zhvillimi i politikave të studiuara afatgjata për sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj fenomenit të konflikteve në familje,

Shala, Xh.
« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

dhunës ekstreme dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për dhënien e informacionit të duhur mbi faktorët që ndikojnë dhe i kthejnë konfliktet në familje deri në vrasje si dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e tyre, etj.

- Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i politikave të studiuara afatgjata për fuqizimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj institucionalë gjithëpërfshirës dhe efikas, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunim të përgjegjshëm ndërinstitutional, mes palëve pjesëmarrëse: Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në nivel qendror e vendor, të institucioneve të tjera që do të përfshihen në këtë proces si dhe të organizatave të shoqërisë civile, nën drejtimin e një organizmi koordinues kombëtar, me synim koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Në zbatim të këtyre politikave të hartohet një strategji kombëtare për trajtimin me prioritet, ndërgjegjësimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, garantimin e drejtësisë, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave, të mbijetuarve të kësaj dukurie, për të ndërtuar një shoqëri që u garanton shtetasve të saj, një jetë sa më të sigurt e pa kërcënime të dhunës ekstreme në familje si dhe të "Planit të veprimit" në zbatim të saj. Ky dokument të përfshijë si objektiva sa më poshtë, dhe jo vetëm:

- parandalimin dhe ndërgjegjësimin nëpërmjet informimit, edukimit, arsimimit dhe ndërgjegjësimin të vazhdueshëm të profesionistëve, komuniteteve dhe të mbarë shoqërisë me këto aktivitete kryesore e jo vetëm:

- forcimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të vijës së parë, të atyre që ofrojnë shërbimet bazë si punonjës policie, mësues shkollash, edukatorë, psikologë, punonjës socialë, punonjës të shëndetësisë, etj., për parandalimin e konflikteve dhe të dhunës në familje;

- nxitja e viktimave dhe familjarëve të tyre për denoncimin e rasteve të dhunës në familje e rritjen e besimit të tyre tek Policia e Shtetit si dhe te institucionet e tjera ligjzbatuese;

- rritja e shkallës së ndërgjegjësimin të shoqërisë për të mos toleruar në asnjë rrethanë dhunën në familje;

- fuqizimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë, gjithëpërfshirës dhe efikas, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës e mundësive të vrasjeve në familje, si dhe bashkëpunimin e përgjegjshëm ndërinstitutional, mes palëve të pjesëmarrëse, Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në nivel qendror e vendor, të institucioneve të tjera që do të përfshihen në këtë proces si dhe të organizatave të shoqërisë civile, nën drejtimin e një organizmi koordinues kombëtar, me synimin koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, me këto aktivitete kryesore e jo vetëm:

- zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave/mbijetuarve të dhunës e të vrasjeve në familje;

- fuqizimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë në nivel vendor për mbrojtjen e viktimave ose të mbijetuarve, të dhunës e vrasjeve në familje dhe menaxhimin e rasteve;

• rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional mes palëve pjesëmarrëse, Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në nivel qendror e vendor, dhe organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e viktimave përmes qartësimit të roleve “kush bën çfarë”, si dhe detyrave e përgjegjësisë të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve.

- Rritjen e efikasitetit të hetimit nga ana policisë dhe e prokurorisë në rastet e dhunës dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si dhe rritjen e rolit të gjykatave në luftën kundër kësaj dukurie, nëpërmjet ndëshkimit të autorëve të këtyre veprave penale, me këto aktivitete kryesore e jo vetëm:

- përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe i akteve të tjera për trajtimin efikas të rasteve të dhunës e vrasjeve në familje:

• rritja e nivelit profesional të oficerëve të policisë gjyqësore, të prokurorëve e të gjyqtarëve në zbulimin, parandalimin, hetimin, dokumentimin e gjykimin sa më të shpejtë të e rasteve të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare;

• rritja e përgjegjshmërisë në veprimtarinë e tyre, qartësimi i roleve dhe marrja e përgjegjësisë nga institucionet e mësipërme si dhe koordinimi i politikave kundër dukurisë së dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Riintegrimin e viktimave ose të mbijetuarve të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si dhe rehabilitimin e autorëve të dënuar të këtyre veprave penale me këto aktivitete kryesore e jo vetëm:

• fuqizimi, në nivel qendror dhe vendor, i shërbimeve ekzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja për rehabilitimin e viktimave ose të mbijetuarve të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe rritja e efektivitetit të këtyre shërbimeve;

• planifikimi i fondeve buxhetore në nivel shtetëror, në mbështetje të shërbimeve për riintegrimin afatgjatë, për viktimat ose të mbijetuarit, e dhunës e vrasjeve në familje;

• përdorimi i politikave të integruara për përmirësimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje;

• aplikimi i programeve të veçanta dhe detyruese për rehabilitimin e autorëve të dënuar të dhunës në familje e të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në IEVP-të në Shqipëri.

b. Rekomandimet e tjera lidhen me:

- Bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërinstitucional, e konkretisht:

• realizimin e studimeve dhe raporteve analitike të thelluara në Policinë e Shtetit e më gjerë, të detajuara e specifike të konflikteve, dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për të analizuar shkaqet reale dhe për të marrë masa për të trajtuar, parandaluar dhe reduktuar rastet e tilla, si dhe impaktin e tyre në shoqëri;

• procedura pune specifike për secilin nga institucionet bashkëpunuese për trajtimin, mbajtjen e të dhënave, reagimin dhe zgjidhjen e rasteve të vrasjeve, si dhe të dhunës dhe konflikteve në familje;

• koordinim mes procedurave sektoriale në një procedurë të unifikuar, ku të përcaktohet roli i secilit prej institucioneve, strukturave të tyre përkatëse dhe punonjësve për të trajtuar rastet e vrasjeve, dhunës apo konflikteve në familje;

• puna të organizohet mbi tre shtylla të problematikave në familje: konfliktet, dhuna, vrasjet;

• ndërmarrja e masave, rishikim i procedurave të punës dhe politikave për më shumë bashkëpunim mes punonjësve të policisë dhe strukturave të pushtetit vendor

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

për mbërritjen në vendin e ngjarjes dhe dhënien e mbështetjes në situata emergjente, si dhe përgjatë hetimit të rasteve të dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare;

- gjetja e mekanizmave që të mundësojnë një bashkëpunim më të gjerë të punonjësve të policisë dhe profesionistëve mjekësorë dhe socialë (mjek, terapist, psikiatër, psikolog, sociolog, punonjës social, etj.,) që shihet si mangësi nga punonjësit e policisë, por e domosdoshme;

- komunikim e bashkëpunim më i madh mes SPZ-ve të zonave dhe atyre të hetimit me banorët për evidentimin e konflikteve familjare që mund të rëndohen më pas në dhunë e vrasje;

- organizim i fushatave e trajnimeve për orientimin e zgjidhjes së konflikteve jashtë vetes, drejt institucioneve (polici, OJF, palë të tretë si ndërmjetësi, negociuesi, etj.) me synim eliminimin e zgjidhjeve me vetëgjyqësi;

- përmirësimi i politikave të punësimit dhe pagave, fillimisht për personat që janë të regjistruar se kanë probleme apo dhunë në familje, apo ata që jetojnë në familje ku kanë ndodhur vrasje të mëparshme për shkak të marrëdhënieve familjare, e në përgjithësi për shtresat në nevojë;

- hartimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të politikave sektoriale që synojnë një përfshirje më të madhe të strukturave sociale për të zbutur problemet socio-ekonomike, si faktorë të rëndësishëm rreziku për vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare;

- fokusi të jetë të grupi i përzgjedhur i meshkujve të grupmoshës 30-50 vjeç, që duhet të marrin fillimisht vëmendje institucionale, shoqërore e profesionale;

- rishikimi i politikave për përmirësimin e nivelit arsimor të shtresave të ndryshme të popullsisë nëpërmjet nxitjes së arsimit në të tre nivelet, sidomos në atë (8 ose 9-vjeçar, arsimin e mesëm dhe arsimin e lartë) si në zonat rurale, ashtu dhe ato urbane;

- gjetja e mekanizmave për marrjen e masave për mbushjen e vakuumit të arsimit të shtresave të veçanta të popullsisë me anë të punësimit, trajnimeve e fushatave sensibilizuese në familjet apo personat e përzgjedhur.

- Ndërtimin e një baze kombëtare të dhënash për rastet e raportuara të konflikteve, dhunës dhe vrasjeve në familje mbi bazën e të dhënave të ngritura në nivelin e institucioneve si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit si më poshtë:

- angazhimi më i madh i SPZ-ve të zonave dhe atyre të hetimit që në bashkëpunim me banorët e zonave dhe struktura të pushtetit vendor, të punojnë për evidentimin e konflikteve familjare, rasteve të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare me synimin për krijimin e një baze të dhënash për këtë problem sipas zonave, komisariateve e drejtorive vendore të policisë;

- ndërtimi në Policinë e Shtetit të një baze të dhënash më të zgjeruar e me informacione më të detajuara për autorët, viktimat, të shkuarën e tyre, familjen dhe specifikat e ngjarjes së konfliktit, dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, të cilat do t'i shërbejnë jo vetëm hetimit, por dhe për menaxhimin e situatave që lidhen më këto dukuri;

- punonjësit e policisë duhet të aftësohen për të menaxhuar efektivisht përballjen me situatat emergjente të njoftimeve për konflikte, dhunë apo vrasje në familje; ata duhet të kujdesen për mënyrën e ndërhyrjes në vendngjarje, mënyrën e komunikimit dhe të sjellit, si dhe respektimin e procedurave standarde të hartuara për këtë problem;

• në ministritë përkatëse bashkëpunuese duhet të përshtatet kjo bazë të dhënash dhe të plotësohet me informacione të tjera specifike sipas fushës së tyre;

• koordinimi i këtyre institucioneve duhet të bëhet me anë të një zyre kombëtare të posaçme e cila duhet të jetë përgjegjëse për grumbullimin dhe përmbledhjen e gjithë informacioneve që ruhen e vijnë gjatë procesit të bashkëpunimit të këtyre institucioneve;

• ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë me anë të bazës së tyre të të dhënave të mundësojnë ofrimin e informacionit të detajuar rreth konflikteve, dhunës e vrasjeve në familje të regjistruara prej tyre si dhe të ofrojnë mbështetje e këshillim ligjor nëpërmjet strukturave specifike që merren me këto çështje;

• ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me anë të bazës së saj të të dhënave të mundësojë ofrimin e informacionit dhe këshillim e trajtim mjekësor e psikosocial nëpërmjet strukturave të saja vartëse e partnere;

• me anë të zyrës së koordinimit dhe unifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet, këto çështje duhet të trajtohen nga aspekti i ndërhyrjes, hetimit, aspektit ligjor, strehimit, këshillimit ligjor e psikologjik e mbështetjes së personave të përfshirë në probleme familjare, sipas rastit;

• kjo bazë të dhënash do të jetë specifike vetëm për rastet e personave që lidhen me konflikte, dhunë dhe vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare që janë raportuar.

• personat e regjistruar në bazën e të dhënave, do të synohet që të jenë të parët që të marrin vëmendje, pasi ata janë potenciali më i rrezikshëm i kësaj problematike.

- Hartimin dhe implementimin e projekteve pilot për problematikat dhe konfliktet në familjet shqiptare, sipas zonave, grupmoshave e gjinive, si më poshtë:

• të mbështeten projekte të veçanta me fokus fushatat sensibilizuese për ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për: shkaqet dhe pasojat e konflikteve, dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, mënyrën e komunikimit mes anëtarëve të familjes, teknikat e mënyrat e përballimit të stresit apo tensionit, orientime për forma të komunikimit dhe zgjidhjes së konflikteve;

• fushata ndërgjegjësimi në shoqëri të fokusohen në grupe të shënjuara të familjeve ku ushtrohen dhunë; në grupe të shënjuara të familjeve ku ka ndodhur më parë vrasje; në fokus grupe të tjera si tek të rinjtë, fëmijët, etj., për problematikat, efektet pozitive e negative të dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, etj.;

• fushatat ndërgjegjësimi duhet të kenë qëllim parësor orientimin e popullatës për të zgjidhur konfliktet në familje në rrugë institucionale dhe jo me vetëgjyqësi;

• ndërmarrja e organizimi i fushatave e trajnimeve për menaxhimin e situatave, të stresit dhe të konflikteve nga meshkujt shqiptarë, kryesisht të grupmoshës 31-50 vjeç;

• të hartohen projekte të veçanta për sensibilizim të veçantë për personat që janë të regjistruar në bazat e të dhënave të përmendura më sipër, të cilat kanë probleme me dhunën në familje, apo ata që jetojnë në familje ku kanë ndodhur vrasje të mëparshme për shkak të marrëdhënieve familjare;

• projektet pilot të zbatohen fillimisht në zonat rurale e urbane të qarqeve të mëdha: Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër e Korçë si qytetet më me shumë probleme të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare;

• të zbatohet një projekt i veçantë, me fokus në studime, fushata ndërgjegjësimi, programe trajnimi e punësimi në qarkun e Lezhës;

• të gjitha programet, projektet, fushatat apo bashkëpunimet institucionale e sociale t'i referohen konflikteve në çift, raportit mes femrës e mashkullit, me fokus te meshkujt, si bashkëshortë dhe si vëllezër.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

• Nga të gjitha rastet e referuara në bazat e të dhënave, të mundësohen trajnime të personave që janë autorë apo viktimë e dhunës në familje. Këto trajnime të jenë të veçanta dhe të ndara në dy pjesë: trajnime në çift dhe terapi familjare. Nevojiten trajnime të thelluara të konflikteve në çift, sidomos mes bashkëshortëve e bashkëjetuesve, në mënyrë që:

- së pari, të nxitet raportimi më i shpeshtë i tyre dhe,
- së dyti, të trajtohen gjerësisht dhe profesionalisht nga profesionistët sipas standardeve të ecurisë së çështjes (punonjësit e policisë, punonjësit socialë, psikologët, mjekët, ndërmjetësit, avokatët, etj.) në mënyrë që çështjet mos të mbeten deri tek niveli i dhënies së urdhrit të mbrojtjes.

• Rekomandohet të evidentohen dhe të shtohen në numër qendrat publike apo strehimoret që drejtohen nga OJF-të për rehabilitim të personave viktimë apo dëshmitarë të konflikteve e dhunës apo dëshmitarë të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në familjet e tyre.

- Hartimin e kurikulave mësimore, programeve mësimore dhe trajnimeve në shkolla 9-vjeçare, të mesme, në universitete në kuadër të edukimit të një kulture kundër dhunës në familje si dhe në Akademinë e Sigurisë për mënyra të analizës së konflikteve, dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare e të menaxhimit të rasteve të tilla si më poshtë:

- përveç bashkëpunimit institucional dhe fushatave të ndërgjegjësimit, rekomandohen hartimi, zbatimi dhe organizimi i trajnimeve për profesionistët (punonjës policie, psikologë, mjekë, etj.) dhe programeve të veçanta në kurikulat mësimore për trajtim dhe menaxhim të konflikteve që në nivelet bazë të shkollimit;

- hartimi i kurikulave dhe implementimi i tyre në programe të veçanta në shkollat 9-vjeçare e të mesme për teknikat dhe mënyrat e komunikimit në familje e në shoqëri; për menaxhimin e stresit; për konfliktet dhe menaxhimin e tyre, etj., në mënyrë që të fillojë një proces i gjatë edukimi për të eliminuar kulturën e dhunshme që në hapat e parë të shkollimit;

- trajnime të detyrueshme e specifike operatorëve të policisë të cilëve u vjen njoftimi për incidentet në familje, si dhe punonjësve përkatës që ndërhyjnë në vendngjarje;

- këto trajnime të jenë pjesë e kurikulave mësimore në ciklet e shkollimit në Akademinë e Sigurisë dhe në “Planin vjetor të trajnimeve”;

- të shtohen në trajnime tematika me karakter procedural, social e psikosocial, të profilit psikologjik të autorit ose viktimës, për trajtimin e viktimës, për pasqyrimin e ndryshimeve në legjislacion, etj.;

- trajnime të vazhdueshme të punonjësve të policisë:

- për komunikim më të mirë,

- për menaxhim të stresit dhe menaxhim të incidenteve,

- për ruajtjen e vetëkontrollit,

- për zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve,

- për praktika rastesh dhe praktika e procedura për dhënien e urdhrave të mbrojtjes,

- për praktika policore në lidhje me ndërhyrjen në vendngjarje në rastet e dhunës e vrasjeve në familje;

- programet dhe modulet e trajnimit rekomandohen të hartohen, të përshtaten e të zhvillohen edhe në organet e pushtetit vendor apo në strukturat e posaçme të Ministrisë së Drejtësisë, Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme, me orientim konfliktet, dhunën

e vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare dhe rolin e tyre kundrejt kësaj dukurie;

- rekomandohet në mënyrë të veçantë ofrim i trajnimeve të specializuara për profesionin apo punën, në mënyrë që të përmbushet boshllëku i arsimimit tek meshkujt 31-50 vjeç.

- Rritjen e rolit të profesionistëve të shëndetit mendor dhe punonjësve të fushave sociale (*psikolog, punonjës social, sociolog, terapist, etj.*), për nxitjen e vlerësimit dhe përforcimit të ushtrimit të rolit të tyre në parandalimin e dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si më poshtë:

- Të përforcohet roli i punonjësit social, psikologut, sociologut, terapistit, psikiatrit e mjekëve në parandalimin e dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në dy drejtime kryesore:

- së pari, të përforcohet dhe të nxitet roli e funksioni i tyre apo të zgjerohet numri i punonjësve të tillë në institucionet ku punojnë nga politikat e vetë institucioneve përkatëse;

- së dyti, të realizohet një bashkëpunim i organizuar i punonjësve të policisë, organeve të pushtetit vendor dhe sistemit të drejtësisë me këta profesionistë, sipas funksioneve të tyre;

- të organizohen projekte me fokus te fushatat për ndërgjegjësim të njerëzve dhe promovim të kulturës së të vizituarit te këta profesionistë, sipas një planifikimi të organizuar, në kuadër të përmirësimit të shëndetit emocional e mendor të shoqërisë në tërësi dhe kjo do të përbënte një ndër elementët më thelbësorë të parandalimit të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- *Rritja e shkallës së informimi të komunitetit për punën që bëhet për parandalimin dhe reduktimin e krimit të përgjithësi dhe në këtë kuadër edhe të dhunës ekstreme e të vrasjeve në familje.*

Kjo do të ndikojë në rritjen e shkallës së objektiviteti në perceptimin e nivelit të sigurisë dhe të krimeve në familje dhe në rritjen e nivelit të kënaqësisë së publikut për punën e Policisë së Shtetit.

Prognozë e përafërt për ecurinë e kësaj dukurie në të ardhmen

Dukuria e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në vendin tonë do të vazhdojë të ketë shifra të ulëta në raport me dhunën e konfliktet, por në linja të vazhdueshme, sidomos në raportet në çift. Kjo për shkak të problemeve të mëdha social ekonomike, vetëgjyqësisë dhe mangësive në menaxhimin e situatave stresuese e konfliktuale që lidhet me nivelin e ulët ekonomik, kulturor e arsimor. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së rekomanduar për koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare do mundësojë që, të paktën për një periudhë afatmesme 5-vjeçare, shoqëria shqiptare të ndërgjegjësohet e të ballafaqohet seriozisht me pasojat e kësaj dukurie. Ky do të jetë fillimi i një investimi serioz për parandalimin e kësaj dukurie në të ardhmen, me ndikime në sigurinë publike.

3.4 Projekti kërkimor “Krimi dhe kërcënimi kibernetik në Shqipëri. Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

Zhvillimi i vrullshëm i komunikimit masiv në hapësirën kibernetike (virtuale), sidomos pas vitit 2000, po i përball strukturat e Policisë së Shtetit, të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit si dhe strukturat e sigurisë me një problematikë të re, në një rritje progresive të veprave penale në fushën kompjuterike, por edhe të kërcënimit kibernetik.

Shafa, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Veprat penale në fushën kompjuterike, janë aktivitete kriminale të zhvilluara në rrjete që kanë si objekt keqpërdorimin e sistemeve dhe të dhënave kompjuterike. Kjo formë e re e veprimtarisë kriminale, e njohur ndërkombëtarisht dhe e pranuar edhe në Shqipëri si krimi kibernetik është e vështirë për t'u hetuar. Ato kanë një shkallë të ulët zbulimi.

Në vendin tonë, në vitin 2017, krahasuar me vitin 2010, janë evidentuar 3.3 herë më shumë vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike dhe me një nivel zbulimi vetëm 27%. Kjo veprimtari kriminale paraqet vështirësi për t'u gjurmuar dhe ndjekur sepse nuk kufizohen nga kufijtë kombëtarë gjeografikë. Autorët e këtyre veprave penale mund të gjenden fizikisht në vende të ndryshme nga ato ku mund të vijnë pasojat e veprimeve të tyre, ndërkohë që legjislacionet, përgjithësisht, kufizohen brenda territorit vendas. Krimet kompjuterike kanë disa veçori në mënyrën se si ndodhin dhe se si organizohen. Këto krime mund të përgatiten nga kudo dhe kundrejt çdo përdoruesi të kompjuterit, kërkojnë resurse të vogla materiale e humane, kryhen në kohë relativisht të shkurtër, me ose pa praninë e autorit në vendin e kryerjes së veprës penale, si dhe aftësimi për përdorim të kompjuterit nuk është i shtrenjtë dhe është i qasshëm nëpërmjet rrjeteve e programeve kudo në botë.

Ndërkohë, janë rritur ndjeshëm kërcënimet/sulmet kibernetike, si përpjekje të qëllimshme për të marrë qasje hyrëse, për të manipuluar, ndërhyrë ose dëmtuar integritetin, besimin, sigurinë ose gjindshmërinë e të dhënave të sistemeve kompjuterike, pa pasur autoritet ligjor për ta bërë këtë. Kërcënimet mund të kenë origjina të ndryshme, duke përfshirë sulme kriminale, të motivuara politikisht, sulme terroriste apo të sponsorizuar nga shtetet si dhe fatkeqësi natyrore e gabime të paqëllimshme. Kriminelët kibernetikë po përdorin metoda gjithnjë e më të sofistikuar për t'u futur në sistemet e informacionit dhe vjedhjen e të dhënave kritike. Rritja e spiunazhi ekonomik dhe aktiviteteve të sponsorizuara nga shteti në hapësirën kibernetike përbëjnë një kategori të re të kërcënimeve për qeveritë dhe kompanitë e BE-së.

Mbrojtja nga kërcënimet e reja të kufijve virtualë dhe rrjeteve e sistemeve është çështje e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Në këtë kontekst, është i pazëvendësueshëm roli i ekzekutivit për të koordinuar punën që nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit të ndikojë në vetëdijësimi dhe fuqizimin e të gjithë niveleve të shoqërisë shqiptare për tu përballur me kërcënimin kibernetikë në rritje.

Ashtu siç është e pafund lista e shërbimeve që ofron përdorimi i internetit dhe hapësirës kibernetike, po aq duket së janë dhe rreziqet që mund të kërcënojnë këto shërbime nëse keqpërdoret interneti dhe hapësira kibernetike. Interneti i ka dhënë edhe kriminelëve një platformë për tu rritur dhe përhapur në hapësirën kibernetike. Sot nuk mund të flitet ndaras për krimin kompjuterik apo sigurinë kibernetike por për individ *cybercitizens* - qytetarë digjital, dhe familje, shoqëri, organizata, kombe, kriminalitet, kërcënime e siguri, të gjitha së bashku në një hapësirë kibernetike. *Për këtë u hartuar dhe u zbatua projekti kërkimor "Krimi dhe kërcënimi kibernetik në Shqipëri. Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave".*

Në funksion të këtij projekti është realizuar trajtimi, skanimi dhe analizimi i dinamikës së krimit dhe kërcënimit kibernetik në Shqipëri, në këndvështrim historik e kriminologjik, juridik, penal e procedural, social e psikosocial, analitik e statistikor, në raport me sigurinë publike e atë kombëtare. Gjithashtu është realizuar një analize krahasuese nisur nga treguesit objektiv (të dhënat reale nga agjencitë e zbatimit të ligjit) dhe treguesit subjektiv (perceptimet e shoqërisë shqiptare për to, për këtë problem dhe nivelin e

kënaqësisë së tyre për punën e agjencive të kanë këtë objekt pune), të gjitha këto me synim evidentimin e problematikave, faktorëve ndikues si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin e reduktimin e tyre, në shërbim të përmirësimit të mëtejshëm të procesit të një policimi bazuar në inteligjencë dhe të sigurisë tonë kombëtare.

Në përfundim të këtij projekti është arritur në përfundimet e janë dhënë rekomandimet e përgjithshme si më poshtë:

- Zgjerimi i përdorimit të teknologjisë informacionit dhe komunikimit do të shoqërohet në vazhdimësi me rrezikun dhe kërcënimin e krimit kibernetik. Intensiteti dhe pasojat e kësaj përballjes mes tyre do të varet në një masë të madhe nga suksesi në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme si në sektorin publik dhe atë privat për tu përballur me këtë dukuri si dhe nga shkalla e ndërgjegjësimit dhe edukimit të përdoruesve të kësaj teknologjie për sigurinë kibernetike.

- Termi “krim kibernetik” është terminologji më shumë profesionale se sa juridike. Ky term përfshin përdorimin e kompjuterëve në ndihmë të autorëve për realizimin e veprave penale tradicionale si dhe veprat penale të cilat janë plotësisht produkte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

- Vetëm pas 6 vitesh të ratifikimit të “Konventës për krimin kibernetik”, Kuvendi i Shqipërisë miratoi paketën ligjore për ndryshimin e *Kodit penal* duke përfshirë për herë të parë veprat penale kompjuterike, të cilat nuk janë të grupuara apo të vendosura në një seksion më vetë, por janë të shpërndara nëpër seksionet ekzistuese në varësi të objektit juridik të mbrojtur.

- Ka një trend në rritje në evidentimin e veprave penale në fushën e krimeve kompjuterike ndërkohë që niveli i zbulimit të këtyre veprave penale është i ulët në raport me veprat e tjera penale.

- Për periudhën 2012-2018 niveli mesatar i zbulimit të këtyre veprave penale është 37.32%, me një trend në rënie, por me një ngritje të lehtë në vitin 2018.

- Format më e përhapur e krimit në këtë fushë është mashtrimi kompjuterik me 33.9%, ndërhyrja e të dhënave kompjuterike me 28.9% dhe falsifikimet kompjuterike me 20.7% të totalit të veprave penale në këtë fushë për vitet 2015-2018.

- Referuar treguesve objektiv të kriminalitetit në këtë fushë (të dhënave të evidentuara nga policia dhe prokuroria) mund të përcaktojmë këtë profil të autorëve të krimeve kibernetik: Kryesisht i përkasin moshës 18 deri 35 vjeç (67.7%). Pjesa më e madhe e tyre janë të gjinisë mashkullore (rreth 90%), me arsim 9-vjeçar (47.5%) dhe me arsim të mesëm (35.7%). Shumica e tyre (77.2%) janë ndjekur në gjendje të lire dhe vetëm 10% në gjendje arresti.

- Sigurinë kibernetike mund ta përkufizojmë si “ruajtje të konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informatave në hapësirën kibernetike”.

- Siguria kibernetike është pjesë përbërëse e sigurisë kombëtare, pasi ajo mbështet mirëfunksionimin e shtetit dhe shoqërisë si dhe konkurrencës e ekonomisë dhe inovacionin. Në strategjinë tonë të sigurisë kombëtare sulmet kibernetike klasifikohen si rreziqet të nivelit të parë.

- Hapësira kibernetike sot është një komponent i rëndësishëm dhe konkret i sigurisë kombëtare, ashtu si dhe hapësira ajrore, detare e tokësore. Për këtë rekomandohet ngritja e strukturave dhe mekanizmave sa më efikas për të garantuar dhe menaxhuar sigurinë në këtë hapësirë.

- Ka mangësi në rregullimin ligjor ndërkombëtar për të zgjidhur konfliktin ndërmjet

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

sovrانيتetit dhe juridiksionit në hapësirën kibernetike. Për këtë është e rekomandueshme marrja e nismave në nivel global nga OKB apo organizata të tjera ndërkombëtare për unifikimin e ligjeve që normojnë veprimtarinë dhe që mbrojnë sigurinë në hapësirën kibernetike.

- Ekziston pasiguria për të nesërmen në fushën kibernetike, referuar kjo rrezikut që është prezent nga veprime të jashtëligjshme që synojnë individin, biznesin, industrinë dhe strukturat e qeverisjes (qendrore/lokale). Për këtë rekomandohet hartimi dhe zbatimi i politikave kombëtare që nxisin përgatitjen e brezit të ardhshëm në përgjithësi dhe të ekspertëve të mirëfilltë në veçanti në fushën kibernetike.

- Niveli i vlerësimit të rrezikut me qëllim zhvillimin e politikave dhe strategjive të qenësishme (joutopike) nuk janë në nivelin me të cilin zhvillohet teknologjia dhe me qasjen e individit/shoqërisë ndaj teknologjisë në vend.

- Është i pazëvendësueshëm roli i ekzekutivit për të koordinuar punën që nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit të ndikojë në vetëdijesimi dhe fuqizimin e të gjithë niveleve të shoqërisë shqiptare për tu përballur me kërcënimin kibernetikë në rritje dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të informacionit si dhe vetë infrastrukturën kritike të vendit.

- Për këtë, rekomandohet shtimi i investimeve për rritjen e sigurisë në rrjetet e sistemet shtetërore të TI-së; krijimi i një sistemi alarmi dhe reagimi kombëtar në rast incidentesh si dhe shtimi i punonjësve të kualifikuar e të trajnuar për çështjet e kibernetikës në mbrojtjen e infrastrukturës kritike të informacionit si dhe vetë infrastrukturën kritike të vendit.

- Ka mungesë bashkëpunimi ndërinstitucional (përfshirë individin dhe sistemin bankar) duke mos bërë të mundur ndërveprimin në kohë reale (*online*) për parandalimin (certifikimi i pajisjeve duke shmangur përdorimin e programeve pirate), evidentimin (evidentimi nëpërmjet instalimit të antivirusit ose programeve sinjalizuese (interceptuese), raportimin (sensibilizimi/trajnimi për mënyrën dhe kohën e denoncimit të një veprimi të paligjshëm që ndodh nëpërmjet përdorimit të PC ose internetit) dhe ruajtjen e të dhënave në mënyrë të përdorshme.

- Për këtë rekomandohet nxitja e bashkëpunimit publik-privat në fushën e sigurisë kibernetike si dhe ndërgjegjësimi i sektorit privat për të kuptuar që siguria kibernetike për sektorin privat nuk ka të bëjë vetëm me krimin kibernetik apo standardet e sigurisë së tyre, por edhe me sigurinë kombëtare të vendit.

- Shumica e të anketuarve mendojnë se zhvillimi i teknologjisë së sotme të informacionit dhe komunikimit luan rol të rëndësishëm në të gjithë aspektet e jetës duke përfshirë biznesin, komunikimin dhe edukimin, qasjen në informacion e shërbime publike dhe në fushën e privatësisë. Për shumicën e të anketuarve ky zhvillim teknologjik, cenon privatësinë ndërkohë që për një pjesë të konsiderueshme të anketuarve (31.7%) komunikimi nëpërmjet kësaj teknologjie nuk është aspak i sigurt ose është pak i sigurt.

- Është relativisht e lartë (36.8%), pjesa e të anketuarve që nuk kanë njohuri për krimin kibernetik. Për shkak të mungesës së njohurive në këtë fushë kjo pjesë mund të bëhet lehtësisht objektiv për veprat penale në fushën kompjuterike. Sa më sipër, rekomandohet që të gjenden rrugët për rritjen e nivelit të njohurive për legjislacionin në fushën e krimit kibernetik si një rrugë për rritjen e sigurisë kibernetike.

- 24.9% e të anketuarve (6.3% + 18.6%) janë përgjigjur se kanë kryer, ose nuk e dinë nëse kanë kryer ndonjëherë veprë penale në jetën e tyre, - shifër kjo relativisht e lartë, - me të cilët duhet punuar për t'i aftësuar që të njohin krimin kompjuterik.

- Sulmet me viruse, vjedhjet e identitetit dhe mashtrimet kompjuterike janë

kërcënimet më të përhapura ndaj të anketuarve.

- Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (22.6%) kanë përjetuar pasoja të krimeve kibernetike më shumë në formën e humbjes së të dhënave kompjuterike (23.6%), vjedhje të identitetit (18%) si dhe forma të tjera të pasojave (59.9%).

- Të anketuarit dënojnë më shumë ato krime kibernetike apo edhe sjellje kriminale në këtë fushë, nga të cilat ata mund të cenohen individualisht dhe kriminalizojnë më pak ato në të cilat ata janë përfitues si p.sh. shkarkimi i programeve kompjuterike dhe shkarkimi i filmave dhe muzikës, përdorimi i paautorizuar i programeve kompjuterike etj.

- Të anketuarit nuk kanë kërkuar asistencë pranë autoritetit kryesor kombëtar të sigurisë kibernetike në rastet e përjetimit të pasojave nga krimet kibernetike. Gjithashtu, konsiderohet jo i vogël edhe numri i të anketuarve që nuk e njohin fare atë institucion.

- Të anketuarit nuk ndjehen të sigurt në aktivitetet e tyre të ndryshme në hapësirën kibernetike në masën nga 21.2% deri në 47.1%.

- Në një numër të konsiderueshëm (47%) të anketuarit nuk ndjejnë “aspak” përgjegjësi apo ndjejnë “pak” dhe “disi” përgjegjësi për sigurinë kibernetike në vendin e tyre të punës.

- 83% e të anketuarve nuk janë trajnuar për sigurinë kibernetike në vendin e tyre të punës dhe vetëm 22.5% e të anketuarve që janë trajnuar, kanë përfituar nga ky trajnim për sigurinë kibernetike. Ky tregues, relativisht i lartë tregon se vetë organizatat punuese nuk e vlerësojnë sigurinë kibernetike.

- Duke marrë parasysh se shumica e të anketuarve i përkasin sektorit publik, arrijmë në përfundimin se ka mangësi në angazhimin e strukturave shtetërore, për trajnimin e punonjësve të tyre për sigurinë kibernetike në vendin e punës si dhe për cilësinë e këtyre trajnimeve. Për këtë rekomandohet fillimi i trajnimit të punonjësve për sigurinë kibernetike në vendin e tyre të punës.

- Sipas të anketuarve fushat ku duhet investuar për të përmirësuar sigurinë kibernetike janë edukimin që në shkollë për parandalimin e krimit në internet; në menaxhimin e sigurisë kibernetike; në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë; në ligjet dhe politikat mbi krimin kibernetik dhe në rreziqet dhe efektet e krimit kibernetik.

- Shumica e të anketuarve (71.4%) do ta raportonin nëse do të hasnin një rast të krimit kibernetik. Ndërkohë mund të konsiderohet përsëri e lartë (27.1) shifra e atyre që janë të pavendosur për ta raportuar një rast të tillë. Për këtë rekomandohet që të gjenden mënyrat për ndërgjegjësimin edhe të kësaj kategorie për të raportuar raste e hasura të krimit kibernetik.

- Të anketuarit do ta raportonin një rast të krimit kibernetik më shumë në Policinë e Shtetit dhe Autoritetin për Sigurinë Kibernetike⁶ dhe më pas në Prokurori; Avokatin e Popullit dhe SHISH.

- Të anketuarit i vlerësojnë si hapa të domosdoshëm për të parandaluar rritjen e rasteve të krimeve kibernetike në masën mbi 94% ofrimin e trajnimit të duhur të oficerëve të zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik; rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë; shtimin e numrit të oficerëve të zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik; ndryshimet e duhura ligjore; ndryshimet e duhura

⁶ Vlen të theksohet se, pas marrjes së informacionit të duhur gjatë procesit të anketimit, ka rritje të besimit tek Autoritetin për Sigurinë Kibernetike. Kjo pasi në fillim të pyetësorit pyetjes nëse kanë raportuar apo kërkuar asistencë në këtë institucion i janë përgjigjur pozitivisht vetëm 2.1%, ndërkohë që 55% nuk kanë raportuar e kërkuar asistencë, 21.1% nuk e njohin fare atë institucion.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

strukture; rritjen e bashkëpunimit publik-privat në këtë fushë; përfshirjen e njohurive mbi veprat penale kompjuterike në programet shkollore si dhe ashpërsimin e dënimeve ndaj autorëve të këtyre veprave penale.

- Rekomandohet që fushatat sensibilizuese/trajnimet duhet të jenë periodike, intensive si edhe të përgatitura për të qenë të asimilueshme nga audienca të ndryshme dhe nëpër mjete të ndryshme të komunikimit, nisur kjo nga shkalla e përdorimit të teknologjisë për kategori të ndryshme.

- Rekomandohet gjithashtu që institucionet kërkimore shkencore të studiojnë dhe dhe gjejnë format e metodat e duhura për të nxitur pjesëmarrjen e punonjësve të profesioneve të ndryshme e të shtresave të ndryshme të popullsisë për (nëpërmjet anketimeve apo instrumenteve të tjerë kërkimore) në procesin e hartimit të politikave për probleme të luftës kundër krimit, çështjeve të sigurisë dhe jo vetëm, si një shprehje e rritjes së përgjegjësisë së tyre sociale.

Prognozë e përfaqërt lidhur me zhvillimet e pritshme në këtë fushë

Rreziku dhe kërcënimi i krimit kibernetik do të vazhdojë të jetë evident me trend në rritje në Shqipëri. Pasoja e tij do të fillojnë të kufizohen në një periudhë afatmesme vetëm nëse do të jemi të suksesshëm në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për ti parandaluar ato dhe për të eliminuar pasojat me sa më pak humbje si dhe nëse do të bëjmë hapa konkret për edukimin, ndërgjegjësimin e vetëdijësimin e publikut të gjerë dhe të punonjësve të institucioneve publike e private, përdorues të teknologjisë së informacionit, më njohuritë dhe konceptet më të domosdoshme për krimet kompjuterike dhe sigurinë kibernetike.

3.5 Projekti kërkimor “Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”

Duke marrë shkas nga perceptimi i një tendence në rritje e të aksidenteve rrugore me pasojë humbje të jetëve njerëzore, vëmendja e madhe dhe përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me çështje të sigurisë rrugore, ndikimi i tyre në çështjet e rendit dhe të sigurisë në vendin tonë si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfilltë e të thelluar në këtë këndvështrim, Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë planifikoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “*Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave*”. Qëllimi i këtij punimi është skanimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me aksidentet automobilistike e sigurinë rrugore, si dhe të faktorëve ndikues, me synim dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e aksidenteve e përmirësimin e sigurisë rrugore.

Aksidentet automobilistike dhe pasojat që i shoqërojnë ato (traumat sociale, humbjet e mëdha ekonomike dhe jo vetëm) po perceptohen si rrezik e kërcënim permanent jo vetëm për këmbësorët e drejtuesit e mjeteve të transportit, por dhe për sigurinë publike e më gjerë. Për këtë siguria rrugore duhet kuptuar e vlerësuar si një e mirë publike dhe personale, pjesë e rëndësishme e sigurisë publike e kombëtare, e pranuar dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut. Procesi i sigurisë rrugore është një ndërveprim i vazhdueshëm midis disa faktorëve ku ndër më kryesorët janë sjellja e përdoruesve të rrugëve, siguria dhe kushtet e infrastrukturës rrugore si dhe karakteristikat e automjeteve. Ajo është një ndërthurje mes sigurisë parandaluese (parandalimin e aksidenteve) me

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

sigurinë reaktive (rikuperimin e një situatë emergjente).

Nga studimi i dokumenteve të shumta arkivore, të cilat janë prezantuar në këtë projekt kërkimor, kemi provuar se në Shqipëri për periudhën 1953-1990 janë evidentuar 5622 aksidente me rreth 3236 të vrarë e 5063 të plagosur. Ndërsa nga viti 1992 deri në vitin 2018 janë evidentuar 28915 aksidente, me 8180 të vrarë e 16004 të plagosur. Aksidentet rrugore me pasojë vdekjen renditen si faktori numër një që u merr jetën shqiptarëve. Kështu për periudhën 2005-2015 nga 7044 vetë që kanë humbur jetën në mënyrë të dhunshme (vrasje, vetëvrasje dhe aksidente rrugore), 3341 ose 47.4% e numrit total e kanë humbur jetën nga aksidentet automobilistike, krahasuar me vetëvrasjet të cilat përbënin 34% të rasteve dhe 17.95% të rasteve që e kanë humbur jetën si pasojë e krimit të vrasjes.

Në kushtet e një mjedisi në ndryshim e zhvillim të shpejtë ekonomik, i cili nuk mund të kuptohet pa rritjen e transportit rrugor, është shtuar shumë presionin pozitiv mbi strukturat e Policisë së Shtetit për më tepër siguri rrugore. Në këto kushte, është i domosdoshëm identifikimi i problematikave që lidhen me sigurinë rrugore si dhe i faktorëve ndikues, me synimin dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e aksidenteve e forcimin e sigurisë rrugore.

Gjatë këtij projekti kërkimor shkencor dhe në hartimin e studimit në përfundim të tij janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore. Analizimin dhe vlerësimin e sigurisë rrugore në vendin tonë në këtë projekt, e kemi bërë duke u bazuar në dy shtylla kryesore. E para, duke u bazuar në treguesit objektivë, aksidentet rrugore të evidentuara realisht, pasojat e shkaqet e tyre. Për këtë janë bërë kërkime dhe administruar të dhëna për një periudhë rreth 100 vjeçare të shtetit shqiptar. Kjo me qëllim jo vetëm për të analizuar dinamikën në vite të këtyre aksidenteve, por dhe që të arrijmë të identifikojmë ata faktorë ekonomikë, socialë e psikologjikë të përsëritshëm në periudha të ndryshme, që kanë ndikuar në tipologjinë e aksidenteve rrugore, sjelljen e përdoruesve të rrugës si dhe në profilin e autorëve dhe të viktimave të aksidenteve rrugore. E dyta, duke u bazuar në treguesit subjektivë, perceptimet e qytetarëve për sigurinë rrugore, sjelljet e përdoruesve të rrugës në Shqipëri si dhe nivelin e kënaqësisë e vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë sigurinë rrugore. Kjo pasi edhe për sigurinë rrugore, ashtu si për sigurinë në përgjithësi perceptimi, përjetimi dhe kënaqësia janë elementë shumë të rëndësishëm. Këto të dhëna janë siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë të realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë gjatë muajit Prill 2019.

Në përfundim të projektit janë dhënë gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave lidhur me mënyrën e trajtimit, menaxhimit, parandalimit dhe reduktimit të aksidenteve dhe përmirësimin e sigurisë rrugore në vendin tonë si më poshtë:

a. Nga analiza e gjetjeve të treguesve objektiv, të dhënave statistikore të mesatareve vjetore të periudhave analizuese, të aksidenteve, ta vrarëve e të plagosurve në këto aksidente, është arritur në përfundimin se:

- numri i aksidenteve automobilistike nga viti 1947 deri 2018 ka pasur një trend të vazhdueshëm në rritje;
- numri i të vrarëve dhe të plagosurve në aksidentet automobilistike ka ardhur në vazhdimësi në rritje;
- në periudhën 2011-2018 evidentohet fillimi i një trendi në rënie të numrit të vrarëve dhe të plagosurve në aksidentet automobilistike;

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

- trajtimi brenda konceptit *siguri*, i kësaj dukurie dhe ndjekja me një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse (2011-2020) filloi të japë rezultatet e para të një trendi në rënie të numrit të varrëve dhe të plagosurve në aksidentet automobilistike.

Në analizë të shkaqeve të aksidenteve për periudhat analizuuese (1947-2018) është arritur në përfundimin se si shkaqe të përsëritshme në të gjithë periudhat janë shkaqe që lidhen:

- *me përgjegjësinë e drejtuesve të mjeteve dhe konkretisht:*
 - shpejtësia e lëvizjes së automjeteve,
 - shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor prej tyre duke mos respektuar rregullat në këmbim, mbajtur krahun në parakalim,
 - përdorimi automjeteve pa leje drejtimi,
 - udhëtimet me mungesa teknike të mjeteve,
 - përdorimi i pijeve alkoolike gjatë drejtimit të mjetit;
- *me gjendjen e infrastrukturës rrugore:*
 - rrugë të dëmtuara e të amortizuara,
 - mungesa e shenjave sinjalizuese rrugore,
 - mosmarrja e masave për rregullimin e “pikave të zeza” të njohura si vende aksidentesh;
- *me veprimet e qytetarëve si përdorues të rrugës:*
 - shkelja e rregullave të trafikut nga qytetarët,
 - ndërprerja e menjëhershme e rrugës prej tyre e sidomos prej fëmijëve;
- *me përgjegjësinë e punonjësve të policisë së qarkullimit rrugor:*
 - puna e pamjaftueshme e punonjësve të qarkullimit rrugor në kontrollin e akteve rrugore;
- *me mangësitë në punën parandaluese për aksidentet automobilistike:*
 - mangësi në edukimin dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve të rrugës për zbatimin e legjislacionit lidhur me qarkullimin rrugor,
 - mangësi në edukimin e fëmijëve në këtë fushë;
- *me mangësitë në infrastrukturën ligjore:*
 - infrastrukturë ligjore e kompletuar gjithmonë me vonesë;
 - ndryshime të shpeshta të kodit rrugor.

b. Nga analiza e treguesve subjektivë, perceptimet e qytetarëve për sigurinë rrugore, sjelljet e përdoruesve të rrugës në Shqipëri si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë sigurinë rrugore, të siguruara nëpërmjet një anketimi të gjerë të realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë gjatë muajit prill 2019 është konkluduar se:

- Shumica e të anketuarve (92.48), e perceptojnë dhe e vlerësojnë sigurinë në rrugë aspak dhe pak të sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës, shifër kjo shumë e lartë. Vetëm 7.52% e të anketuarve e vlerësojnë shumë të sigurt. Për këtë rekomandohet që krahas masave për parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve automobilistike, duhet të punohet paralelisht, që kjo punë, të ndikojë në përmirësimin e perceptimeve të tyre për sigurinë rrugore sepse në fund të fundit, siguria është dhe perceptim.

- Pjesa më e madhe e të anketuarve (63.53%), ndjehen më të shqetësuar se mund t’u ndodhë një aksident rrugor se sa një vjedhje në shtëpi apo ngjarje tjetër kriminale. Pra, aksidentet perceptohen nga qytetarët si kërcënimi kryesor për sigurinë e tyre. Kjo

tregon ndjeshmërinë dhe kërkesat në rritje të komunitetit për sigurinë rrugore si një e mire publike dhe personale.

- Shumica e të anketuarve (91.69%) ndihen në masën aspak dhe pak të sigurt si këmbësorë në rrugët e Shqipërisë shifër kjo shumë e lartë.

- Shumica e të anketuarve (62.23%) ndihen aspak dhe pak të sigurt në rrugët e Shqipërisë si drejtues mjeti, shifër kjo e lartë. Krahësuar me statusin e këmbësorit kjo shifër është 29.46% më e ulët se në rastin e këmbësorëve. Pra, drejtuesit e mjetit ndjehen më të sigurt se këmbësorët.

- Një numri relativisht të lartë të anketuarve (28.32%) u ka ndodhur të pësojnë aksident për shkak të kushteve të rrezikshme të rrugës. Kjo tregon për problematikat e mëdha të rrugëve në Shqipëri, si një nga komponentët e rëndësishëm të sigurisë rrugore në Shqipëri si dhe për përgjegjësinë e enteve administruuese të rrugëve

- Të anketuarit kanë vlerësuar se faktori që kërcënon më shumë sigurinë rrugore është sjellja e përdoruesve të rrugës në masën 39.8%; gjendja e keqe e rrugëve në masën 19.6%; mungesa e shenjave sinjalizuese rrugore në masën 17.8%; përdorimi i alkoolit/drogës gjatë udhëtimit në masën 11%, prezenca e ulët e policisë në rrugë në masën 6.5%, ndriçimi i keq në masën 4.5% si dhe mungesa e mirëmbajtjes së mjeteve në masën 0.8%. Për këtë rekomandohet se drejtimet kryesore nga ku duhet investuar më shumë për të ulur nivelin e kërcënimit ndaj sigurisë rrugore është puna për përmirësimin e sjelljes së përdoruesve të rrugës, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rregullimin e shenjave sinjalizuese rrugore, forcimi i kontroleve dhe penalizmi i përdorimit të alkoolit e drogës gjatë udhëtimit, rritja e efikasitetit të shërbimeve të policisë rrugore, përmirësimin e ndriçimit të rrugëve dhe kontrollin autoteknik të mjeteve.

- Ka një përgjegjshmëri më të madhe për sigurinë rrugore si një e mirë personale dhe për shpejtësinë e të ngjarit të automjeteve si kërcënim për të. Kjo duket pasi 16.59% e të anketuarve e kanë ulur shpejtësinë dhe 40.65% e tyre kanë ruajtur atë nivel shpejtësie ndërsa vetëm 4.48% e tyre e kanë rritur shpejtësinë në vitin e fundit.

- Për pjesën më të madhe të anketuarve (62.31%) është bërë pak për të ulur nivelin e rrezikshmërisë në qarkullimin rrugor, ndërkohë që 25.71% e të anketuarve janë të kënaqur dhe mendojnë se është bërë shumë në Shqipëri për të ulur rrezikshmërinë në qarkullimin rrugor.

- Për pjesën më të madhe të anketuarve (60.48%) puna e policisë së qarkullimit rrugor është e suksesshme dhe shumë e suksesshme. Kjo tregon për një nivel relativisht të mirë të kënaqësisë së publikut për punën e policisë së qarkullimit rrugor dhe përmbushjes së saj në rritje. Gjithsesi rekomandohet intensifikimi i punës parandaluese të kësaj strukture jo vetëm për të bindur 20.5% të atyre që nuk prononcohen, por dhe të ndryshojë edhe perceptimin e 19% të të tjerëve që e vlerësojnë negativisht punën e saj parandaluese.

- Nga përgjigjet e të anketuarve mund të rekomandojmë si masa më emergjente për përmirësimin e sigurisë rrugore si më poshtë: fushatat për edukim e ndërgjegjësim të qytetarëve; përmirësimin e shenjave sinjalizuese rrugore; përmirësimin e kushteve të sipërfaqes së rrugës; fuqizimin e transportit publik; shtimin e gjobave për këmbësorët; rregullimin e vendeve të parkimit; përmirësimin e ndriçimit rrugor; prezencën më të shpeshtë të patrullave të policisë në rrugë; krijimin e një qendre ndërinstitucionale për menaxhimin e sigurisë rrugore; shtimin e gjobave për drejtuesit e mjeteve; përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përmirësimin e rrugëve për këmbësorët e për çiklistët.

- Për pjesën më të madhe të anketuarve (56.6%) shtimi i gjobave iu jep pak ose nuk

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

iu jep aspak siguri si përdorues rruge, ndërkohë mund të konsiderohet relativisht e lartë (35.05%) edhe pjesa e anketuesve që mbështesin këtë si masë që iu jep siguri si përdorues rruge.

- Për pjesën më të madhe të anketuarve (69.36%) çështjet e sigurisë rrugore përbëjnë interes për pjesën dërmuese të qytetarëve në zonat ku ata banojnë. Për të arritur standardet e sigurisë rrugore, ajo duhet të jetë e trajtuar si çështje sigurie dhe të ndiqet me politika agresive.

- Rreth një e treta e të anketuarve (29.95%) janë shumë dakord që, kush shkakton aksident me pasojë vdekjen, duhet akuzuar për vrasje ndërkohë që, pjesa më e madhe (47.72%) janë pak dakord me këtë ide. Ecuria e kësaj ideje do të ndiqet dhe me anketimet që do të zhvillohen në vitet në vazhdim. Rritja e mbështetjes për këtë mund të nxisë idenë e ndryshimeve ligjore në këtë fushë.

- Pjesa më e madhe e të anketuarve (76.01%) nuk kanë aspak ose kanë pak besim për marrjen e masave konkrete për rritjen e sigurisë rrugore në të ardhmen e afërt. Për këtë rekomandohet gjetja e formave dhe metodave për rritjen e besimit të qytetarëve se masat që po merren do të ndikojnë në rritjen e sigurisë rrugore. Kjo do të ndikojë dhe në rritjen e rolit dhe përgjegjshmërisë së qytetarëve si aktorë mjaft të rëndësishëm në procesin e garantimit të sigurisë rrugore në vend.

c. Krahاسimi i gjetjeve dhe përfundimeve të analizave dhe vlerësimeve të sigurisë rrugore bazuar në treguesit objektivë dhe subjektivë.

Duke krahasuar gjetjet dhe përfundimet e analizave dhe vlerësimit të sigurisë rrugore mbi bazën e treguesve objektivë, pra të të dhënave reale të administruara nga strukturat policore për një periudhë afatgjatë, nga viti 1945 deri në vitin 2018 si dhe të treguesve subjektiv, pra perceptimet e qytetarëve për sigurinë rrugore, sjelljet e përdoruesve të rrugës në Shqipëri si dhe nivelin e kënaqësisë e vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë sigurinë rrugore, arrijmë në përfundimin se ka ngjashmëri në vija të përgjithshme në shumë gjetje e përfundime të arritura gjatë analizimit dhe vlerësimit të sigurisë rrugore, si duke u mbështetur në treguesit objektivë, ashtu dhe në ata subjektivë.

ç. Rekomandime të përgjithshme të projektit

Nisur nga gjetjet dhe përfundimet e arritura pas analizave dhe vlerësimit të sigurisë rrugore mbi bazën e treguesve objektivë e subjektivë, me synim reduktimin e aksidenteve e pasojave të tyre dhe rritjen e parametrave të sigurisë rrugore mund të rekomandojmë më poshtë:

- *Përmirësimi i mendimit dhe veprimit strategjik për sigurinë rrugore, duke përfshirë dhe jo vetëm:*

- Siguria rrugore duhet kuptuar e vlerësuar si një e mirë publike dhe personale, pjesë e rëndësishme e sigurisë publike e asaj kombëtare, e pranuar dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut.

- Çështjet e sigurisë rrugore në Shqipëri duhet të vazhdojnë të mbahen fort brenda konceptit të sigurisë, çka do të thotë të vazhdojnë të ndiqen më strategji e masa të veçanta shtesë.

- Për këtë të realizohet një analizë e thellë në përfundim të afateve të *Strategjisë kombëtare për sigurinë rrugore*, të evidentohen problematikat e shfaqura dhe të hartohet një strategji e re për sigurinë rrugore për vitet 2021-2030, e një planveprimi 5-vjeçar, me fokus rritjen sigurisë rrugore nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës në nivel kombëtar.

- Kësaj t'i shërbejë dhe ngritja e një agencie kombëtare (qendër ndërinstitucionale)

për menaxhimin e trafikut rrugor në Shqipëri.

- Për sigurinë rrugore të investohet në dy komponentët e saj kryesor, në sigurinë proaktive (parandalimin e aksidenteve) me sigurinë reaktive (rikuperimin në një situatë emergjente).

- *Përmirësimi i punës për parandalimin e aksidenteve automobilistike duke përfshirë, dhe jo vetëm:*

- rritjen e ndërgjegjësimit, përgjegjshmërisë dhe përgjegjesisë së drejtuesve të mjeteve për respektimin dhe zbatimin kërkesave të kodit rrugor e akteve të tjera në këtë fushë;

- rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve si përdorues rruge dhe bashkëpërgjegjës për sigurinë rrugore në vend si dhe me fokus edukimin e fëmijëve me programe të veçanta në këtë fushë.

- *Përmirësimi në infrastrukturën rrugore si komponent i rëndësishëm i sigurisë rrugore, duke përfshirë dhe jo vetëm:*

- përmirësimin në vazhdimësi të rrjetit rrugor ekzistues në përgjithësi dhe i zonave të tij të rrezikshme, me synimi minimizimin dhe eliminimin e “pikave të zeza”;

- projektimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja në përputhje me direktivat e BE-së e standardet më të mira ndërkombëtare sa i përket kërkesave për sigurinë rrugore.

- *Rritje e rendimentit të punës së punonjësve të qarkullimit rrugor duke përfshirë, dhe jo vetëm:*

- rritjen e përgjegjesisë së punonjësve të qarkullimit rrugor për zbatimin e masave specifike në zonat me rrezikshmëri të lartë për aksidente automobilistike e me pasoja fatale;

- trajnimin e vazhdueshëm të tyre me synim rritjen e profesionalizimit në punë.

- *Për përmirësimin e kuadrit ligjor, duke përfshirë, dhe jo vetëm:*

- përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor me atë të BE-së dhe përdorimi i praktikave më të mira sidomos për pajisjen me leje drejtimi të drejtuesve të mjeteve, forcimin e penalteteve në këtë fushë, etj.

- *Për përmirësimin e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë rrugore, si dhe nivelin e kënaqësisë e vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë sigurinë rrugore, duke përfshirë dhe jo vetëm:*

- organizimi i matjeve vjetore të perceptimeve të qytetarëve për sigurinë rrugore pasi aksidentet perceptohen si kërcënimi kryesor për sigurinë e tyre;

- organizimi i matjeve vjetore për nivelin e kënaqësisë e vlerësimin e qytetarëve për punën e strukturave që menaxhojnë sigurinë rrugore;

- përdorimi i rezultateve të matjeve si indikator matës në përmirësimin e mëtejshëm të punës së strukturave përkatëse;

- organizimi i punës që, krahas masave për parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve automobilistike, të punohet paralelisht që kjo punë të ndikojë në përmirësimin e perceptimeve të tyre për sigurinë rrugore sepse në fund të fundit siguria është dhe çështje perceptimi.

3.6 Projekti kërkimor “Ekzaminimi në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes së botimeve profesionale e juridike e të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato”.

Me qëllim përmirësimin e punës për rritjen e nivelit profesional e juridik të oficerëve të Policisë së Shtetit, si dhe njohjen e eksperiencave më të mira në fushën e shërbimit

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

policor, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë hartoi dhe zbatoi një projekt kërkimor-shkencor për studimin dhe ekzaminimin e gjendjes së botimeve profesionale e juridike në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes reale të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato, si dhe për identifikimin e nevojave për botimet më të nevojshme e më të domosdoshme për aktivitetin e përditshëm të punonjësve të policisë e në shërbim të një policimi gjithnjë e më efektiv.

Ky projekt kërkimor kishte si objektiva kryesore: njohja tërësisht të gjendjes me botimet juridike e profesionale, në mjediset e punës së Policisë së Shtetit, (stacionet, komisarariatet e deri në drejtoritë vendore e qendrore të Policisë); thithjen e mendimeve e të sugjerimeve të grupeve të interesit (inspektorëve, menaxherëve dhe drejtuesve të policisë) për nevojat imediate në këtë fushë dhe së treti nxjerrjen e përfundime dhe dhënien e rekomandime për hartimin e politikave për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë.

Bazuar në analizën e përgjigjet e dhëna gjatë anketimit të realizuar, analizën e informacionit të bollshëm të siguruar nga kontaktet fizike dhe intervistave me personelin policor si dhe duke marrë në konsideratë edhe koeficientin e gabimit në të kuptuar apo subjektivizmin dhe kufizimet në interpretimin e fakteve, në përfundim të këtij projekti kërkimor shkencor është arritur në përfundimet kryesore se në kohën e realizimit të këtij projekti (maj 2017), në strukturat vendore të policisë:

a. Ka pasur mangësi të theksuar të mjediseve të leximit si kabinete, klasa, salla mbledhjeje të cilat mund të shfrytëzohen edhe për ngritjen profesionale, kulturore e juridike individuale të punonjësve të policisë.

Sipas anketimit vetëm në 45% të institucioneve, ambienteve apo vend dislokimeve të strukturave policore ekzistojnë mjedise leximi si kabinete, klasa, salla mbledhjeje, etj. të cilat shfrytëzohen edhe për ngritjen profesionale, kulturore e juridike individuale dhe vetëm 44.5% e këtyre sallave janë të pajisura me aparate kompjuterike e internet. Këto shifra janë të ulëta në raport me rolin që luan studimi individual, trajnimi dhe kualifikimet në procesin e rritjes së nivelit profesional të punonjësve të policisë.

b. Ka pasur mungesë të theksuar të literaturës dhe botimeve juridike e profesionale. Edhe ajo literature që ndodhe nuk ishte bashkëkohore dhe e përditësuar.

Sipas anketimit vetëm në 20 % të atyre strukturave rajonale e vendore të Policisë së Shtetit të cilat kanë salla leximi, kabinete, klasa, salla mbledhjeje ka literaturë profesionale apo juridike e cila mund të shfrytëzohet nga punonjësit e policisë. Gjithashtu 74.5% e kësaj literature nuk është bashkëkohore dhe e përditësuar.

c. Ka pasur mungesë të theksuar në literaturën ekzistuese të titujve profesionale reduktuar në 0.96% në rastin e urdhrave e udhëzimeve dhe 4.82% në rastin e procedurave standarde në dispozicion të tyre. Ndërkohë që titujt më të pranishëm janë ligji i Policisë së Shtetit 11.57% dhe kodet me 10.36%.

ç. Konstatohet indiferencë në kërkesat për literaturë juridike dhe profesionale. Kështu rreth 28.74% e të anketuarve zgjedhin të mos i përgjigjen rubrikës "Listoni pesë tituj kryesore të literaturës më të nevojshme për tu botuar për Ju, sipas përkatësisë: literaturë profesionale dhe literaturë juridike". Kjo mund të interpretohet si mangësi të theksuara në përgatitjen profesionale e juridike të tyre. Ndërkohë ata që janë përgjigjur kanë kërkuar më shumë titujt profesional 44.48% e më pak titujt të formimit juridik 26.78%.

d. Ka pasur tendencë në rritje në shfrytëzimin e librisë elektronike dhe botimeve digjitale, megjithëse afatin e shkurtër të ofrimit të këtij shërbimi në Policinë e Shtetit. Nga anketimi ka rezultuar se 44.58% e të anketuarve e shfrytëzojnë librarinë elektronike,

ndërkohë që 51.62% nuk e shfrytëzojnë akoma atë. Këto shifra përputhen dhe me përgjigjen tjetër se rreth 45% e të anketuarve shprehen se ekzistojnë salla apo mjedise leximi të pajisura me aparate kompjuterike e internet, të cilat shfrytëzohen nga punonjësit, kurse 51.6% e tyre pohojnë të kundërtën.

Duke hyrë më në brendi të përgjigjeve të kësaj rubrike të anketimit gjejmë se: 61.16% e punonjësve të policisë së Tiranës (drejtori e komisaritate), shprehen se ka kushte të mira dhe shfrytëzim efektiv të librarisë elektronike. Ndërkohë që anketimi i zhvilluar me punonjësit e policisë së Kavajës, Vlorës, studentët dhe FS&H, evidenton se 71.23% e tyre deklarojnë të kundërtën (madje në DPV Vlore kjo shifër është 96.74% dhe në komisaratin e Kavajës 65.52%).

Ndërkohë që për rrugët e bërjes me të përdorshme të kësaj alternative studimi rreth 70.5% refuzuan të përgjigjen dhe rreth 22% sugjerojnë kushte të përshtatshme për studim në mjediset e institucioneve policore dhe hedhjen e materialeve në mënyrë elektronike.

e. Shkon në njësitë vendore të policisë, lexohet dhe vlerësohet revista shkencore e Akademisë së Sigurisë "Policimi dhe siguria". Ndonëse ka një kohë relativisht të shkurtër që po botohet, kjo revistë shkon në njësitë e policisë vendore (sipas 35.02% të anketuarve) lexohet prej tyre (sipas 34.66% të anketuarve) dhe i ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive teknike, profesionale e juridike dhe në realizimin e detyrave të tyre (sipas 55.23% e të anketuarve).

Përgjigjet përputhen me faktin tirazhit të vogël të botimit të kësaj reviste si dhe me numrin e reduktuar të kopjeve që dërgohen në njësitë policore vendore. Fakti që 55.23% e të anketuarve mendojnë se revista i ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive teknike, profesionale e juridike dhe në realizimin e detyrave të tyre, e bën edhe me të nevojshëm shtimin e tirazhit të botimit dhe gjetjen e formave e të metodave për bërjen e revistës me të pranishme, në mjediset vendore të policisë dhe me të përdorshme edhe nga punonjësit e tjerë të organizatës sonë policore.

f. Krijimi i bibliotekave dhe sallave të leximit, shtimit të fondit të librave, titujve, botimeve dhe literaturës profesionale e akademike do të ndikojë në rritjen e arritjeve policore.

Rreth 84 % e të anketuarve sugjerojnë si rrugë zgjidhjeje krijimin e mjediseve dhe fondeve me literature për studim. Kjo përforcohet edhe nga përgjigjet e të anketuarve për rrugët e përmirësimit të gjendjes. Fakti që vetëm 11.34% e të anketuarve sugjerojnë shtimin e trajnimeve për të kompensuar mungesën e sallave apo mjediseve për studim, do të thotë se deklaratimet e mësipërme janë të qëndrueshme.

h. Drejtuesit e njësive policore vendore bashkëpunojnë pak (vetëm 16.61% e tyre) me aktorë të shoqërisë civile, kompani apo ente private botuese për të përfutur donacione në literaturë për bibliotekat e njësive të tyre (vetëm 10% kanë arritur të marrin donacionet tilla). Forcimi i këtyre marrëdhënieve do të shtonte numrin e titujve të botimeve në bibliotekat e njësive policore me buxhete të limituara në këtë fushë si dhe do të ndihmonte promovimin pozitiv të policisë në publik dhe mjediset akademike.

Në përputhje me qëllimin e realizimit të këtij projekti kërkimor shkencor për studimin dhe ekzaminimin e gjendjes së botimeve profesionale e juridike në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes reale të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato, si dhe për identifikimin e nevojave për botimet më të nevojshme e më të domosdoshme për aktivitetin e përditshëm të punonjësve të policisë në shërbim të një policimi gjithnjë e më efektiv, mbështetur në gjetjet e përfundimet, janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e politikave si më poshtë.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Rekomandim i përgjithshëm i projektit

Hartimi i një programi pune afatmesëm në nivel të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, për përmirësimin e gjendjes dhe për plotësimin e mungesave dhe të nevojave për botime dhe literature profesionale e juridike si dhe të ambienteve e teknologjisë për shfrytëzimin e tyre. Ky program të ketë të përcaktuara detyrimet e drejtorive qendrore të policisë, të drejtorive vendore e të Akademisë së Sigurisë në këtë fushë si dhe mjetet financiare e buxhetore të nevojshme për realizimin e tyre.

Rekomandime specifike të projektit:

- Hartimin dhe zhvillimin e politikave të studiara afatgjata për shtrirjen e trajnimit të vazhdueshëm profesional në të gjitha nivelet në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, gjetjen e rrugëve më efikase për realizimin e këtij trajnimi si dhe testimet periodike për rivlerësimin e njohurive të marra.

- Zhvillimi i politikave për të nxitur ofrimin dhe shfrytëzimin e librarisë elektronike, të botimeve digjitale dhe të trajnimit *online*, si metoda bashkëkohore e mjaft efikase. Të krijohet mundësia e shfrytëzimit të librarisë elektronike dhe të botimeve digjitale jo vetëm nga punonjësit e policisë në Tiranë por edhe për ata punonjës policie që shërbejnë në skajin më të largët të vendit. Për këtë të studiohet mundësia pajisjes së punonjësve të policisë me tableta personale. Kështu, nëpërmjet programe të caktuara, sipas grupeve e gradave, ata mund të marrin në kohë rekord literaturën e nevojshme juridike apo profesionale si dhe informacione të tjera të nevojshme në përbushje të detyrës së tyre.

- Studimin e mundësisë dhe gjetjen e formave e të metodave më efikase për bërjen e revistës shkencore e Akademisë së Sigurisë "Policimi dhe siguria" më të pranishme, në mjediset vendore të policisë dhe më të përdorshme nga punonjësit e tjerë të organizatës sonë policore.

- Hartimi i projekteve dhe gjetja e partnerëve për financimin e tyre, me synim mbështetjen e programit që do të hartojë Policia e Shtetit për plotësimin e mungesave dhe të nevojave për botime, literature profesionale e juridike si dhe të ambienteve e teknologjisë për shfrytëzimin e tyre, edhe në kushtet e një buxheti të kufizuar financiar të Policisë së Shtetit.

Shkaku i mosparaqitjes në testin me shkrim të konkurrimit për gradën "Nënkomisar" - 2017		Përqindje
Për shkak të konfuzionit të krijuar nga informacioni për mënyrën dhe nivelin e pagesës gjatë viteve të shkollimit.		6.9%
Për arsye familjare e shëndetësore (të sëmurë, shtatzënë, me fëmijë të vegjël, familjarë të sëmurë, etj).		51.38%
Për arsye shërbimi (shoferë me drejtues të struktura policore, etj..)		6.9%
Për arsye të pjesëmarrjes në kurse, trajnime, kualifikime të tjera brenda e jashtë vendit.		9.72%
Për arsye të largimit nga Policia e Shtetit		2.77%
Për shkak të mosbesimit të transparencës së procesit të konkurrimit		1.38%
Për arsye të ardhjes me vonesë për regjistrim		1.38%
Për shkak të mungesës së dokumentacionit për regjistrim		2.77%
Për shkak se kanë mbaruar arsimimin policor në Sistemin e Korrespondencës dhe nuk janë titulluar oficer.		2.77%
Për shkak se kanë hequr dorë apo kanë pasur dilema për arsye personale.		13.8%
Totali		100%

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

3.7 Projekti kërkimor “Identifikimi i shkaqeve të mos paraqitjes në testin me shkrim për konkurrimin në gradën “Nënkomisar”, të punonjësve të policisë të cilët kishin aplikuar dhe ishin regjistruar për të marrë pjesë në këtë proces”.

Me porosi të autoriteteve të larta të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u kërkua identifikimi i shkaqeve të mos paraqitjes në testin me shkrim për konkurrimin në gradën “Nënkomisar”, të punonjësve të policisë, të cilët kishin aplikuar dhe ishin regjistruar për të marrë pjesë në këtë proces. Në zbatim të kësaj porosie Qendra Kërkimore Shkencore hartoi dhe zbatoi projektin me të njëjtin titull. Në përfundim të këtij projekti afatshkurtër, u grumbullua një informacion, që i përpunuar dhe i analizuar, lidhur me shkaqet e mospjesëmarrjes së tyre në procesin e konkurrimin, në paraqitje tabelorë është si më poshtë vijon:

Në fund i dhanë përfundimet dhe rekomandimet përkatëse.

3.8 Projekti kërkimor “Për përmirësimin e performancës së punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me rrjetin sekret informativ”.

Në kuadrin e domosdoshmërisë për rritjen e treguesve dhe përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit, sidomos krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit dhe terrorizmit, në përmbushje të prioritetëve të qeverisë dhe Ministrisë së Brendshme për rendin dhe sigurinë, më kërkesë ta autoriteteve të larta të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u kërkua hartimi i projektit kërkimor “Mbi vlerësimin e performancës strategjike të punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”.

Në përfundim të këtij projekti, nisur nga gjetjet e tij, u hartua dokumenti strategjik “Për rritjen e performancës së punës së strukturave të Policisë së Shtetit, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin në punën me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”.

Hartimi i këtij dokumenti strategjik është mbështetur mbi arritjet dhe përvojën e fituar në vite dhe parashikon këto komponentë kryesorë strategjikë:

1. Rivlerësimi gjendjes së RSI-së dhe ridimensionimi i punës me informatorët si një komponent kryesor në çdo përpjekje për një policim të udhëhequr nga inteligjenca.

2. Përmirësimi organizativ dhe strukturor në të gjithë piramidën e strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve në mbështetje të ridimensionimit të punës me RSI-në.

3. Përcaktimi i politikave të qarta me qëllim disiplinimin e lëvizjeve dhe të transferimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin, të autorizuar për punën me rrjetin sekret informativ.

4. Rishikimi dhe përmirësimi i akteve dhe procedurave që normojnë punën me informatorët dhe veprimtarinë informativo-gjurmuese.

5. Zhvillimi, ndërmjet shkollimit dhe trajnimit të vazhdueshëm, të kapaciteteve profesionale të punonjësve të strukturave policore, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin dhe të autorizuar për punën me RSI-në.

Gjithashtu, pjesë e këtij projekti kërkimor, me kërkesë të autoriteteve të larta të Ministrisë së Punëve të Brendshme QKSH ishte dhe hartimi dhe dorëzimi i draft udhëzimit të ministrit të Punëve të Brendshme “Për burimet e informacionit policor dhe bashkëpunimin e fshehtë me individët”.

Në këtë draft udhëzim, në raport me udhëzimin në fuqi, janë bërë disa ndryshime

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

konceptore si në formë dhe në përmbajtje. Kjo, duke u mbështetur:

- në studimin e thelluar në përfundim të projektit kërkimor shkencor të zhvilluar lidhur me “Performancën e punës së strukturave të hetimit të krimit në punën me rrjetin sekret informativ”;

- në problematikat e shfaqura në zbatim të udhëzimeve të mëparshme (të vitit 2007 dhe 2013) të cilat normonin punën me RSI-në;

- në domosdoshmërinë e ridimensionimit të punës me rrjetin sekret informativ si një nga teknikat e domosdoshme për sigurimin e informacionit të nevojshëm në luftën për zbulimin, parandalimin dhe goditjen me efikasitet të veprimtarisë kriminale i cili nuk merret nga burime të tjera e që maksimalizon efekshmërinë e taktikave të tjera të punës së fshehtë;

- në rezultatet e konsultimeve intensive të zhvilluara me njohës të mirë të punës së policisë me RSI-në;

- në rezultatet e konsultimeve intensive të zhvilluara me misionet e huaja të asistencës policore në Shqipëri si dhe me prokurorë e gjyqtarë për sa i përket procedurave lidhur me “informatorin nën mbulim” dhe “informatorin e implikuar”.

Mbështetur në analizën e fuqive të organizatës së Policisë së Shtetit, të mundësive dhe potencialeve që ajo ka për punën me rrjetin sekret informativ, si dhe në këmbënguljen dhe fillimin e eliminimit të dobësive të evidentuara, në përfundim të këtij projekti është arritur në përfundimin se janë të gjitha mundësitë për ndaljen e rënies në trendin e performancës së Policisë së Shtetit me treguesit e punës së rrjetit sekret informativ në një periudhë afatshkurtër dhe fillimin e një ndryshimi pozitiv.

3.9. Projekti kërkimor “Krimi mjedisor krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”

Në dekadat e fundit si objekt referues i sigurisë është parë dhe mjedisi me elementët e tij si ujin, tokën, ajrin, etj. Këto janë pranuar si vlera të shoqërisë që duhen mbrojtur e siguruar pasi ndikojnë në cilësinë e jetës së komuniteteve njerëzore. Në këtë rast, kur objekt referimi i sigurisë është mjedisi në tërësi apo elementët e tij përbërës, kemi të bëjmë me sigurinë mjedisore. Për këtë, ndryshimet mjedisore si dhe rreziqet e kërcënimit ndaj tij, vlerësohen si rreziqe e kërcënime ndaj sigurisë mjedisore. Siguria mjedisore apo dhe ambientale siç dhe përmendet shpesh, është një koncept relativisht i ri, është një zgjerim i konceptit jotradicional të sigurisë. Pavarësisht legjislacionit të miratuar për mbrojtjen e mjedisit dhe përcaktimit të ruajtjes së tij si domosdoshmëri strategjike, problematikat në fushën e rendit dhe të sigurisë që shoqëruan zhvillimet pas vitin 1992, krijuan kushte për përfitime abuzive pasurore nëpërmjet shfrytëzimit pa kriter të pasurive mjedisore. Kjo bëri që degradimi mjedisor të kthehet në një rrezik real për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Për këtë arsye Qendra Kërkimore Shkencore hartoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Krimi mjedisor krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

Në përfundim të këtij projekti, duke krahasuar gjetjet dhe përfundimet e analizave dhe vlerësimit të krimeve dhe sigurisë mjedisore të arritura:

- Mbi bazën e treguesve objektivë, pra të dhënave reale të administruara nga strukturat policore dhe të prokurorisë për periudhën 2014-2018, mbi bazën e të cilëve u arrit në përfundimin për një mosfunksionim të zinxhirit investigim-hetim-gjykim apo

polici-prokurori-gjykatë për ta bërë të suksesshëm luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Mbi bazën e treguesve subjektivë, pra perceptimet e qytetarëve për krimin, sigurinë mjedisore dhe nivelin e kënaqësisë me punën e agjencive që menaxhojnë këtë drejtim, mbi bazën e të cilëve u arrit në përfundimin se të anketuarit ndjejnë rrezik më shumë nga krimi mjedisor se sa nga vrasjet dhe vjedhjet, se në vendin tonë nuk po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime dhe nuk po punohet mjaftueshëm për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit, se institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore, se ndonëse besojnë tek Policia e Shtetit, performanca e saj në fushën e mjedisit nuk kënaq më shumë se gjysma e të anketuarve.

Është arritur në përfundimin se ka ngjashmëri në vija të përgjithshme në shumë gjetje e përfundime të arritura gjatë analizimit dhe vlerësimit të luftës kundër krimit mjedisor si duke u mbështetur në treguesit objektivë, ashtu dhe në ata subjektivë pra perceptimeve të qytetarëve për krimin, sigurinë mjedisore dhe nivelin e kënaqësisë me punën e agjencive që menaxhojnë këtë drejtim. Nisur nga gjetjet dhe përfundimet e arritura pas skanimit, analizimit, vlerësimit dhe identifikimit të problematikave që lidhen me krimin mjedisor dhe sigurinë mjedisore, si dhe të faktorëve ndikues, më qëllim përmirësimin të politikave në këtë fushë janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Përmirësimi i mendimit dhe veprimit strategjik për parandalimin e krimit mjedisor dhe rritjen e sigurisë mjedisore me synim përmirësimin e jetës së qytetarëve.

- Kuptimi dhe vlerësimi i sigurisë mjedisore si një e mirë publike dhe personale, pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare, e pranuar dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut.

- Trajtimi i luftës kundër krimeve mjedisore në Shqipëri, në kornizën e sigurisë, çka do të thotë që në vijim do të vazhdojnë të ndiqen me strategji, legjislacion, struktura e masa të veçanta shtesë.

- Integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, në mënyrë që të jetë pjesë e politikave dhe programeve të përgjithshme të zhvillimit të tyre.

- Riorganizimi i inspektorateve shtetërore që merren drejtpërsëdrejti apo që kanë lidhje me mbrojtjen e mjedisit për të qenë më efikas në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore për parandalimin e krimeve e rritjen e sigurisë mjedisore.

- Mbështetja e politikave afatgjatë për rritjen e nivelit arsimor të shtresave të ndryshme të popullsisë, sidomos të atyre në zonat rurale pasi 64% e autorëve të veprave penale në këtë fushë janë me arsim të fillor, të ulët e 9-vjeçar.

- Mbështetja e politikave për mirëfunksionimin e zinxhirit investigim-hetim-gjykim apo polici-prokurori-gjykatë për ta bërë të suksesshme luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me *aquis* të BE-së dhe plotësimi gradual i standardeve të BE-së për luftën kundër krimeve mjedisore dhe çështjeve të sigurisë mjedisore.

- Përmirësimi i politikave për rritjen e përgjegjësisë qytetare për parandalimin dhe luftën kundër krimeve mjedisore pasi 96.27% e të anketuarve mbështesin alternativën që krimet mjedisore janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

- Përmirësimi i politikave për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve në informacionet që institucionet shtetërore japin për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, pasi rezultojnë që besueshmëria në informacione e tyre është në nivele të ulëta.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

- Përmirësimi i politikave për nxitjen e kulturës së mospajtimit, reagimit dhe denoncimit qytetar kundër krimit mjedisor në zonat e tyre të banimit pasi, nga anketimi, ka rezultuar që pjesa më e madhe e tyre nuk kanë denoncuar ndonjë rast të krimit mjedisor në zonën e tyre të banimit.

- Përmirësimi i politikave për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në çështjet mjedisore pasi nga anketimi ka rezultuar se pjesa më e madhe e tyre janë për mbështetjen dhe promovimin e aktiviteteve që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore dhe ruajtjen e mjedisit, janë të gatshme të sakrifikojnë duke ndryshuar stilin e jetesës për t'u përshtatur më mirë me mjedisin (78.67%) apo dhe për të blerë më shtrenjtë një produkt vetëm se është në të mirë të mjedisit.

- Intensifikimi i punës për informimin e qytetarëve me legjislacionin mjedisor pasi pjesa më e madhe e tyre (69%) nuk kanë dijeni ose kanë deri diku dijeni lidhur me ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit.

- Përmirësimi i politikave për rritjen e shkallës së besimit në komunitet lidhur me mundësitë për sukses kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit, pasi nga anketimi ka rezultuar se më shumë se gjysma janë pesimistë në mundësinë e suksesit.

- Përmirësimi dhe intensifikimi i punës për parandalimin dhe goditjen e krimeve mjedisore pasi, pjesa më e madhe e të anketuarve, i perceptojnë krimet mjedisore si rrezik për jetën e tyre më shumë se sa vrasjet dhe vjedhjet. Ata e vlerësojnë dhe si çështja më e rëndësishme apo çështje të rëndësishme për t'u zgjidhur krahas të tjerave.

- Ngritja e një strukture të veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të specializuar për luftën kundër krimeve mjedisore.

- Lufta për parandalimin dhe goditjen e krimeve mjedisore të jetë një nga prioritetet kryesore në punën e Policisë së Shtetit pasi nga studimi rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve e perceptojnë ndotjen e mjedisit si kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e tyre personale.

- Përmirësimi i kurikulave për krimet dhe sigurinë mjedisore në Kolegjin e Lartë Policor dhe në Fakultetin e Hetimit e të Sigurisë, në Akademinë e Sigurisë, me qëllim përgatitjen e oficerëve të aftë të policisë për parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Intensifikimi i punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimit në Policinë e Shtetit në luftën kundër krimeve mjedisore, sidomos për veprat penale "Prerja e paligjshme e pyjeve" dhe "Ndotja e ajrit" si dy nga format më të përhapura të krimeve në fushën e mjedisit (të dyja bashkë zënë 80% të rasteve të evidentuara të krimeve mjedisore).

- Përmirësimi i punës së Policisë për rritjen e besueshmërisë së komunitetit në punën e saj për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

- Rritja e bashkëpunimit mes strukturave policore dhe atyre të prokurorisë për një punë më të kualifikuar në drejtim të dokumentimit të veprimtarisë kriminale të autorëve të veprave penale kundër mjedisit, pasi prokuroria ka regjistruar procedime penale rreth 1/3 më pak nga rastet e referuara nga Policia e Shtetit.

- Rritja e nivelit profesional të punës së prokurorisë në hetimin e veprave penale në fushën e mjedisit pasi ka rezultuar nga procedimet e regjistruara prej saj janë dërguar për gjykim 3.46 herë më pak.

- Rritja e nivelit profesional dhe të përgjegjshmërisë në gjykimin e veprave penale në fushën e mjedisit pasi janë dënuar vetëm 77% e të pandehurve të dërguar për gjykim

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

nga prokuroria dhe 6.7 herë më pak nga numri i autorëve të referuar nga policia në prokurori.

- Përshkallëzimi i masave të sigurisë ndaj autorëve të krimeve mjedisore pasi masat e marra deri tani ndaj autorëve të krimeve mjedisore (89.5% e tyre janë ndjekur në gjendje të lirë) nuk e kanë mbështetur luftën kundër veprave penale në fushën e mjedisit. Edhe pjesa më e madhe e të anketuarve (86.75%) mendojnë se ligjet për sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit duhet të jenë më të sakta e më të rrepta.

- Rritja e investimeve në drejtim të trajnimeve specializimeve të strukturave të posaçme shtetërore që merren me çështje të mjedisit.

- Rritja e investimeve në fushën e edukimit në programet mësimore në gjimnaze e në universitete për parandalimin e krimit mjedisor dhe sigurinë mjedisore me synim ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit qytetar për çështjet mjedisore.

- Përmirësimi dhe intensifikimi i programeve dhe projekteve që mbështesin takimet, fushatat e ndërgjegjësimit me publikun e gjerë dhe trajnimet ose specializimet e posaçme, për parandalimin e krimit mjedisor.

- Ridimensionimi i rolit të institucioneve arsimore e shtetërore në dhënien e informacionit për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor pasi nga anketimi rezultoi se veprimtaria e tyre në këtë fushë është dukshëm më pak ndikuese se e grupeve për mbrojtjen e mjedisit.

- Mbështetja e politikave për zgjidhjen afatgjatë të nevojave ekonomike të popullsisë për ngrohje e gatim për të parandaluar përdorimin e pakontrolluar të lëndëve pyjore.

3.10 Projekti kërkimor “Parandalimi i kultivimit kyçi i suksesit antikanabis”

Thuajse i gjithë territori shqiptar mund të klasifikohet si “zonë e përshtatshme për kultivim” e kanabisit, nisur nga karakteristikat e tij si kushtet klimaterike, elementet përbërës të tokës ku mund të kultivohet, të fluksit të dritës së diellit, e përshtatshme për biosintezën apo reaksionet biokimike që kalon bima e kanabisit deri në fazën e prodhimit të saj si dhe mundësia e sigurimit të burimeve ujore. Përhapja e kësaj dukurie, pas vitit 1995, dhe sidomos lejimi i rrezikshëm dhe “licencimi i heshtur” i aktivitetit të kultivimit të hapur të kanabisit, në komunën e Lazaratit të qarkut Gjirokastrë, krijoi kushte të favorshme për grupet kriminale, të cilat, për më shumë se një dekadë, arritën të konsolidojnë financat, rrjetet, tregjet, specialistët dhe lidhjet politike. Modeli negativ i krijuar në Lazarat ndikoi shumë, jo vetëm në fuqizimin e shumanshëm të grupeve dhe rrjeteve kriminale, por edhe në inkurajimin e kultivimit të kanabisit në rajone të tjera të vendit, si dhe në përkeqësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë⁷. Rritja e kultivimit me këto ritme rrezikonte ta kthente territorin shqiptar nga një “zonë e përshtatshme për kultivim” në një “zonë prodhimi” të kanabisit, pra në një vend ku prodhimi i tij ndikon në çmimet e tregut ndërkombëtar të drogave si dhe në përcaktimin e ndërtimitin e linjave ndërkombëtare të këtij trafiku.

Por, si ka qenë dinamika e kultivimit dhe trendi i përhapjes së kësaj dukurie në vendin tonë? Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e tij? Cilat janë veçoritë që kanë kufizuar suksesin në luftën e deritanishme kundër kësaj dukurie? Dhe cila është metodologjia më të mirë që garanton suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit?

Për këto dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me kultivimin dhe luftën kundër kanabisit u hartua projekti kërkimor “Parandalimi i kultivimit kyçi i suksesit antikanabis”, projekt i cili u finalizua me studimin përkatës.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Objekti i këtij projekti ishte trajtimi për periudhën 1992-2016 i dukurisë së kultivimit të kanabisit si një aktivitet kriminal i dënuar nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar, me potencialet e kthimit në një kërcënim për sigurinë kombëtare, i dinamikës dhe trendit të përhapjes së kësaj dukurie në vendin tonë, i faktorëve që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e tij, i veçorive të luftës së deritanishme kundër kësaj dukurie, me qëllim identifikimin e metodologjisë më të mirë dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave që garantojnë suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit.

Kultivimi i kanabisit ka qenë dhe mbetet një sfidë serioze për strukturat e shtetit shqiptar. Kultivimi i kësaj bime si dukuri, u bë i njohur në Shqipëri zyrtarisht në vitin 1993. Më pas, si një epidemi e rrezikshme, u përhap me shpejtësi pothuajse në të gjithë vendin. Heqja dorë në vite nga puna parandaluese për kultivimin e kanabisit, mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, lënia e përgjegjësive të kësaj lufte vetëm Policisë së Shtetit si dhe mungesa e bashkëpunimit me komunitetin në zonat e kultivimit ka kufizuar në vite suksesin e agjencive ligjzbatuese në luftën ndaj kësaj dukurie. Operacioni policor për marrjen nën kontroll të zonës së Lazaratit në qershor 2014 ka ndikuar pozitivisht në rivendosjen e autoritetit të shtetit edhe në atë pjesë të territorit që ishte nën kontrollin e rrjeteve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Projekti u fokusua kryesisht tek puna për parandalimin e kultivimit të kanabisit pasi, suksesi në këtë fazë, përcakton dhe dinamikën e luftës ndaj trafikimit të tij.

Gjatë zbatimit të këtij projekti janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe ajo e studimit të rastit.

Pasi trajtuam, për një periudhë thuhet 25 vjeçare (1991-2016), dukurinë e fillimit të kultivimit të kanabisit, të përhapjes së saj në vendin tonë, të faktorëve që kanë ndikuar, të dinamikës sipas viteve të rasteve të evidentuara, bimëve të asgjësuara dhe personave të penalizuar, mbështetur në hulumtime, analiza e sinteza në përfundim të këtij projekti, u hartua studimi me këto përfundime.

Përfundimi kryesor

- Kultivimi i kanabisit, si dukuri, u bë i njohur në Shqipëri zyrtarisht në vitin 1993, vit në të cilin janë regjistruar rastet e para të kultivimit të bimëve narkotike. Pavarësisht përpjekjeve në vite fenomeni i kultivimit të bimëve narkotike ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe se metodologjia e zgjedhur për ta frenuar dhe minimizuar atë nuk garantonte suksesin dhe pritshmërinë në këtë fushë.

- Masivizimi i aktivitetit kriminal të kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike nxit dhe rrezikon krijimin e të ashtuquajturave “zona gri”, zona ku sundon paligjshmëria, nxitet rezistencë dhunshme ndaj autoritetit shtetëror dhe shteti humbet kontrollin e pjesëve të territorit të tij duke u shndërruar kështu në një kërcënim për sigurinë publike e kombëtare.

Përfundime të tjera

- Ndër faktorët kryesorë që ndikuan në fillimin dhe përhapjen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri janë: mosmarrja që në fillim e masave për parandalimin e dukurive të tilla negative që do të shoqëronin hapjen e Shqipërisë ndaj vendeve të tjera, pas një periudhe të gjatë izolimi; krizat politike të njëpasnjëshme gjatë viteve të tranzicionit të tej zgjatur,

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

të shoqëruara me mungesën e shtetit ligjor herë pas here në Shqipëri; varfërimi i popullatës dhe papunësia në shifra të mëdha në zonat rurale; pozicioni gjeostrategjik i përshtatshëm i Shqipërisë “një hap larg” perëndimit dhe qenia pothuajse e të gjithë territorit shqiptar si një “zonë e përshtatshme për kultivim” të kanabisit për shkak të cilësive të tokës, klimës, burimeve ujore e fluksit të dritës ; mungesa në vitet e para e legjislacionit për parandalimin e luftës kundër dukurisë së drogave dhe moszbatimi si duhet i ligjeve ekzistuese; mangësitë në përgatitjen e strukturave policore dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese për të përballuar dukuri të tilla; korrupsioni në shifra relativisht të larta për vite të tëra në polici, në prokurori dhe në gjykata, etj.

- Ndërsa si faktorë kryesorë të vazhdimësisë dhe të trendit rritës të kultivimit të kanabisit deri në fund të periudhës analizuese (viti 2016) përveç faktorëve të evidentuar më sipër, mund të veçojmë: vazhdimi i trajtimit të këtij problemi thjesht si një problem policor; niveli i përgjegjësisë brenda Policisë, që ka rezultuar pasiv, në rastin më të mirë dhe i përfshirë, në rastin më të keq, në mbylljen e syve ndaj shfaqjes së fenomenit në të gjitha territoret e mbjella vitin e shkuar (2016), mos koordinimi i punës midis strukturave të ngarkuara me ligj për të luftuar këtë dukuri, mospërfshirja e komunitetit në këtë luftë, rritja progresive e kërkesave të tregut për prodhimin cilësor të kanabisit shqiptar si dhe për pasojë rritjen progresive të interesimit të organizatave të huaja kriminale për të shtrirë aktivitetin e tyre në Shqipëri, zbatimin e standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit për konsumin e drogës, hapja e parakohshme e debatit për legalizimin e kanabisit si dhe përcjellja për këtë e mesazheve të gabuara nga persona me mandat politik.

- Numri i bimëve narkotike të asgjësuara dhe i autorëve të dënuar për kultivimin e tyre, pavarësisht disa zigzageve, ka ardhur vazhdimisht në rritje.

- Niveli i zbulimit së autorëve të kultivimit të bimëve narkotike në përgjithësi ka ardhur në ulje çka ka ndikuar negativisht në luftën ndaj këtij fenomeni.

- Politika penale e ndjekur nuk ka mbështetur luftën ndaj këtij fenomeni që në fillimet e tij. Procedimi i kultivuesve në fillimet e kësaj dukurie kryesisht në gjendje të lirë nuk e ka mbështetur frenimin e këtij fenomeni.

- Operacioni policor për marrjen nën kontroll të zonës së Lazaratit në qershor 2014 ka ndikuar pozitivisht në luftën ndaj këtij fenomeni, në rivendosjen e autoritetit të shtetit edhe në atë pjesë të territorit që ishte nën kontrollin e rrjeteve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

- Në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës analizuese (1992-2016), pavarësisht eksperiencave të suksesshme në nivel vendor, është hequr dorë nga puna parandaluese dhe lufta ndaj këtij fenomeni është përqendruar në korrjen e tij nga ana e policisë në fazat e vonshme të rritjes e pjekjes së bimëve të kanabisit dhe, më pas, në përpjekjet për zbulimin dhe goditjen e trafikantëve të marihuanës pra, të lëndës së përpunuar pas korrjes së bimëve narkotike në zona të paidentuara e të pa asgjësuara më parë.

Mbështetur në përfundimet e arritura, në përputhje dhe me qëllimin e realizimit të këtij projekti për minimizimin drejt zëros të kultivimit të bimëve narkotike, janë dhënë këto rekomandime:

- Trajtimi në kornizën e sigurisë, i fenomenit të kultivimit dhe të trafikimit të bimëve narkotike si një kërcënim për sigurinë kombëtare të vendit.

- Ndryshimi i metodologjisë dhe rikonceptimi i plotë i luftës ndaj dukurisë të kultivimit të kanabisit duke zbatuar plotësisht zinxhirin parandalim, zbulim dhe goditje.

- Zbatimi i plotë i “Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit”,

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

i miratua nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 248, datë 29.3.2017 si një plan gjithëpërfshirës që ka rikonceptuar politikën shtetërore të luftën ndaj dukurisë së kultivimit të kanabisit si nga ana strategjike ashtu dhe taktike.

- Ridimensionimi i punës me burimet e informacionit me qëllim sigurimin e informatave të nevojshëm në luftën për zbulimin, parandalimin dhe goditjen me efikasitet të veprimtarisë kriminale të kultivimit të kanabisit.

- Organizimi i një konferencë shkencore në funksion të një analize të thelluar pas vitit të parë të zbatimit të Planit të Veprimit, me qëllim evidentimin e problemeve të shfaqura dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësimet e nevojshme.

Në përfundim të këtij projektit, është bërë dhe një prognozë për të ardhmen dhe konkretisht:

Zbatimi në detaje i “Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit”, i miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 248 datë 29.3.2017 në planin afatshkurtër, brenda vitit të parë të zbatimit të tij (2017), do të stopojë, do të vendosë nën kontroll dhe do të reduktojë disa herë kultivimin e bimëve narkotike në raport me një vit më parë. Zbatimi i këtij plani me të njëjtin intensitet si në fillim, do të bëjë që, për një periudhë afatmesme 3-5 vjeçare, kultivimi i kanabisit të shfaqet vetëm në mënyrë sporadike. Ky do të jetë një investim serioz dhe në fushën e sigurisë kombëtare. Çdo lëshim nga zbatimi i këtij plani dhe desigurizim i parakohshëm i dukurisë të kultivimit të kanabisit mund të hedhë në erë tërë investimin e kryer.

3.11 Projekti kërkimor shkencor i radhës

Qendra Kërkimore Shkencore në vite ka hartuar dhe zbatuar projekte kërkimore shkencore duke trajtuar problematikat kryesore që lidhen me çështje të rendit e sigurisë publike si dhe të sigurisë kombëtare, këto mbi bazën e programeve të miratuara paraprakisht. Përfundimet dhe rekomandimet e këtyre projekteve janë marrë në konsideratë nga strukturat përkatëse në përmirësimin e politikave në fushat përkatëse.

Në vendin tonë shifrat tregojnë për rritje të pasojave katastrofike, kërcënuese për sigurinë, të cilat vijnë nga fenomenet ekstreme të natyrës, sidomos në dy dekadat e fundit, që korrespondojnë me fillimin e shekullit dhe fillimin e mijëvjeçarit të ri. Vetëm në dy dekadat e para të shek XXI, 2000-2020 Shqipëria ka përjetuar të gjitha llojet e goditjeve të faktorëve ekstremë të natyrës, si përmbytje, tërmete dhe pandemi. Pasojat në vend nga përmbytjet, tërmetet e fenomene të tjera ekstreme të natyrës kanë qenë shumë të mëdha. Ato janë kthyer në kërcënime për sigurinë në Shqipëri. Ndërkohë ka mangësi të theksuara në zhvillimin e politikave për minimizimin e pasojave të tyre.

Për këtë Qendra Kërkimore Shkencore ka hartuar projektin kërkimor të radhës të titulluar “Fenomenet ekstreme të natyrës si kërcënim për sigurinë në Shqipëri. Rekomandime për përmirësimin e politikave që mundësojnë minimizimin e pasojave të tyre”.

Qëllimi i projektit është trajtimi i detajuar dhe në mënyrë shkencore i elementëve që mund të ndikojnë në minimizimin e pasojave që sjellin fenomenet ekstreme të natyrës. Projekti do të finalizohet më një studim thelluar për fenomenet ekstreme të natyrës si kërcënim për sigurinë në Shqipëri, duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave që mundësojnë minimizimin e pasojave të tyre. Studimi do të ketë qëllim që të mundësojë krijimin e profileve, prirjeve, shifrave, analizave, përshkrimeve, anketimeve masive, konkluzioneve për hartimin e politikave, për reduktimin e minimizimin e dëmeve si dhe për të amortizuar emergjencat e pritshme që sjellin këto fenomene natyrore të parashikueshme dhe të paparashikueshme.

Gjithashtu një ndër qëllimet e studimit është përmirësimi i shpejtësisë dhe efikasitetit të reagimit përballë kërcënimit të fenomeneve ekstreme të natyrës, përmes kontributit akademik, policor, institucional dhe më gjerë, duke përgjithësuar praktikat më të mira botërore dhe mësimet e nxjerra; nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit mes institucioneve shtetërore si dhe bashkëpunimin mes shteteve, duke identifikuar aktorët dhe përgjegjësitë, nevojat për përmirësimi në akte ligjore e nënligjore si dhe duke bërë propozimet dhe rekomandimet për të ardhmen.

Pjesë e këtij projekti do të jetë trajtimi i këtij fenomeni duke e parë të lidhur me masat reaguese të gjithë strukturave përgjegjëse shtetërore si të Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura, të pushtetit vendor e qendror, të agjencive të tjera të sigurisë, por edhe të popullatës. Projekti synon të bëjë bashkë gjithë spektrin e studiuesve profesionistë dhe ekspertët e fushave të faktorëve ekstremë të natyrës dhe emergjencave, teoricienët e praktikantët etj.; aktorë dhe faktorë të strukturave të shtetit përgjegjës për amortizimin e rreziqeve që vijnë nga faktorë ekstremë të natyrës, që faktorizohen tek emergjencat shtetërore si dhe botën akademike, ekspertë të vendit dhe të huaj, për të shfrytëzuar eksperiencat, praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare, punimet shkencore si dhe gjetjet më efikase për gjithëpërfshirje në përballimin e këtij kërcënimi serioz për publikun.

Studimi synon ndërgjegjësim publik, mirinformim mbi elementët e prekshëm, të qenësishëm, të përvitshëm, si njohje kërcënuese të sigurisë kombëtare, zgjerimin e bashkëpunimit e segmenteve përgjegjëse të shtetit për sigurinë publike, koordinim në gjithë nivelet për bashkëpunimin e aktorëve ndërshtetërorë, rajonalë, veçanërisht ata fqinjësor. E gjithë kjo synon në përmirësimin e aftësisë themelore të sigurisë publike në të gjithë hapësirën shqiptare nëpërmjet ofrimit të rekomandimeve, për politika “smart” të strukturave të shtetit, në kuadër të përmirësimit të punës së policisë dhe të strukturave të tjera për reduktimit të dëmeve nga fenomenet ekstreme të natyrës. Projekti do të mbulojë me detaje aspektet ligjore e teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve të emergjencave në shkallë vendi, në kushtet e Shqipërisë dhe duke shfrytëzuar praktikën më të përparuar ndërkombëtare në fushën e përballimit të fenomeneve ekstreme të natyrës si dhe të fatkeqësive. Për realizimin e këtij projekti po punojmë për të siguruar partneritetin dhe të aktorëve të tjerë të interesuar për këtë fushë.

4. Konferencat kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga Qendra Kërkimore Shkencore, të publikuara në revistën “Policimi dhe siguria”

Përveç projekteve kërkimore shkencore që realizon më stafin e saj, Qendra Kërkimore Shkencore me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor në fusha të caktuara që përbëjnë interes për Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor, ka organizuar me sukses shtatë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, e konkretisht:

4.1. Më 1 nëntor 2016 u realizua konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: “Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimit” (Contribution to public safety through education)

Kjo, konferencë shkencore u zhvillua në kuadër të reformës së ndërmarrë për

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

reformimin rrënjësor të sistemit arsimor për punonjësit e Policisë, si dhe vënien në funksion të plotë të Akademisë së Sigurisë jo vetëm si qendër formimi, por edhe kërkimi shkencor. Siguria mund të përmirësohet nëpërmjet arsimimit. Tashmë, është një fakt i njohur nga kushdo se, niveli i arsimimit brenda radhëve të Policisë së Shtetit është në ngritje, në përmirësim. Kjo gjë rezulton të jetë zgjidhja e duhur. Dimensioni, i cili vjen nëpërmjet arsimimit, është ai i emancipimit, emancipim për shoqërinë e policinë, emancipim që synon të rrisë sigurinë.

Policimi si veprimtaria më e suksesshme deri tani për ofrimin e sigurisë kërkon një trajtim në shumë dimensione. Një nga dimensionet është rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave që marrin pjesë në këtë veprimtari, por sidomos struktura e policisë, e cila ka punën më të specializuar. Struktura që ka misionin kryesor për respektimin e rendit dhe të zbatimit të ligjit është Policia, pikërisht kjo strukturë duhet të zotërojë nivel shumë të lartë profesional, për të përmbushur kërkesën e komunitetit. Qëllimi i kësaj konference është t'i japë kontribut nëpërmjet shkollimit, rritjes së sigurisë publike për qytetarët".

Kjo konferencë u organizua në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Akademinë e Forcave të Armatosura në Tiranë dhe Universitetin e Sigurisë në Shkup.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor "*Mbi menaxhimin e karrierës e të sistemit tonë arsimor policor*".

Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit të mësipërm kërkimor të prezantuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore zunë një vend të rëndësishëm në punimet e kësaj konference.

Në këtë konferencë një vend të rëndësishëm zunë përfundimet dhe rekomandimet për ndryshimin e gjendjes dhe përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit në lidhje me menaxhimin e zhvillimit të karrierës, të sistemit arsimor policor dhe të burimeve njerëzore si dhe domosdoshmërinë e hartimit të strategjive të domosdoshme për këtë problem.

Ishte tronditës gjetjet e projektit tonë kërkimor se për periudhën analizuese vetëm 1.5% e punonjësve që kanë kryer shkollimin bazë policor patrullë e përgjithshme 22 javore kanë arritur të kenë një ecuri në karrierë deri në gradën e nënkomisarit; se gjatë shkollimit, nënkomisarët të cilët përbëjnë "tullën" bazë të hetimit, merrnin vetëm 8 orë mësimore njohuri mbi legjislacionin penal dhe procedural penal; se nga punonjësit e policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor, vetëm njëri ka arritur të ketë ecuri në karrierë deri në gradën e komisarit të Policisë.

Gjetjet dhe përfundimet tregonin se ka nevojë për një reformim të thellë të sistemit arsimor policor sidomos në drejtim të përgatitjes së specialistëve të policisë (nënkomisarëve) që të jenë të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës.

Efektet e vakuumit në përgatitjen e nënkomisarëve nuk do të ishin ndër një paralelisht me shkollimin bazë policor të vazhdonte normalisht dhe Akademia e Policisë⁸, si shkollë e lartë që përgatiste punonjës policie të gradës nënkomisar, punonjës të cilët mund të vinin nga shkollimi bazë policor. Vazhdimi i Akademisë së Policisë do ta zbuste si nga ana sasiore, ashtu dhe nga ana cilësore "krizën" e

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria

nr.20, 2020

⁷ Plani i veprimit kundër kultivimit të bimëve narkotike 2017-2020, miratuar me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Publikuar në Fletore Zyrtare Nr. 65, datë 30 Mars 2017. Faqe Nr. 3644.

⁸ Akademia e Policisë u mbyll me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 135 datë 11.2.2009.

nënkomisarëve në Policinë e Shtetit.

Sistemi i Trajnimit në Policinë e Shtetit si dhe kurikulat për zhvillimin e tij janë huazuar si model nga Kosova e janë përshtatur për Shqipërinë. Në projektstrategjinë “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar” të përgatitur në vitin 2007 bashkërisht nga Akademia e Policisë dhe përfaqësuesit e misionëve ICITAP dhe PAMECA, dokument i propozuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, parashikohej vazhdimi i Akademisë së Policisë me misionin që “...të menaxhojë zhvillimin dhe zbatimin e trajnimit bazë, trajnimit të specializuar/avancuar dhe të programeve trajnuese për rritje në gradë dhe përgjegjësi”⁹.

Pavarësisht projekt strategjisë së mësipërme, propozim i përbashkët i Akademisë së Policisë dhe misionëve ICITAP dhe PAMECA, Akademia e Policisë u suprimua edhe formalisht¹⁰ me një vendim qeverie në vitin 2009¹¹ dhe u zëvendësua me një strukturë administrative në qendër, të quajtur “Departamenti për trajnimet” të cilit, në kundërshtim dhe me ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”¹², iu dhanë edhe kompetenca të një institucioni arsimor.

Në vitin 2011, ndonëse urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit ishte për hartimin e *Strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit*¹³, u hartua strategjia “Për trajnimet në Policinë e Shtetit për vitet 2011-2016”, në të cilën nuk përmendet në asnjë rast modeli i sistemi arsimor që do të ndiqej.

Në konferencë u evidentua fakti se krijimi i Akademisë së Sigurisë dhe konceptimi i saj strukturor, infrastrukturor e në kurrikula si institucion i arsimit të lartë publik, me programe ku ndërthuren arsimimi bazë policor, arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës si dhe trajnimet e kualifikimet profesionale, shënonte një moment të rëndësishëm kthese për mundësinë e përmirësimit të menaxhimit të procesit të ecurisë në karrierë të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe për fillimin e eliminimit të pasojave negative në fushën e arsimit, edukimit profesional policor e ecurisë në karrierë të shkaktuar nga mbyllja e Akademisë së Policisë.

4.2 Më datë 28 prill 2017, u organizua konferenca e parë kombëtare e akademisë së sigurisë me temë “Depresioni dhe vetëvrasjet në Shqipëri”

Kjo konferencë u organizua me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor si dhe eksplorimin në thellësi, trajtimin në këndvështrim analitik dhe psikosocial të dukurisë së vetëvrasjeve, i trendit të saj sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit, analizës shumëdimensionale e kësaj dukurie për të evidentuar problematikat, faktorët që e nxitin, e mundësojnë e që krijojnë terren për zhvillim e saj, ndikimin e tyre në fushën e sigurisë, dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e kësaj dukurie, në shërbim të një policimi më efektiv.

⁹ Projektdraft “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar”, faqe 4. Burim i cituar.

¹⁰ Pranimet e reja në Akademinë e Policisë, në sistemin me shkëputje nga puna, realisht ishin pezulluar që në vitin 2005, me një urdhër verbal të ministrit të Brendshëm të asaj kohe, Igli Toska.

¹¹ Akademia e Policisë u mbyll me VKM nr. 135, datë 11.2.2009 “Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

¹² Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr. 10 307, datë 22.7.2010.

¹³ Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 05.01.2011 “Për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit” dhe Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 83, datë 24.1.2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit”. Burim i cituar.

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Ajo u organizua në bashkëpunim me përfaqësinë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik, Fakultetin e Shkencave Sociale, Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore si dhe repartin e Toksikologjisë të QSUT-së.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesore të projektit kërkimor shkencor *“Vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2005-2015”*.

Gjetjet interesante dhe me vlerë të këtij projekti kërkimor shërbyen si boshti i kësaj konferencë. Në mënyrë të veçantë u vlerësuar dhe rekomandimet për hapat dhe masat që duhen ndërmarrë në parandalimin e kësaj dukurie, me synim sensibilizimin e institucioneve përgjegjëse për hartimin e një Strategjie Kombëtare për parandalimin e vetëvrasjes. Trajtimi i dukurisë komplekse e gjithëpërfshirëse të vetëvrasjes, nën një këndvështrim historik, analitik e psikosocial, shërbeu për të evidentuar problematikat, faktorët nxitës, nivelin e riskut të vetëvrasjes si dhe grupet potencialisht më të rrezikuara në shoqërinë shqiptare. Kjo konferencë i shërben gjithashtu punës së institucionit të policisë për normimin dhe institucionalizimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshetërorë për këto problematika.

Me interes në konferencë u vlerësuar gjetjet e mëposhtme të projektit tonë kërkimor shkencore si në vijim.

- Faktorët dhe kushtet ndikuese për vetëvrasje në Shqipëri, për periudhën analizuese 2005-2015, ishin si më poshtë:

- depresioni është paraprijës i shumicës së vetëvrasjeve;
- sëmundjet mendore;
- përdorimi i drogave, alkoolit;
- gjendja sociale dhe ekonomike;
- lidhjet e dashurisë mes të rinjve;
- humbja e personave të dashur të familjes;
- për shkak të borxheve dhe pamundësisë për t'i shlyer dhe mbajtur familjen;
- për shkak të dhunës në familje;
- për shkak të faktorit gjenetik;
- për shkak të predikimeve fetare.

Faktorët ndikues në aktin e vetëvrasjes lidhen edhe me sistemin politik, ekonomik e social të një vendi dhe kanë ngjashmëri e ndryshime në sistemin komunist dhe në periudhën analizuese postkomuniste 2005-2015.

- Për periudhën 2005-2015, në vendin tonë vetëvrasjet janë evidentuar të përhapura në zonën e Shqipërisë së Mesme (Tiranë, Durrës, Elbasan); në zonën jugore (Fier, Vlorë, Berat, Korçë) dhe në zonën Veriore (Lezhë, Shkodër, Dibër).

- Metodat më të përdorura në Shqipëri për realizimin e vetëvrasjes në këtë periudhë ishin: me lëndë helmuese në 35.2% të rasteve, me armë zjarri 10.5% të rasteve si dhe “Shkaqe të tjera” si vetëmbytja, vetëhedhja nga lartësitë, vetëmbytja me litar apo me mjete të tjera, mbidoza nga medikamentet, alkooli apo droga, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë 53.8% të rasteve.

- Në bazë të grupeve në shënjestër, rezultoi që metoda më e përdorur në Shqipëri e në Tiranë për të vrarë veten është vetëhelmimi me fotoksinë në 49.7% të rasteve ose ½ e totalit të rasteve dhe vetëvarja me litar në 23.7% të rasteve.

- Edhe për vetëvrasjet e mbetura në tentativa ka rezultuar se në më shumë se gjysmën e rasteve të vetëvrasjeve (58.2%) është ajo me lëndë helmuese, kurse metodat

më pak të përdorura janë me lëndë eksplozivë në 0.1% të rasteve dhe me armë zjarri në 3.8% të rasteve.

- Në periudhën 2005-2015, metodat më të përdorura nga femrat në Shqipëri për të realizuar vetëvrasjen janë vetëhelmimi në 70.3% të rasteve, vetëvarja në 16.5% të rasteve, vetëvrasja me 4.9% të rasteve, vetëhedhja me 2.9% të rasteve si dhe vetëmbytja me 1.8% të rasteve.

- Ndërsa metodat më të përdorura nga meshkujt në Shqipëri është po vetëhelmimi në 43.4% të rasteve, vetëvarja në 31.4% të rasteve; vetëvrasja me 13.4% të rasteve; mbidozë me 2.7% të rasteve; vetëhedhje me 2.5% të rasteve; vetëmbytje me 1.2% të rasteve dhe me përdorimin e energjisë elektrike me 0.7% të rasteve.

- 78.9% e rasteve të vetëvrasjes janë realizuar brenda në banesë, me metoda si vetëhelmimi, vetëvarja, vetëvrasja me armë, mbidoza me medikamente, etj.

- Në periudhën analizuese 2005-2015, sipas të dhënave të grumbulluara nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, lakorja (kurba) e vetëvrasjeve fillon e ngrihet në pranverë, arrin pikën më të lartë në muajit e nxehtë (qershor 8.1%, korrik 11.9%, gusht 20%, shtator 11.9%) ulet në muajit tetor e nëntor me nga 6.7% dhe piken më të ulët e ka në dhjetor me 3.8% të totalit të vrasjeve.

- Në periudhën analizuese, 69.6% e personave të vetëvrasurë kanë qenë pa arsim ose me nivel të ulët arsimor (55.6% me nivel arsimor 8-9 vjeçar dhe 14% të pa arsimuar), kryesisht moshë e mesme ose e vjetër dhe vetëm 5.5% me arsim të lartë.

- Meshkujt dhe të rinjtë në Shqipëri janë shumë të prirë për të kryer vetëvrasje si rrjedhojë e abuzimit me substancat e drogat ndërsa femrat dhe grupmoshat e tjera janë shumë pak të prirë për të kryer vetëvrasje nga ky shkak.

- Popullsia shqiptare, përfshi femrat, meshkujt dhe të gjithë grupmoshat, është shumë pak e prirë për të kryer vetëvrasje për shkak të predikimeve të dëmshme fetare, ku të moshuarit janë më pak të rrezikuarit ndër të tjerët.

- Si femrat ashtu dhe meshkujt në Shqipëri, si dhe të rinjtë e moshë e mesme (e re dhe e vjetër) janë shumë të prirë të kryejnë vetëvrasje si rrjedhojë e mosdiskutimit apo moskurimit të problemeve të ndryshme të hershme ndërsa të moshuarit janë më pak të prirë ndër tjerë për të kryer vetëvrasje nga ky shkak.

- Si femrat ashtu dhe meshkujt në vend, si dhe moshë e mesme e re kanë shumë prirje për të kryer vetëvrasje si pasojë e problemeve apo sëmundjeve mendore ndërsa të moshuarit dhe moshë e mesme e vjetër janë më pak të prirë ndër të tjerët që të kryejnë vetëvrasje nga ky shkak.

- Për periudhën analizuese 2005-2015, vetëvrasjet e punonjësve të policisë janë në shifra të ulëta në raport me numrin e vetëvrasjeve në vend (10 vetëvrasje) dhe krahasuar dhe përhapjen e këtij fenomeni në organizatat policore të disa vendeve të tjera, por me një tendencë në rritje sidomos vitin e fundit të periudhës analizuese. Vetëvrasjet e punonjësve të policisë për vitin 2015 (gjithsej 4) zënë 40% të vetëvrasjeve të së gjithë periudhës analizuese 2005-2015.

- Në Shqipëri mungonte një strategji kombëtare për parandalimin e vetëvrasjeve, nuk ka një vëmendje të shtuar të institucioneve apo shoqërisë shqiptare ndaj dukurisë në rritje të vetëvrasjes. Nuk ka procedura të veçanta standarde për hetimin e vetëvrasjeve. Nuk ka struktura të veçanta e të trajnuara që të merren me këtë fenomen. Ka mangësi në masat për parandalimin e këtij fenomeni në të gjitha aspekte, si në atë shoqëror, mjekësor, profesional e policor.

Në përfundim të konferencës, pas trajtimit të thelluar të dukurisë komplekse e

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës "Policimi dhe siguria" »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

gjithëpërfshirëse të vetëvrasjes, në bashkëpunim dhe me aktorët të tjerë pjesëmarrës në konferencë, janë dhënë rekomandimet e nevojshme për hartimin e politikave për parandalim dhe reduktim të vetëvrasjeve, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e një strategjie kombëtare për këtë çështje. Kjo konferencë përkoi edhe me fushatën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi depresionin “Depression: Let’s Talk”, fushatë e cila do të zgjasë një vit.

4.3 Më 15 nëntor 2017 QKSH organizoi konferencën II shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë” (Forensic sciences and contemporary security challenge).

Në format e tij bashkëkohore, kriminaliteti përbën sot një faktor me ndikim në rritje në mjedisin e sotëm strategjik e të sigurisë, i cili karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga të panjohura dhe nga mundësitë e zhvillimeve krejtësisht të paparashikueshme. Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit adekuat të rreziqeve të ardhshme, i detyron strukturat e sigurisë që të orientohen drejt krijimit të kapaciteteve polivalente, të cilat duhet të jenë të afta që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura. Përmirësimi i sundimit të ligjit, përbën për ne një domosdoshmëri strategjike dhe kjo, ndërmjet të tjerave, kërkon fuqizimin dhe modernizimin e Policisë së Shtetit, përmes përmirësimit të kapaciteteve të hetimit dhe informacionit, me qëllim rritjen e kontrollit mbi territorin dhe përmirësimin e aftësive parandaluese dhe goditëse ndaj krimit. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, për të siguruar zbatimin e rreptë të ligjit, është prioritet i adresuar në “Planin kombëtar për integrimin evropian 2016-2020” dhe planin e veprimit në zbatim të tij. Problematika e kriminalitetit dhe procesi i hetimit rreth zbulimit, analizimit, masave dhe mënyrave të parandalimit, kërkon sofistikim të fushave specifike të shkencave ligjore, që përfshin aplikimin e metodave shkencore për të zgjidhur problemet që lidhen me ligjin, hetimin, mënyrat apo mjetet e përdorura.

Në këtë kuadër Qendra Kërkimore Shkencore organizoi konferencën II shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë” (Forensic sciences and contemporary security challenge).

Ndërmarrja e projekteve, studimeve e kërkimeve në fushën e shkencave ligjore, përfshin aplikimet shkencore, punimet, trajnimet, studimet dhe analizat e thelluara, lidhur me fusha të ndryshme të shkencave ligjore, në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të këtyre shkencave, përmirësimit të punës së punonjësve e profesionistëve, të gjetjes së formave të reja, të metodave shkencore e teknologjike të zbulimit e hetimit të krimit, të rishikimit e ndikimit të tyre në aspektin ligjor e më gjerë, rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së testimeve dhe intervistave profesionale, etj., në kuadër të ndërtimit të strategjive të nevojshme të identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të krimit.

Kjo konferencë, shërbeu në kuadrin shkencor, për të ndihmuar institucionet, programet, agjencitë, individët, ekspertët, për të bashkëpunuar dhe për të ndarë burimet, informacionet dhe ekspertizën në lidhje me shkencat ligjore, aplikimin dhe rëndësinë e tyre, me në fokus krijimin e mundësive për rrjetëzim, bashkëpunim dhe këmbim të ideve me udhëheqës, profesionistë, ekspertë e studiues në nivel kombëtar e ndërkombëtar për përmirësimin, sofistikimin e zbulimin e metodave e mënyrave për hetimin e krimit dhe ndikimin në sigurinë publike.

Konferenca kishte për objekt, trajtimin në mënyrë gjithëpërfshirëse nga disiplina të ndryshme të shkencave ligjore, nëpërmjet punimeve të mirëfillta shkencore në nivel të

gjerë kombëtar e ndërkombëtar, të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga kriminaliteti bashkëkohor, përgjithësimin e përvojës më të mirë, zgjerimin e dijeve aplikative, si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave, për përmirësimin e punës në shërbim të një policimi më efektiv.

Qëllimi i konferencës ishte mbledhja, përpunimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar shkencor të fushës së shkencave ligjore, për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor; trajtimi në këndvështrim analitik e në mënyrë shkencore të aplikimit të disiplinave të ndryshme të shkencave ligjore në hetimin e krimeve në Shqipëri, në aspektin ligjor e më gjerë, në varësi të fushave specifike e profesionale, kontributit dhe rëndësisë së tyre në punën e punonjësve të policisë e më gjerë; evidentimi i problematikave dhe nevojave për përmirësimin e punës nëpërmjet zhvillimit të dijeve, teknikave të reja e modeleve të përparuara të këtyre disiplinave, përballë sfidave të kriminalitetit bashkëkohor.

Kjo konferencë arriti të bashkojë njëzëri akademikët, profesionistët, ekspertët, punonjësit e policisë si dhe pedagogët e fushave të shkencave ligjore, të sigurisë dhe jo vetëm, në nivel gjithëkombëtar (gjeohapësira shqiptare) e ndërkombëtar, për të ndarë eksperiencat, praktikat, punimet shkencore dhe gjetjet për të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të shkencave ligjore në raport me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

Të pranishëm në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare ishin, kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Sh.t.z. Edi Rama, ministri i Brendshëm, z. Fatmir Xhafaj, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtues madhor Haki Çako si dhe shumë personalitete të tjera nga brenda e jashtë vendit.

Në fjalën e tij kryeministri Edi Rama vlerësoi rolin që po merr përditë e më tepër Akademia e Sigurisë në funksion të rritjes së kapaciteteve në këtë fushë. Sipas tij “Elementët apo grupet kriminale, sot kanë një kapacitet të lartë keqpërdorues të teknologjive në funksion të qëllimeve të tyre të mbrapshta, që e bëjnë punën e institucioneve ligjzbatuese shumë më të ndërlikuar dhe shumë më komplekse dhe pa diskutim e bëjnë rolin e kësaj akademie shumë më kyç për të ardhmen e përpjekjes së Policisë së Shtetit dhe të institucioneve ligjzbatuese, në tërësi, në fushën e betejës me krimin”.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Fatmir Xhafaj, në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh: “Dëshiroj t’ju jap vlerësimet më të mira organizatorëve të kësaj konference, Akademisë së Sigurisë, Qendrës Kërkimore Shkencore dhe bashkëpunëtorëve të tyre, që kanë mundur të jenë këtu së bashku, me këtë pjesëmarrje ndërkombëtare, akademikë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të shkencave ligjore. Si ministër, por edhe si jurist në profesion, e shoh me interes të veçantë këtë konferencë, që synon në një dimension gjithëpërfshirës të nxisë shkëmbimin e përvojave kërkimore për sa i përket aplikimit të shkencave ligjore në hetimin e krimit në Shqipëri. Unë besoj se kjo konferencë do të ndihmojë për të përmbushur më mirë misionin e Policisë së Shtetit në këto kohë kur krimi dhe format e organizuara të tij janë më të sofistikuar dhe kanë nevojë jo vetëm për forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar, por edhe për përdorim më të mirë dhe të gjerë të metodave bashkëkohore dhe mundësive që ofron zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë në ditët tona”.

Konferenca u organizua në bashkëpunim me Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Akademinë e Kosovës për Sigurinë Publike, Agjencinë e Kosovës për Forezikë, Universitetin e Romës “Tor Vergata”, Fakultetin e Mjekësisë Monstir - Tunizi, dhe Fakultetin e Sigurisë Shkup, Maqedoni.

Shafa, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Kumtuesit e kësaj konference patën mundësinë e prezantimit të punimeve të tyre dhe të shkëmbimit të ideve nëpërmjet diskutimeve të ndryshme.

4.4. Më 26 prill 2018 QKSH organizoi konferencën II shkencore kombëtare “Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare”

Në punimet e paraqitura në konferencë u vlerësua një vëmendje e shtuar nga mjaft studiues dhe të interesuar për problemet e familjes dhe krimeve brenda saj. Tema e konferencës rreth një problemi sa interesant kaq edhe të vështirë, siç është vrasja brenda familjes, tërhoqi praninë e një dimension relativisht të gjerë të interesuarish, studiues e pjesëmarrësish me punime e kumtesa, të cilët përfaqësonin institucione të arsimit të lartë dhe struktura ligjzbatuese, pedagogë e lektorë me grada shkencore, punonjës të institucioneve të sigurisë, drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Vrasjet në familje janë forma më ekstreme e dhunës në familje. Dhuna dhe vrasjet në familje i kapërcejnë kufijtë e një krahinë, të një kombi apo të një kulture. Ato shpesh janë pjesë e kronikave të zeza pothuajse në të gjitha kulturat.

Trajtimi i problemeve në kumtesa pati një shtrirje të gjerë, multidimensionale, që nga syri i sociologut tek këndi i shikimit të juristit, nga vëzhgimi i psikologut tek kodet e penalistit, nga puna hetimore e parandaluese e punonjësit të sigurisë tek analiza e gjithsecilit sipas këndvështrimit të vet.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri” të realizuar së fundmi prej saj.

Në konferencë u analizua dinamika e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për vitet 2007-2016, nga ku rezultoi se, kanë ndodhur gjithsej 356 vrasje (nga këto 54.5% vrasje e 45.5% vrasje të mbetura në tentativë); mesatarisht në një vit 35.6 vrasje; në vitin 2016 (viti i fundit i periudhës analizuese) kanë ndodhur 16 vrasje (se bashku më ato të mbetura në tentativë) ose 2.68 herë më pak se në vitin 2007 (vit i parë i periudhës analizuese) dhe 3.3 herë më pak se në vitin 2012, i cili shënon nivelin më të lartë të vrasjeve për shkak të rrethanave familjare të kësaj periudhe analizuese. Këto vrasje përbëjnë vetëm 3.54% të totalit të veprave penale të fushës së dhunës në familje, të cilat, për periudhën analizuese, kanë një tendencë në rritje.

Gjithashtu në vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare janë evidentuar mesatarisht 13.91 viktima për 100 mijë banorë në shkallë vendi. Këto kanë ndodhur kryesisht në qarqe të mëdha si Tirana, Durrësi, Fieri, etj, kryesisht në zona rurale (në 61.17% të rasteve) dhe më e theksuar në qarkun e Lezhës (me 32.55 viktima për 100 000 banorë). Këto vrasje kryhen edhe në bashkëpunim, kanë pasur më shumë se një autor (në 10.37% të rasteve), më shumë se një viktimë (në 14.04% të rasteve), ku një pjesë jo e vogël e autorëve ka përfunduar me vetëvrasje (në 12.8% të rasteve). Kryesisht kanë ndodhur mes bashkëshortëve (në 28.79% të rasteve), më shumë për motive të dobëta (në 68.8% të rasteve), kryesisht i përkasin profesionit të fermerit me mbi 50%, të rasteve (51.01% të autorëve dhe 53.75% të viktimave), më shumë të vetëpunësuar (në 44.95% për autorët dhe 48.75% për viktimat).

Nga analiza në kontekstin historik e juridik të vrasjeve në familje u evidentua fakti se:

Shala, Xh.
« Pesë vite
kërkime
shkencore,
në njëzet
numra
të revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

- Në legjislacioni penal të para vitit 1945 dhe e në të drejtën zakonore penale shqiptare, rastet e vrasjes në familje e në fis kanë gjetur një trajtim të veçantë. Këto vrasje janë klasifikuar e trajtuar të kryera kryesisht në rrethana cilësuese të lidhura me objektin e krimit, duke i dhënë kështu një mbrojtje të posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet brenda vetes. Kjo në vazhdimësi ka ndikuar në frenimin e dukurisë së vrasjes në familjen shqiptare të asaj periudhë.

- Në legjislacioni penal që përfshin periudhën nga viti 1945 e deri në ndryshimet ligjore të vitin 2013 pjesëtarëve të familjes ju hoq mbrojtja e posaçme nga vrasjet brenda vetes, të cilën ajo e kishte gëzuar në shekuj më parë. Kjo ka ndikuar negativisht në parandalimin e vrasjeve në familje dhe në mundësinë e reduktimit të rasteve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Ndryshimet në “Kodin penal” të bëra në vitin 2013 duke shtuar nenin 79/c “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, pas pothuajse 70 vitesh i sigurojnë dhe rikthejnë mbrojtjen e posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare. Në planin afat gjatë kjo do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e numrit të vrasjeve në familje dhe në forcimin e institucionit të familjes

Në mbyllje të konferencës u dhanë përfundimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave në këtë fushë.

4.5. Më 21 nëntor 2018 u organizua konferenca III shkencore ndërkombëtare “Computer Crime, Cyber Crime and National Secyurity”

Vrulli i zhvillimit të komunikimit masiv në hapësirën kibernetike (virtuale), sidomos pas vitit 2000, orienton drejt një problemi të ri që po kërcënon vrullshëm sigurinë kombëtare: lufta kibernetike dhe krimet kompjuterike. Këto krime, si aktivitete kriminale të zhvilluara në rrjeta, kërcënojnë informacionin, shkëmbimin e informacionit, hapësirën kibernetike dhe shoqërinë e sotme njerëzore. Kjo nxit drejt një lufte të re globale virtuale që kërkon rishikim të politikave e masave mbrojtëse. Në ditët e sotme kjo formë e krimit po përhapet vrullshëm në nivel individual, institucional, organizativ, kombëtar e ndërkombëtar. Zhvillimi i madh i teknologjisë dhe internetit ka mundësuar që pjesa më e madhe e aktiviteteve ekonomike, shkencore, sociale, ligjore, hetuese, policore, politike, etj., të mundësohen e të realizohen nëpërmjet kompjuterit dhe komunikimit virtual.

Nga aspekti hetimor, kjo veprimtari kriminale paraqet vështirësi për t’u gjurmuar, hetuar, ndjekur e zbuluar sepse nuk kufizohet nga kufijtë kombëtarë gjeografikë. Gjithashtu këto krime mund të përgatiten nga kudo dhe kundrejt çdo përdoruesi të kompjuterit, kërkojnë resurse të vogla materiale e humane, kryhen në kohë relativisht të shkurtër, me ose pa praninë e autorit në vendin e kryerjes së veprës penale, si dhe aftësimi për përdorim të kompjuterit nuk është i shtrenjtë dhe është i qasshëm nëpërmjet rrjetave e programeve kudo në botë. Autorët e këtyre veprave penale gjenden fizikisht në vende të ndryshme, nga ato ku vijnë pasojat e veprimeve të tyre, ndërkohë që legjislacionet vendase përgjithësisht kufizohen brenda territorit vendas. Nga aspekti strategjik, mbrojtja nga kërcënimet e reja të kufijve virtualë dhe rrjeteve e sistemeve nga mashtrimet kompjuterike, është çështje e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Sipas “Strategjisë për mbrojtjen kibernetike 2018-2020”, trendi aktual tregon se incidentet e kësaj natyre do të vazhdojnë të rriten. Ndërmarrja e projekteve, studimeve e kërkimeve në fushën e krimeve e luftës kibernetike përfshin aplikimet shkencore, punimet, trajtimet, studimet dhe analizat e thelluara lidhur me procedurat, metodat e teknikat hetimore

Shala, Xh.
« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

brenda e jashtë vendit; vlerësimin e faktorit të rrezikut dhe ndikimit në shoqëri; digjitalizimin e komunikimit dhe format e reja të mbrojtjes, si dhe me programet, kurikulat e modulet ekzistuese për këtë formë krimi, në kuadër të ndërtimit të strategjive të nevojshme për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore e materiale, për përmirësimin e metodave hetimore dhe për bashkëpunime të fushave e nivele të ndryshme në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Në këtë konferencë do të diskutohet rreth masave strategjike, organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit, lidhur me rrezikun e krimeve kompjuterike dhe kërcënimeve kibernetike. Kjo konferencë shërben në kuadrin shkencor, për të ndihmuar institucionet, programet, agjencitë, ekspertët për të nxitur debate konstruktive akademike e për të dhënë sugjerime për masa e politika për mbrojtjen nga kërcënimet në rritje në sigurinë publike në hapësirën kibernetike dhe në aspektin hetimor sa më efektiv, me qëllim nxitjen e bashkëpunimeve në nivel ndërkombëtar e kombëtar, dhënien e ekspertizave e praktikave që ofrojnë risi dhe rekomandimet përkatëse për politikat në vazhdim të Policisë së Shtetit e më gjerë.

Për këtë, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë, në bashkëpunim me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), si dhe me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri (OSCE), me Misionin PAMECA V dhe me Projektin IPA/2017 “Countering Serious Crime In The Western Balkans”, organizoi konferencën e III-të shkencore ndërkombëtare me temë: “Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare” (Computer crime, cyber crime and national security).

Objekti kryesor i kësaj konference, ishte paraqitja e analizave e prognozave, nga aspekti i hetimit të krimeve kompjuterike dhe kërcënimeve kibernetike të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare. Këto u konkretizuan me punime të mirëfillta shkencore për të nxitur debate dhe për të trajtuar në nivel të gjerë, kombëtar e ndërkombëtar, rëndësinë dhe nevojën e zgjerimit të dijeve dhe aplikimit të tyre përballë sfidës së hetimit, kërcënimeve të reja të kufijve virtualë dhe parandalimit të krimeve kibernetike në Shqipëri, si dhe hartimin e politikave, masave, kurikulave e trajnimeve për këtë çështje.

Qëllimi i konferencës ishte trajtim në mënyrë shkencore rreth aspektit proceduralo-hetimor të krimeve kompjuterike; aspektit analitik strategjik të kërcënimeve të krimeve kibernetike dhe terrorizmit kibernetik në sigurinë kombëtare dhe aspektit akademik, për paraqitjen e praktikave ekzistuese dhe rekomandime të mëtejshme të kurikulave, programeve e trajnimeve për fushën e krimeve kibernetike te punonjësit e policisë e më gjerë.

Pjesëmarrja ishte e hapur, për staf akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partnere të Policisë së Shtetit.

Konferenca i zhvilloi punimet në tre sesione tematike shkencore dhe konkretisht:

- Aspekte strategjike të krimit kibernetik dhe impakti në sigurinë kombëtare.
- Hetime profesionale të krimeve kibernetike.
- Aspekte ligjore, ekonomike e psikosociale të krimeve kibernetike.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore prezantoi gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit të saj kërkimor shkencor “Krimi dhe kërcënimet kibernetik në Shqipëri. Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”. Kumbësuesit patën mundësinë e prezantimit të punimeve të tyre dhe të shkëmbimit të ideve nëpërmjet diskutimeve të ndryshme.

Punimet e konferencës e përshëndetën dhe zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë prof. dr. Vasilika Hysi dhe ministri i Brendshëm, dr. Sandër Lleshaj.

4.6. Më 23 maj 2019 u organizua konferenca IV ndërkombëtare me temë “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri”

Qendra Kërkimore Shkencore, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës, universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, kolegjin universitar “Luarasi”, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, si dhe me mbështetjen e SHELL Albania, TAP Albania, Drejtorisë së Policisë Rrugore, Kryqit të Kuq Shqiptar, Institutit të Transportit Rrugor dhe DPSHTRR, organizoi me datën 23 maj 2019 konferencën e IV shkencore ndërkombëtare me titull “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri”.

Akademikë, profesionistë, ekspertë, nga brenda e jashtë vendit, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve publike e private që shprehën interes morën pjesë në punimet tyre në këtë konferencë.

Në Shqipëri, efektiviteti i sigurisë rrugore përbën një ndër sfidat kryesore në rang kombëtar në fushën e sigurisë. Si një vend në zhvillim, vendi ynë rezulton të jetë vend me probleme në fushën e sigurisë rrugore, krahasuar me vendet e zhvilluara dhe aksidentet rrugore regjistrojnë shifra më të larta sesa në ato vende.

Në këtë konferencë morën pjesë profesionistë, ekspertë e studiues, të cilët prezantuan kërkimet e tyre shkencore në këtë fushë si dhe diskutuar dhe ndanë mendimet, eksperiencat e praktikën rreth problematikës së sigurisë rrugore në vendin tonë dhe më gjerë, duke përfshirë dhe jo vetëm, infrastrukturën rrugore, mjetet dhe përdoruesit e rrugës.

Në kuadrin shkencor kjo konferencë u shërben institucioneve, programeve, agjencive, dhe ekspertëve për të nxitur debate konstruktive për konceptin e sigurisë rrugore, rreziqet që parashtrihen në Shqipëri dhe masat e nevojshme për të parandaluar dhe reduktuar sa më shumë dhe në mënyrë efektive numrin e aksidenteve rrugore, në bazë të bashkëpunimit gjithëpërfshirës të institucioneve dhe shoqërisë shqiptare.

Objekti kryesor i arritur i kësaj konference ishte paraqitja e analizave e prognozave gjithëpërfshirëse për sigurinë rrugore në Shqipëri, nëpërmjet punimeve profesionale me karakter shkencor dhe zhvillimi i debateve konstruktive rreth kushteve nxitëse, perceptimeve e veçorive të aksidenteve rrugore në shkallë vendi, si dhe rekomandimeve për politika, strategji, plane veprimi, praktika e bashkëpunime, në shërbim të institucioneve përgjegjëse dhe të një policimi efektiv.

Qëllimi i konferencës ishte që nëpërmjet punimeve të thelluara kërkimore shkencore të situatës së sigurisë dhe aksidenteve rrugore në vend, duke përfshirë: problemet në infrastrukturën rrugore, rregullimin, gjendjen e mirëmbajtjes së rrugëve; problemet në mirëmbajtjen e infrastrukturës së automjeteve; shenjat sinjalizuese rrugore, ndriçimin, semaforët, etj; veçoritë e sjelljes së përdoruesve shqiptarë të rrugës; perceptimin e sigurisë rrugore nga qytetarët shqiptarë; funksionimit të shërbimeve të policisë rrugore në Policinë së Shtetit, të shërbimeve të emergjencës e të atyre ndihmëse; praktika të punëve të OJF-ve apo forumeve të ndryshme për këtë çështje, e të tjera, të ndihmojë në evidentimin e

Shafa, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

strategjive, planeve gjithëpërfshirëse të veprimit, masave dhe organizimit të punës së domosdoshme parandaluese për një siguri rrugore më të mirë.

Konferenca i filloi punimet me seancën plenare ku dhe u bënë përshëndetjet e të ftuarve VIP.

Më pas konferenca i zhvilloi punimet në katër sesione paralele. Sesioni I: “Siguria rrugore si pjesë e rëndësishme e sigurisë publike. Kërkime shkencore e analiza profesionale”. Sesioni II: “Hetimi, legjislacioni shqiptar dhe veprimtaria policore për sigurinë dhe aksidentet rrugore”. Sesioni III: “Analiza teknike të infrastrukturës rrugore dhe mjeteve rrugore në Shqipëri” dhe sesioni IV: “Kultura e sjelljes së përdoruesve të rrugës dhe roli i edukimit qytetar në sigurinë rrugore”. Në përfundim të katër sesioneve paralele u zhvillua sesioni i përbashkët përmbyllës ku u bënë diskutimet përmbyllëse dhe u dhanë përfundimet dhe rekomandimet e konferencës.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore prezantoi gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit të saj kërkimor shkencor “Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

4.7. Më 11 shkurt 2020 u organizua konferenca V shkencore ndërkombëtare “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

Akademia e Sigurisë, me 11 shkurt 2020 organizoi konferencën e 5-të shkencore ndërkombëtare, me titull: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”. Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të gjithë institucioneve ligjzbatuese e më gjerë, morën pjesë me punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën. Konferenca u organizua në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës “Tor Vergata”, universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, departamentin e shkencave politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, Fakultetin e Drejtësisë në universitetin “Luarasi”, Tiranë; dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe të Bashkisë së Tiranës.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin edhe ministri i Mjedisit e Turizmit, Blendi Klosi; zëvendësministria e Brendshme, Romina Kuko, si dhe zëvendëskryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Robert Wilton.

Në fokus të kësaj konference ishte siguria mjedisore, e cila, në dekadat e fundit, është shndërruar në një nga shtyllat më të rëndësishme të sigurisë njerëzore, të asaj kombëtare e sigurisë ndërkombëtare. Meqenëse siguria mjedisore përqendrohet te hetimi i kërcënimeve që sillen përmes mjedisit, te komuniteti ndërkombëtar i kombeve, te shoqëria dhe te njeriu, atëherë fokusi i kësaj konference ishte i gjerë, gjithëpërfshirës dhe i lidhur me këto kërcënime. Ky fokus do i shërbejë ndërtimit të një kornize të plotë që ka lidhje me sigurinë mjedisore. Kjo kornizë do të jetë në funksion të kthjellimit dhe të rritjes së informacionit e vetëdijes së institucioneve, shoqërisë, agjencive ligjzbatuese dhe Policisë së Shtetit, si institucion, që ka pjesën e vet në drejtim të sigurisë mjedisore.

Krahas fokusit të gjerë të konferencës, specifika e saj, qëndron te evidentimi dhe trajtimi i sigurisë mjedisore në këndvështrimin e përgjegjësive, nevojave, strategjive dhe detyrimeve që dalin para policisë, lidhur me krimet mjedisore. Roli i policisë në zgjidhjen e problemeve mjedisore është i rëndësishëm, për shkak se këto probleme, shpeshherë kanë natyrë kriminale dhe janë me kalime ndërkufitare.

Objekti kryesor i kësaj konference ishte paraqitja e analizave dhe prognozave, si

nga aspekti i hetimit të krimeve mjedisore, edhe në aspektin e trajtimit të sigurisë mjedisore në tërë rrafshin e saj të gjerë, ku ndikimet dhe gërshetimet gjenden te siguria kombëtare e ajo ndërkombëtare. Konferenca pati si objekt përmirësimin e dijes akademike lidhur me sigurinë mjedisore duke kontribuar përmes punimeve shkencore. Kjo dije synohet që t'i shërbejë përmirësimit të nivelit akademik e profesional policor që ka lidhje me krimin mjedisor dhe përballjen me veprat penale që kanë natyrë të tillë apo që gërshetohen me elementin mjedisor.

Ndërsa qëllimi i konferencës ishte trajtimi në mënyrë shkencore të shkallës së rëndësisë së mbrojtjes juridiko-penale të mjedisit; kuptimin e veprave penale kundër mjedisit dhe trajtimin përmes e figurave të përgjithshme të tyre; llojet e veprave penale kundër mjedisit; trajtimin e kuptimit dhe veçorive të hetimit të veprave penale mjedisore, etj. Qëllimi është përmirësimi i sigurisë mjedisore në vendin tonë, përmes kontributit akademik policor e jo vetëm: duke ndarë praktikatat më të mira mjedisore dhe mësimet e nxjerra; duke formuar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh, duke identifikuar aktorët dhe përgjegjësitë, mungesat ligjore dhe rekomandimet për të ardhmen; për paraqitjen e praktikave ekzistuese dhe rekomandime të mëtejshme të kurikulave, programeve e trajnimeve për fushën e sigurisë mjedisore te punonjësit e policisë e më gjerë.

Kjo konferencë synoi të bashkojë njëzëri akademikë, shkencëtarë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të sigurisë, të mjedisit, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj.; prokurorë, gjyqtarë, oficerë të policisë gjyqësore si dhe ekspertë të tjerë për të ndarë eksperiencat, praktikatat, punimet shkencore dhe gjetjet në të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të sigurisë mjedisore. Në përfundim kjo konferencë arriti të sigurojë:

- përforcimin e bindjes në radhët e kërkuesve shkencore dhe jo vetëm se siguria mjedisore është një përbërës i prekshëm, i vërtetë, i qenësishëm dhe shumë i ndjeshëm i sigurisë kombëtare, i çdo shteti dhe, duke bërë qasje specifike te Shqipëria;

- zgjerimin e bashkëpunimit dhe shpënie përpara, të dialogut të sigurisë mjedisore midis aktorëve në vend dhe në rajon;

- rritjen e vetëdijes për çështjet e sigurisë mjedisore, praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e aftësisë themelore të sigurisë mjedisore të Shqipërisë;

- trajtimin e aspekteve ligjore dhe juridike e historike krahasuese, të krimit mjedisor brenda dhe jashtë vendit;

- dhënie e rekomandimeve për përmirësimin e të strukturave përkatëse që trajtojnë këtë problematikë, në kuadër të përmirësimit të punës së policisë për parandalimin dhe reduktimin e dukurisë së krimit mjedisor;

- mbulimin në detaje të së gjitha aspekteve ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve mjedisore në shkallë vendore, në kushtet e Shqipërisë dhe duke shfrytëzuar praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë fushë;

- nxitjen për rritjen cilësore të metodave të hetimit të krimeve mjedisore.

Në këtë konferencë u prezantuar dhe gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit kërkimor të Qendrës Kërkimore Shkencore “Krimi mjedisor krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

Në përfundim mund të themi se në përmbushje të misionit të saj, revista shkencore “Policimi dhe siguria”, si organ periodik, teoriko-shkencor i Qendrës Kërkimore Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ka shërbyer edhe për publikimin e shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të kësaj qendre, të cilat në mënyrë të

Shala, Xh.

« Pesë vite kërkime shkencore, në njëzet numra të revistës “Policimi dhe siguria” »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

përmbledhur i paraqitëm më sipër. Revista ka qenë gjithashtu e hapur për studentët, pedagogët, autorë e kërkues shkencorë nga Akademia e Sigurisë, Policia e Shtetit si dhe për autorë e kërkues shkencorë nga institucione të tjera të sigurisë e të arsimit të lartë në vend. Kjo revistë ka qenë një portë e hapur edhe për kërkuesit shkencor të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike e të strukturave të tjera të sigurisë së Kosovës.

Publikimi i numrit 20-të të revistës shkencore “Policimi dhe siguria” është një eveniment i rëndësishëm për Qendrën Kërkimore Shkencore, Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit, kërkimin shkencor e sidomos për botimet e sigurisë në Shqipëri. Ky eveniment, përveç vlerësimit të arritjeve, do të shërbejë dhe si një moment reflektimi për projekte të reja lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të kësaj revistë por dhe të ideve të reja në fushën e botimeve shkencore të sigurisë në një nivel më të gjerë se mbarëshqiptar.

Shala, Xh.

« Pesë vite
kërkime
shkencore,
në njëzet
numra
të revistës
“Policimi dhe
siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020



Shala, Xh.

« Pesë vite
kërkime
shkencore,
në njëzet
numra
të revistës
“Policimi
dhe siguria” »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë



Dr. Albert HITOALIAJ
Shefi i sektorit të botimeve,
Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë
albert.hitoaliaj@asp.gov.al

Abstrakt

Në këtë material përmbledhës trajtohet ecuria e punës së sektorit të botimeve të Qendrës e Kërkimeve Shkencore, në Akademinë e Sigurisë, përmes një analize të punimeve të botuara në revistën e akademisë, "Policimi dhe siguria". Kjo analizë kryhet me rastin e botimit të numrit të 20-të, i cili shënon edhe mbylljen e një periudhe pesëvjeçare botimesh. Ky punim bën një shpalim të arritjeve dhe problematikave që ka hasur qendra, përgjatë botimit të këtyre numrave të revistës. Analizimi i punës së revistës, apo botimeve në tërësi, ndahet në disa drejtime. E thënë në një mënyrë të thjeshtuar, analizohet puna e artikujshkruesve, cilësia e artikujve, sasia, interesi etj.; e nga ana tjetër, analizohet edhe puna e kryer nga sektori i botimeve për arritjen e publikimit të revistave apo botimeve përmbledhëse të konferencave. Krahas shfaqjes së një panorame të saktë e të paanshme të punës, nxirren në dukje edhe të metat e përgjithshme. Materiali synon gjithashtu, që të vërë në dukje rëndësinë që kanë botimet shkencore, për institucionin e Policisë së Shtetit dhe për fushën e sigurisë publike. Në fund nxirren përfundime dhe jepen disa rekomandime të cilat do të mund të përmirësonin ecurinë e botimeve shkencore të Akademisë së Sigurisë dhe të Policisë së Shtetit në tërësi.

Hitoaliaj, A.

« Botimet
shkencore
të Akademisë
së Sigurisë,
kontribut i
qenësishëm
akademik
në fushën
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

revistë shkencore, botime, "Policimi dhe siguria", botime për sigurinë, Policia e Shtetit.

1. Hyrje

Revista shkencore “Policimi dhe siguria”, botohet nga Qendra e Kërkimeve Shkencore (QKSH) e Akademisë së Sigurisë (AS). Kjo akademi e filloi aktivitetin e saj, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”¹; dhe, bazuar në urdhrin e ministrit të Punëve të Brendshme, nr. 294 datë 5.6.2015², e miratimit të dhënë nga drejtori i Policisë së Shtetit, me nr. 4434, i datës 9.7.2015. QKSH-ja është pjesë e AS-së që nga çelja e akademisë: “Njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë janë: a) Fakulteti i Sigurisë Publike; b) Fakulteti i Hetimit të Krimit; c) Qendra Kërkimore Shkencore”³, dhe që nga ky moment, kjo qendër ka pasur në strukturën e saj sektorin e botimeve⁴, i cili, ndër të tjera, kishte mision edhe realizimin e botimeve. Misioni i qendrës për kërkim shkencor dhe për botime shkencore, si pjesë e aktivitetit të AS-së jepet që në “Hyrjen” e statutit:

“Akademia e Sigurisë, është një institucion publik që synon arsimimin e punonjësve të Policisë së Shtetit e të institucioneve të tjera ligjzbatuese. Kjo akademi do të merret me studime, kërkime shkencore dhe botime në fushat e policimit dhe të sigurisë”⁵.

¹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë” (f. 1566-1567), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2015 - numri 34*, Tiranë: 12 mars 2015.

² Ministri i Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, *Urdhër nr. 294 datë 5.6.2015 “Mbi miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria Punëve të Brendshme, Tiranë: 2015.

³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015.

⁴ Ministri i Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, “Struktura e Akademisë së Sigurisë, Skema nr 1 dhe Skema nr 2” në: *Urdhër nr. 294 datë 5.6.2015 “Mbi miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria Punëve të Brendshme, Tiranë: 2015.

⁵ *Statuti i Akademisë së Sigurisë*, miratuar me Urdhër nr. 490, dt. 21.9.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri dhe të ministrit të Arsimit dhe Sporteve, Lindita Nikolla “Për miratimin e statutit të Akademisë së Sigurisë”, Ministria e Brendshme nr. 6732 prot., Ministria e Arsimit dhe Sporteve nr. 7014 prot.

Hitoallaj, A.

Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë ►

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Ashtu si përcaktohet në “Statutin e Akademisë së Sigurisë”, dy nga detyrat kryesore të QKSH-së janë: “a) kryen kërkime shkencore dhe studime në fushën e policimit dhe të sigurisë në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë së Shtetit; b) realizon botime në fushën e policimit dhe të sigurisë”⁶.

Në këtë mënyrë, nisur nga këto synime, u ndërtua edhe struktura e përshtatshme për botimin e revistës “Policimi dhe siguria”. Kjo revistë e nisi aktivitetin e saj bazuar në urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, nr. 639, të datës 23.7.2015, që çel “Fillimin e botimit të revistës shkencore, periodike, semestrale, e cila të shërbejë për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të Akademisë së Sigurisë në fushën e policimit dhe sigurisë”⁷. Po me anë të këtij urdhri, revista titullohet “Policimi dhe siguria”⁸. Urdhri përcaktonte që revista “Policimi dhe siguria” të drejtohej nga bordi⁹, i përbërë nga: dr. Xhavit Shala (kryetar i bordit), anëtarët: prof. dr. Ilirjan Mandro, prof. dr. Ismet Elezi, prof. asc. Pandeli Taçi, prof. asc. Irakli Koçollari, prof. asc. Ferdinand Elezi, prof. asc. Fatmir Tartale dhe redaktor shkencor dr. Albert Hitoaliaj. Dua të theksoj faktin se rektori i AS-së, dr. Bilbil Memaj, ka mbajtur qysh nga fillimi, një qëndrim motivues, mbështetës dhe inkurajues për botimet shkencore.

Bordi i revistës do të shtohet me disa anëtarë të tjerë, kryesisht të huaj, në vitin 2017. Përmes një urdhri¹⁰ të drejtorit të përgjithshëm, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, bordi editorial i revistës shkencore “Policimi dhe siguria” u zgjerua me këta anëtarë: prof. dr. Giovanni Arcudi, prof. dr. Laura Tafaro (profesor, universiteti i Romës “Tor Vergata”), prof. asc. dr. Snezana Mojsoska (zëvendësdokane, universiteti “St. Kliment Ohridski-Manastir”, Fakulteti i Sigurisë, Shkup), prof. asc. dr. Bejtush Gashi (dekan, Fakulteti i Sigurisë Publike, Akademia e Kosovës për Siguri Publike), dr. Frank Harris (University of Portsmouth), prof. Sebastiano Tafaro (Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Barit); këtij bordi i është shtuar edhe prof. asc. dr. Idriz Haxhija, (drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Rendit e Sigurisë Publike, Ministria e Brendshme). Pjesëtar i këtij bordi ka qenë për një periudhë njëvjeçare edhe prof. asc. Stavri Sinjari, gjatë periudhës që ai mbajti funksionin e “shefit të sektorit të botimeve” në QKSH; për një periudhë njëvjeçare e ka mbajtur këtë funksion edhe prof. asc. Pandeli Taçi, i cili ishte po ashtu anëtar bordi. Aktualisht, funksionin e “shefit të sektorit të botimeve” e mban autori i këtij artikulli, dr. Albert Hitoaliaj, i cili krahas funksionit të redaktorit shkencor, është edhe pjesë e bordit editorial të revistës. Ndryshimet dhe shtimet e bordeve të revistave janë diçka normale dhe sillen këtu për arsye informimi të përgjithshëm. Konferencat shkencore kombëtare e ndërkombëtare, të organizuara nga Akademia e Sigurisë në vitet 2015-2020, kanë pasur borde shkencore të zgjeruara, me emra të nderuar të botës akademike¹¹.

Në 20 numra të botuar, 414 autorë (këtu janë përfshirë edhe autorët e dytë) kanë prezantuar punimet e tyre në faqet e kësaj reviste dhe në konferencat e organizuara nga QKSH, AS. Të njëzetë numrat e revistës “Policimi dhe siguria” kanë një sasi prej 4070 faqesh.

⁶ Ibid., neni 23, f. 12.

⁷ Drejtori i përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë Bilbil Mema, *Urdhër nr. 639, datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, Tiranë: 2015.

⁸ Ibid.

⁹ Ibid.

¹⁰ Drejtori i përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë Bilbil Mema, *Urdhër nr. 236, datë 26.1.2017, “Mbi disa shtesa e ndryshime në Urdhërin nr. 639, dt. 23.7.2015, Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, Tiranë: 2015.

¹¹ Përbërja e bordeve shkencore të konferencave, mund të lexohet, e bashkëlidhur si shtojcë, në fund të revistës.

2. Sfondi historik i revistës shkencore të policisë

Tradita e botimit të një reviste shkencore në Policinë e Shtetit, nuk fillon me këtë revistë shkencore. Revista shkencore gjashtëmujore “Kriminaliteti, rendi dhe policimi”, e botuar në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, nga “Qendra e studimeve dhe kualifikimeve”, nisi botimin në vitin 2000. Botohej përgjithësisht dy herë në vit. Janë nxjerrë dhjetë numra të tillë. Emri i saj ndryshon pas dy viteve të para, nga “buletin shkencor”, në “revistë shkencore”. Bordi i parë i kësaj reviste përbëhej nga: dr. Bajram Yzeiri, prof. asc. dr. Ilir Mandro, dr. Pandeli Taçi, dr. Piro Laze, prof. dr. Ismet Elezi dhe redaktor përgjegjës: dr. Hasan Shkëmbi.

“Kohë më parë, shumë pedagogë, personel kërkimor shkencor dhe specialistë të policisë kanë aspiruar për të patur një botim shkencor ku do të pasqyronin dijet, eksperiencën dhe arritjet kërkimore shkencore të tyre. Kjo dëshirë u bë e mundur me daljen e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, në të cilin Akademia e Policisë cilësohet si shkollë e lartë dhe institucion me të drejta të plota kërkimore shkencore në fushën e policisë.”¹² – thotë në parathënien e numrit të parë të buletinit shkencor 6-mujor, “Kriminaliteti, rendi dhe policimi”, drejtori i Akademisë së Policisë, prof. asc. Luan Veliqioti. Fjala e tij shpreh qartë nevojën dhe mungesën në kohë të një botimi të tillë shkencor. Natyrisht që botimet e mirëfillta shkencore lidhen në mënyrë të pandashme me kërkimin shkencor dhe programet arsimore dhe institucionet e kërkimit shkencor. Pa zhvillimin e arsimit dhe të kërkimit shkencor, strukturave përkatëse, politikave e strategjive në këtë drejtim, vështirë se arrihet në botime shkencore. Dhe Akademia e Policisë, mendohej si institucion bazë i kërkimit shkencor.

“Ky buletin shkencor policor i jepet për herë të parë në dorë lexuesit tonë [...] Finalizimi i botimit të kësaj reviste, dëshmon për nivelin e mendimit praktik e shkencor dhe potencialet intelektuale që ka sot Policia Shqiptare dhe në veçanti Akademia e Policisë që është institucioni bazë formues e kërkimor shkencor dhe garant i së ardhmes së policisë sonë.”¹³ – thotë në përfundim të përshëndetjes së hapjes së kësaj reviste, drejtori i atëhershëm i Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”. Por, numri i fundit i kësaj reviste u botua deri në vitin 2005. Më pas, botimi i saj u ndërpre. Në vitin 2009, u mbyll edhe akademia e asaj kohe¹⁴.

Më 2015-n rihapet Akademia e Policisë, por këtë herë me një format të ri dhe me emrin Akademia e Sigurisë. Po në këtë vit u bënë përgatitjet e duhura dhe doli numri i parë i revistës “Policimi dhe siguria”. Në fjalën përshëndetëse të numrit të parë saj, drejtori i Policisë së Shtetit, drejtues madhor Haki Çako, mban të njëjtin qëndrim, për nevojën e kërkimit shkencor, ashtu siç e kishte shprehur edhe Veliqioti në vitin 2000.

“Që një institucion arsimor të jetë i plotë, ai nuk mund të përfytyrohet pa botimin e një ose disa periodikëve studimorë, kërkimorë e shkencorë; të ketë njësinë e vet shkencore funksionale, e cila nëpërmjet instrumenteve të duhur të shfaqë e të zhvillojë

¹² Luan Veliqioti, “Parathënie”, në: *Buletini shkencor: Kriminaliteti, rendi dhe siguria*, nr. 1 (gusht, 2000): 6.

¹³ Ibid.

¹⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 11.2.2009, “Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Policisë së Shtetit” (fq. 1453), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare*, viti 2009 - numri 24, Tiranë: 10 mars 2009.

Me këtë vendim, akademia pushoi aktivitetin si institucion i arsimit të lartë dhe të ulët dhe u shndërrua në nivelin e një qendre të formimit policor.

Hitoallaj, A.
✦ Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë ✦

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

kërkimin shkencor. [...] E shoh hapjen e kësaj reviste si një shenjë pozitive, të një përpjekje serioze për të ngritur nivelin e arsimit dhe si një hap pozitiv në drejtim të plotësimit të standardeve të kërkimit shkencor, kërkim i cili synohet të jetë pjesë e fuqizimit të nivelit të hapësirave të kërkimit shkencor e analizës profesionale brenda radhëve të Policisë së Shtetit.¹⁵

Në këto pesë vite pune (2015-2020), për sa i përket sasisë së numrave dhe vijmësisë, volumit të punës, tematikës, standardeve të kërkuara për botim etj., revista “Policimi dhe siguria” pasqyron një rast eksperience më të gjerë se sa revista shkencore paraardhëse e policisë, pavarësisht mangësive që mund të ketë, rrethanave në të cilat është zhvilluar puna dhe vështirësive të hasura. Në vijim do të shprehen disa mendime në lidhje me arritjet dhe pikat e dobëta që ka ky botim periodik i Akademisë së Sigurisë.

3. Botimet, pjesë e pandashme e kërkimit shkencor

3.1 Sektori i botimeve si pikë finalizuese e botimeve shkencore

Sektori i botimeve në QKSH të AS-së, realizon botime dhe menaxhon punën për shpërndarjen e rezultateve studimore dhe kërkimore sipas standardeve, në përputhje me nevojat, vizionin dhe prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë së Shtetit, duke përdorur strategji dhe teknika të ndryshme, të shfrytëzueshme si për komunitetin shkencor, ashtu dhe për një lexues më të gjerë.

Ai shpërndan rezultatet studimore në fushën e rendit dhe sigurisë si dhe informon publikun, nëpërmjet publikimeve elektronike (“online”) dhe fizike, promovimeve studimore, diskutimeve në grupe specialistësh, seminareve, simpoziumeve, konferencave, etj. Ai koordinon punën në fushën e botimeve shkencore, të publikimit të tyre, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të Akademisë së Sigurisë dhe me struktura të tjera të Policisë së Shtetit.

Sektori koordinon punën për zhvillimin e një politike të gjerë të bashkëpunimit për kërkimin dhe botimet shkencore me institucionet e tjera kërkimore të arsimit të lartë dhe agjencitë e sigurisë; siguron që botimet dhe publikimet në të gjitha format, të përmbushin standardet e shkrimit akademik, drejtshkrimor dhe të jenë në përputhje me standardet etike dhe normat e pranura mbi pronësinë intelektuale; kërkon nga departamentet dhe drejtoritë përkatëse në DPSH, të dhëna dhe materiale që i gjykon të nevojshme për realizimin e botimeve shkencore dhe të publikimeve, në përputhje me nevojat, vizionin dhe prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë Shtetit.

Ky sektor realizon botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë, tekstet, broshurat, tekstet e ndryshme udhërrëfyese, si dhe produkte të tjera informuese, të shfrytëzueshme si për komunitetin shkencor, ashtu dhe për një audiencë më të gjerë. Sektori bashkëpunon me strukturat mbështetëse të Akademisë së Sigurisë për realizimin e botimeve apo teksteve të tjera informuese ose arsimore, të planifikuara për botim fizik.

3.2 Misioni i revistës shkencore “Policimi dhe siguria”

Revista shkencore “Policimi dhe siguria”, botohet nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë, bazuar në urdhrin nr. 639, datë 23.7.2015, të

Hitoallaj, A.
« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

¹⁵ Haki Çako, “Fjalë përshëndetëse për fillimin e botimit të revistës ‘Policimi dhe siguria’”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 9.

drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”. Revista shkencore “Policimi dhe siguria” me ISSN 2413-1334, është botim periodik i Akademisë së Sigurisë e cila shërben për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të Akademisë së Sigurisë në fushën e policimit dhe sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në Akademinë e Sigurisë dhe më gjerë.

Kjo revistë publikon studime, kërkime shkencore dhe botime në fushat e policimit dhe të sigurisë. Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material i saj nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ribotohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij, në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje të së drejtave të autorit. Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe ligjin “Për arsimin e lartë” si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën “Policimi dhe siguria”, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën “Policimi dhe siguria” gëzojnë liri të plotë akademike, por me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, të zbatojnë legjislacionin përkatës, si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

Revistën e drejton kryetari i bordit editorial të saj, i cili është i emëruar si i tillë nga urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, nr. 639, datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”. Bordi i revistës shkencore “Policimi dhe siguria” dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore, me punën e tyre, synojnë që publikimet në këtë revistë, të përmbushin standardet më të larta të kërkimit shkencor e të integritetit, dhe të jenë në përputhje me standardet etike e normat ndërkombëtare mbi pronësinë intelektuale.

Artikujt e synuar për botim, rekomandohet që të përfshijnë kryesisht këto tematika: rendi dhe siguria publike, siguria kombëtare, parandalimi i kultivimit të lëndëve narkotike, kriminologjia, kriminalistika, mjekësia ligjore, siguria kibernetike, policimi në komunitet, menaxhimi policor, arsimimi dhe trajnimi policor, parandalimi i radikalizmit dhe lufta kundër terrorizmit, parandalimi dhe luftën kundër krimit të organizuar, etj. Revista publikon studime origjinale, punime konceptore, analiza dhe skenarë të trajtuar sipas natyrës studimore, kërkime empirike, studime teknike në lidhje me fusha të ndryshme që ndërthuren me policimin, analiza librash e të tjera.

4. Standardizimi i botimeve përmes numrave me seri

Qysh në momentet e para të fillimit të punës, sektori i botimeve të QKSH-së, u kujdes që botimet të cilat do të realizoheshin nga Akademia e Sigurisë, të ishin në përputhje me standardet më serioze dhe ato të kërkua. Pajisja e botimeve me numra serialë, ishte jo vetëm risi për AS-në, por edhe një standard i plotësuar. Përmes sektorit të botimeve, tashmë AS-ja ka atributet e një shtëpie botuese. Botimet e akademisë janë të pajisura me dy lloje numrash serialë: ISSN dhe ISBN.

Hitoallaj, A.
« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

4.1. Numri standard serial ndërkombëtar (ISSN)

ISSN, është akronim i cili ka kuptimin “International Standard Serial Number” (numri standard serial ndërkombëtar). Ky numër u vendoset të gjithë botimeve periodike, shkencore ose joshkencore. Revistat shkencore mbanë të gjitha një numër të tillë.

“Një ISSN është një kod 8-shifror që përdoret për të identifikuar gazetat, revistat, revistat shkencore dhe revistat periodike të të gjitha llojeve dhe të gjitha medieve: të shtypura dhe elektronike”¹⁶. Këtë numër e mbanë pra, të gjitha publikimet që kanë natyrë të vazhdueshme e të përsëritshme në kohë si p.sh. revistat, gazetat, botimet vjetore, koleksionet, etj. Për shumë vende, pajisja e çdo publikimi me ISSN është një detyrim ligjor. Në Shqipëri nuk funksionon në mënyrë detyruese. Bëjnë përjashtim rastet kur një individ kërkon fitimin e një grade apo titulli shkencor. Në këtë rast, botimi i punimeve shkencore të individit duhet të jetë në “botime të indeksuara”¹⁷.

ISSN-ja ka formën e akronimit të shoqëruar nga dy grupe prej katër numrash, që ndahen me vijë në mes tyre (p.sh. “Policimi dhe siguria”: ISSN 2413-1334). Llogaritja e numrave bëhet me një mënyrë me algoritme dhe çdo numër është unik. Duhet pasur parasysh se ISSN-ja luan thjesht rol në identifikimin e një publikimi. Ajo është një kod numerik i cili nuk përmban ndonjë kuptim të veçantë, të brendshëm; nuk përmban ndonjë informacion mbi origjinën apo përmbajtjen e publikimit dhe, nuk garanton cilësinë apo vlefshmërinë e përmbajtjes. ISSN-ja shoqërohet me titullin e publikimit. Nëse titulli ndryshohet atëherë edhe ISSN-ja duhet të dorëzohet, pasi bëhet e pavlefshme.

Këta numra i lëshon CIEPS (“Le Centre International d’Enregistrement des Publications en Série”) e cila është Qendra Ndërkombëtare për Regjistrimin e Publikimeve Periodike. Ajo është një organizatë ndërqeveritare që administron në nivel ndërkombëtar, identifikimin dhe përshkrimin e publikimeve periodike ose të vazhdueshme, të shtypura ose të publikuara në internet, për çdo temë. Qendra Ndërkombëtare ISSN u krijua zyrtarisht në Paris më 21 janar 1976, nën kushtet e një marrëveshje të nënshkruar në nëntor 1974 midis UNESCO-s dhe Francës, vendi pritës i Qendrës Ndërkombëtare. Pjesëtarë të kësaj qendre, sot janë 90-të vende. Në Ballkan vetëm Shqipëria nuk është pjesë e kësaj qendre, ndërsa në botë, nuk bëjnë pjesë në këtë qendër kryesisht vetëm shtetet afrikane. Për të marrë ISSN-në e revistës “Policimi dhe siguria”¹⁸ është kryer një kërkesë përmes postës elektronike dhe është bërë plotësimi i të dhënave në mënyrë elektronike, në formularin e ofruar përmes internetit nga faqja zyrtare¹⁹. Përdorimi i ISSN-së, si standard i një botimi shkencor, kryhet për herë të parë në historinë e botimeve shkencore e joshkencore të policisë shqiptare.

4.2. Numri ndërkombëtar i standardizuar i librit (ISBN)

ISBN-ja është akronim i cili ka kuptimin “International Standard Book Number”

¹⁶ The International Centre for the registration of serial publications – CIEPS, “What is an ISSN?”, ISSN International Centre, Paris.

¹⁷ <https://www.issn.org/understanding-the-issn/ëhat-is-an-issn/>

¹⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” ” (fq. 2042), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2018 - numri 27*, Tiranë: 2 mars 2018.

¹⁹ Imeli i regjistrimit të ISSN-së: issnic1 <issnic1@issn.org> Dec 2, 2015, 11:55 AM “Dear Sir, Your print publication has been recorded permanently in the ISSN Register as follows: ISSN 2413-1334. Key title: *Policimi dhe siguria*. Data, Network & Standards Department, ISSN International Centre, Paris.

¹⁹ Adresa postare: ISSN International Centre, 45 rue de Turbigo, 75003 Paris, France.

(numri standard ndërkombëtar i librit). ISBN-ja është një kod numerik që shërben për identifikimin e librave. Botuesit e sigurojnë këtë kod nga një degë kombëtare e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-ve. Për çdo libër jepet një ISBN e veçantë, e ndryshme nga libri në libër. ISBN-ja është një standard ndërkombëtar i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit, ISO (“International Organization for Standardization”). Kjo organizatë papublikuar rreth 19 500 standarde të ndryshme ndërkombëtare të cilat përdoren botërisht në shkallë të madhe në fushat e teknologjisë dhe të biznesit²⁰.

Përpara janarit të vitit 2007 ky kod përbëhej nga dhjetë numra ndërsa nga janari i vitit 2007 dhe këtej, kodi përbëhet prej trembëdhjetë numrash. Metoda e vendosjes së një kodi është kombëtare dhe varet nga botimet që bën një vend. Fillimisht vendosja e identifikimit me numra për secilin botim, u krye në vitin 1967 dhe shifra ishte më nëntë numra. Ky numër në atë kohë quhej SBN “Standard Book Numbering” (numërimi standard i librit). Në vitin 1970 u botua nga ISO-s një standard ndërkombëtar, ISO 2108, i cili kishte një kod me dhjetë numra. Në vitin 1998, në vendin tonë krijohet Agjencia Kombëtare e ISBN-së²¹.

4.2.1. Përfitimet nga ISBN-ja

ISBN-ja është identifikues unik ndërkombëtar për botimet monografike; caktimi i një numri të tillë zëvendëson përdorimin e përshkrimeve të gjata bibliografike, duke kursyer kohën dhe mundin e stafit, si dhe zvogëlon mundësinë e gabimeve. Përdorimi i saktë i ISBN-së mundëson dallimin e qartë të formave dhe ribotimeve të ndryshme të një libri, si i shtypur apo digjital, duke siguruar në këtë mënyrë që klienti të marrë versionin që kërkon. ISBN-ja mundëson përpilimin dhe përditësimin arkivave për tregtimin e librit dhe të bazave bibliografike të të dhënave, si p.sh. katalogët e librave në shtyp. Ajo mundëson gjithashtu gjetjen me lehtësi të informacioneve në lidhje me librat që janë në dispozicion.

Porosia dhe shpërndarja e librave realizohet kryesisht nëpërmjet shfrytëzimit të numrit të ISBN-së, pasi është një metodë më e shpejtë dhe më efikase. ISBN-ja lexohet nga kompjuteri dhe ka formën e një numri dhe kodi identifikues 13-shifror (EAN-13). Kjo është një mënyrë e shpejtë e cila shmang gabimet. ISBN-ja është e domosdoshme në menaxhimin e sistemeve elektronike të shitjes nëpër librari. Shumë sisteme të veprimtarive botuese dhe të furnizimit bazohen në ISBN. Grumbullimi i informacioneve të shitjes bëhet përmes ISBN-së. Kjo mundëson monitorimin e sukseseve të formave të produkteve dhe ribotimeve të ndryshme të tyre, si dhe mundëson krahasimin mes fushave të ndryshme të subjekteve, si dhe mes shtëpive të ndryshme botuese. Në disa shtete, e drejta kombëtare për të huazuar bazohet gjithashtu në sistemin e ISBN-së. Skemat e tilla u mundësojnë autorëve dhe ilustruesve që të paguhen në përpjesëtim me atë se sa herë u janë huazuar librat nëpër bibliotekat publike etj.²²

4.2.2. Akademia e Sigurisë dhe përdorimi i ISBN-së për botimet e policisë

Akademia e Sigurisë botimet e saja tashmë i pajis me ISBN. Duke marrë atributet e një shtëpie botuese, AS-ja e kryen veprimtarinë e saj botuese, në përputhje me ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.

Hitoallaj, A.
 « Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
 nr.20, 2020

²⁰ International ISBN Agency, “ISBN Standard”, <https://ëëë.isbn-international.org/content/isbn-standard>.

²¹ “Krijohet Agjencia Kombëtare e ISBN-së në vendin tonë”, *Buletini i Bibliotekave*, nr. 1 (1998), Tiranë.

²² Majlinda Toçi, përk., *Manuali i përdoruesve të ISBN-së*, (Londër: Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, 2012), 6. <http://www.bksh.al/ISBN/ManualISBN.pdf>

10238, datë 18.2.2010, sipas të cilit “Botues” konsiderohet *personi fizik ose juridik, që zgjedh dhe përgatit për botim veprat e krijuara të autorëve, realizon ose porosit proceset industriale për shndërrimin e tyre në libra*²³.

Nëpërmjet sektorit të botimeve të QKSH-së, Akademia e Sigurisë mund të botojë publikime të indeksuara me kodin ISBN, për nevojat e saja, ose të pajisë me ISBN edhe botime të tjera të Policisë së Shtetit. Në vitin 2015 akademia lidhi kontratë me Agjencinë Kombëtare të ISBN-së. Kjo agjenci pajis me ISBN për botimet e tyre, të gjithë botuesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mban regjistrat kombëtarë të ISBN-ve, identifikuesit e botuesve, identifikuesit për çdo botim dhe dërgon pranë Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së (Londër) të gjitha të dhënat e botuesve si dhe identifikuesit e tyre. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ne si akademi, janë kryer të gjitha këto veprime nga agjencia.

Regjistrimi pranë Agjencisë Kombëtare të ISBN-së realizohet nëpërmjet lidhjes së një kontrate vjetore midis botuesit, Akademisë së Sigurisë, dhe agjencisë, në përputhje me nenin 28 të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Kjo kontratë ka qenë e përsëritur dhe vepruese përgjatë pesë viteve të fundit. Për marrjen e ISBN-së, për çdo botim duhet të paraqitet kërkesa dhe të ndiqen hapat e kërkuar nga agjencia. Akademia e ka kryer këtë procedurë përmes sektorit të botimeve.

Agjencia, nisur nga disa mungesa dhe pasaktësi të hasura në libra të botuar në Shqipëri, ka përcjellë shqetësimin e vazhdueshëm të specialistëve të bibliotekave lidhur me të dhënat bibliografike që botuesit vendosin në librat e tyre. Duhet përmendur se botimet e AS-së kanë qenë në përputhje të plotë me kriteret e kërkuara nga specialistët e bibliotekave. Në vija të përgjithshme, standardet e përshkrimit bibliografik janë respektuar në të gjitha paraqitjet e botimet e AS-së, duke vendosur të gjitha të dhënat bibliografike të domosdoshme. Botimet e akademisë kanë zbatuar me përpikëri “Standardin ndërkombëtar të përshkrimit bibliografik” (ISBD), i cili tregon se cilat janë ato të dhëna bibliografike që duhen, e po ashtu, edhe hierarkinë e vendosjes së tyre në botime.

Mungesa në botime e elementeve thelbësore të përcaktuara nga ky standard, krijojnë vështirësi për bibliografët gjatë procesit të përgatitjes së informacionit bibliografik, për rrjedhojë edhe për përdoruesit e bibliotekës, pra vështirëson procesin e gjetjes së informacionit, çfarë nuk është në të mirë të leximit të veprave që botohen.

Identifikimi dhe përzgjedhja e librave do të vështirësohej pa të dhëna të tilla të sakta që kanë të bëjnë me autorin e librit, kontribuuesit në paraqitjen e tekstit (redaktorë, përkthyes, ilustrues etj.), titullin, edicionin, vitin dhe vendin e botimit, emrin e botuesit, formatin etj. Këto të dhëna të “furnizuara” nga botuesi përpunohen dhe strukturohen sipas standardit të përmendur më lart nga bibliotekat, çfarë mundëson dhe lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit për librat në rrjetin e bibliotekave dhe të tregtisë së librit.

Akademia e Sigurisë ka zbatuar me korrektësi të gjitha këto standarde bibliografike. Botimet e AS-së dhe të policisë mund të jenë të pajisura me ISBN tashmë. Ky standard botimesh është zhvilluar për herë të parë në policinë shqiptare, pasi nuk ka pasur asnjë rast të mëparshëm që ndonjë sektor i saj të ketë pasur atributet ligjore të një enti

Hitoallaj, A.
« Botimet
shkencore
të Akademisë
së Sigurisë,
kontribut i
qenësishëm
akademik
në fushën
e sigurisë »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

²³ Neni 3 “Përkufizime”, ligji nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, (fq. 4384), Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2006, numri 112, Tiranë: 25 tetor 2006.

botues. Akademia e Sigurisë sot përfaqëson një shtëpi botuese që është në përputhje me ligjet në fuqi dhe me standardet e kërkuara për botimet. Nga ana tjetër, pajisja me ISBN e botimeve të punimeve shkencore të konferencave, ose kërkimeve shkencore në tërësi, përbën një detyrim akademik²⁴, i cili është zbatuar me rigozitet në çdo botim të AS-së.

4.3 Realizimi teknik i botimit të revistës

Realizimi teknik i botimit të revistës shkencore “Policimi dhe siguria” kryhet nga sektori i botimeve të Qendrës së Kërkimeve Shkencore dhe mbulohet nga buxheti i Akademisë së Sigurisë. Por revista fton dhe është e hapur edhe për bashkëpunime e kontribute prej të tretëve. Në disa raste, falë bashkëpunimeve të realizuara, është arritur edhe përfitimi i financimeve për botimin e përmbledhjeve të punimeve të konferencave të ndryshme. Për ndjekjen e realizimit të botimit përgjigjet sektori i botimit të QKSH-së. Në rastin e revistës, për shkak të specifikës së punës në faqesje me referencat etj., redaktori shkencor (A. H.) i saj ka realizuar edhe faqesjen dhe përpunimin grafik të së gjithë numrave të revistës “Policimi dhe siguria”²⁵.

“Policimi dhe siguria” publikohet në versionin fizik dhe mund të gjendet edhe në atë elektronik në faqen tonë të internetit.

5. Vlerësime të shkurtra mbi cilësinë e punimeve të revistës “Policimi dhe siguria”

Përpara se të bëjmë një vlerësim të shkurtër mbi cilësinë e artikujve të revistës “Policimi dhe siguria” dhe të natyrës së tyre, le të japim disa shpjegime të përmbledhura mbi tiparet e artikujve dhe të revistave shkencore. Artikujt e revistave të tilla mund të përfshijnë kërkime origjinale, rishikime hulumtimesh, recensione apo shqyrtime literature në një fushë specifike, propozime teorish të reja por të paprovuara, ose edhe mendime të shprehura në formë qëndrimesh. Një artikull shkencor është një botim i cili bazohet në prova empirike. Mund të mbështesë një hipotezë me hulumtime origjinale, të përshkruajë hulumtimin ekzistues ose të komentojë mbi prirjet aktuale në një fushë të caktuar²⁶. Provat shkencore të dhe interpretimi sipas metodës së përzgjedhur shkencore, mund të pasurohen e mbështeten edhe me analiza statistika, në varësi të fushës.

Revistat shkencore, përfaqësojnë mjetet më jetike për shpërndarjen e gjetjeve të kërkimit shkencor dhe zakonisht, janë të specializuara për disiplina të ndryshme akademike, ose për nëndisiplina. Shpeshherë, hulumtimi sfidon supozime të zakonshme

²⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” (fq. 2042), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2018 - numri 27, Tiranë: 2 mars 2018.*

²⁵ Shënim, Albert Hitoallaj: cilësia grafike dhe fizike e botimit të revistës “Policimi dhe siguria” ka qenë një standard i ruajtur me rigozitet nga Qendra Kërkimore Shkencore dhe Akademia e Sigurisë. Duke qenë se kam kryer të gjithë përpunimin e materialeve, kam realizuar dizajnin e faqesjen e çdo numri reviste, si dhe kam ndjekur ecurinë e zbatimit të specifikimeve teknike nga shtypshkronjat që kanë fituar të drejtën e botimit, flas me siguri të plotë, se revista “Policimi dhe siguria”, përbën një rast të rrallë në Shqipëri, për sa i përket botimit të saj në letër. Ajo është një revistë më cilësi të lartë grafike dhe me cilësi të lartë shtypshkrimi.

²⁶ Wayne W. LaMorte, “What is a Scientific Article?” në: *Overview of Critical Reading. How to Critically Review an Article* (Boston: Boston University, 2016).

http://sphweb.bumc.bu.edu/otlt/MPH-Modules/EP/EP713_CriticalReview/EP713_CriticalReview2.html

Hitoallaj, A.
« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

ose të dhëna hulumtuese, të cilat janë të paraqitura në literaturën shkencore të botuar, në mënyrë që të ndërtohet një kuptim më i qartë i fakteve dhe i gjetjeve. Në varësi të politikave të një reviste shkencore të caktuar, artikujt mund të jenë që nga hulumtime, kërkime origjinale e deri te rishikime të hulumtimeve të të tjerëve²⁷.

5.1 Struktura e artikujve shkencorë

Nëse do të përshkruanim strukturën apo anatomicën e një artikulli shkencor të përgjithshëm, pjesët e tij do të ishin këto: titulli, autori, abstrakti, hyrja, metodologjia, rezultatet, diskutimi, përfundime, rekomandime, burimet e përdorura ose bibliografia, tabela, figura. Po të shohim të gjithë numrat e revistës “Policimi dhe siguria” do të vëmë re se artikujt ruajnë një format të ngjashëm me këtë që përmendëm. Por duhet thënë se ka problematikë në këtë drejtim. Krahas shumë artikujsh që vijnë sipas kërkesave e standardeve që flasim, ka edhe të tjerë që nuk e ruajnë strukturën. Ka raste që u mungon ndarja e brendshme sipas një strukture të nevojshme për një artikull shkencor; mungon abstrakti, hyrja apo bibliografia, etj. Kjo gjë lidhet kryesisht me një mangësi të përgjithshme në fushën e të shkruarit, në vendin tonë, e cila shtrihet në çdo nivel të studiuesve apo kërkuesve të ndryshëm.

Këto mangësi reflektohen kryesisht në artikuj të ndryshëm, në fazën e grumbullimit të materialeve. Me anë të komunikimeve kemi bërë të mundur sistemimin e tyre. Ndërkaq, ka edhe studiues të zellshëm dhe të kujdesshëm që kanë sjellë materiale shumë cilësore. Një problematikë si kjo e përmendura, ekziston edhe për shkak të mungesës së angazhimit për të realizuar shkrime kërkimore. Jemi përpjekur që ta pakësojmë shkallën e këtij problemi dhe mendojmë se kemi arritur të kemi një ecuri të pranueshme, pozitive, për sa i përket orientimit të shkruarve drejt standardeve të kërkuara. Por nuk jemi të kënaqur plotësisht dhe synojmë përmirësim të mëtejshëm.

5.2 Burimet dhe konceptimi teorik i fenomeneve të studiara

Përdorimi i burimeve në artikujt kërkimorë të revistës “Policimi dhe siguria” ka qenë i kënaqshëm. Nëse vëren në tërësi punimet e revistës, vihet re se autorët u janë referuar në mënyrë të shpeshtë burimeve të ndryshme për kërkimet e tyre. Burimet jo rrallë herë janë edhe arkivore. Nuk mungojnë as burimet parësore të cilat janë siguruar përmes ndërtimit të pyetësorëve, anketimeve, intervistave etj. Në këtë drejtim ka bërë një punë të lavdërueshme QKSH-ja. Kjo e fundit, thuajse në të gjitha konferencat është paraqitur me punime apo studime origjinale, të pasuruara me statistika të shumta. Kjo gjë nuk është vetëm arritja e një standardi, por krahasuar me historinë e shkrimeve shkencore dhe kërkimit shkencor brenda strukturave të policisë, përdorimi i këtyre statistikave, përbën arritje të një niveli më të lartë hulumtimi.

Krahas këtyre burimeve, autorët në një pjesë të madhe të shkrimeve të tyre u janë referuar gjerësisht ligjeve dhe akteve të ndryshme. Bordi i revistës ka mbajtur një qëndrim të palëkundur për sa i përket pasqyrimin të burimeve përmes referencave. Ka pasur raste kur kjo gjë është nënvlerësuar nga autorë të ndryshëm, por është punuar që në artikujt të përfshihen saktësisht burimet. Problematika e citimit të burimeve në Shqipëri është e madhe dhe shpeshherë ajo, me vetëdije ose në mënyrë aksidentale, mbështet plagjiaturën. Kjo problematikë citimesh e burimesh nuk e ka lënë pa prekur edhe

Hitoallaj, A.
« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

²⁷ APA, What Are Scientific Journals?, Në:
<https://www.apa.org/advocacy/research/defending-research/scientific-journals>

revistën “Policimi dhe siguria”. Kemi punuar në mënyrë konstante me ato materiale që kanë pasur një problematikë të tillë. Në një pjesë të madhe të rasteve citimi i burimit qëllon që të nënvlerësohet, duke e dëmtuar në këtë mënyrë cilësinë e punimit. Ndodh që autorë të caktuar, edhe pse të pajisur me një eksperiencë afatgjatë në fusha të ndryshme, kur shkruajnë, janë të prirë më shumë që të sjellin një argument se sa të ruajnë standardet e të shkruarit shkencor. Ky defekt vjen për shumë arsye, por e thënë me pak fjalë: kultura e përgjithshme e të shkruarit në format akademik, në vendin tonë është e pakultivuar mirë.

Krahas problemit të mungesës apo mosvendosjes së burimeve, është edhe problemi i keqvendosjes së citimeve. Përdorimi i mangët i stileve të citimit është një problem mbarëkombëtar në Shqipëri. Nuk mund të bëjmë përgjithësime, pasi ka punime shumë korrekte, por kemi si synim vënien në dukje të problematikës së punës. Ndërtimi i bibliografisë së punimeve dhe mënyra e të cituarit të burimeve sipas një stilit të caktuar citimi, nuk respektohet te të gjithë autorët. Ndërhyrja te burimet shpeshherë është e pamundur pasi nuk ekziston informacion i plotë mbi to, për t’i redaktuar; nga ana tjetër është një redaktor nuk mund të transformojë burimin pasi, nuk e ka shfletuar vetë. Në revistën tonë kërkojmë përdorimin e stilit të citimit *Chicago stajl* (“Chicago style”), por pavarësisht se autorët citojnë burime, në një pjesë të madhe të rasteve nuk zbatojnë kërkesën që paraqesim në thirrjen për botim²⁸. Përpos kësaj, punimet përdorin referime. Ky që përmendim është një problem i përgjithshëm i kërkimit shkencor në vendin tonë.

Për sa i përket qartësisë dhe saktësisë së hipotezës në shkrime, duhet thënë se shkrimet reflektojnë përgjithësisht qartësi në formulimet e tyre. Konceptimet teorike të fenomeneve të studiuara janë të kënaqshme. Një rezultat më të mirë në këtë drejtim mund ta vëmë re në punimet e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Në këto të fundit, tregohet se ka zotërim të koncepteve nga ana e autorëve dhe shfaqja e tyre kryhet pa gabime e kuptohet gjerësisht. Përdorimi i burimeve në këto raste, pavarësisht problemeve të përmendura, tregon kryesisht njohje të thellë të fushave të studiuara. Referimi ndaj burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ka pasur një raport të kënaqshëm në shumë punime serioze.

5.3 Cilësia e argumentimit, përcaktimi i qartë i çështjes së hulumtuar dhe i pyetjeve kërkimore

Në pjesën më të madhe të punimeve qëllimi dhe pyetjet kërkimore paraqiten në mënyrë të qartë, të justifikuar dhe të lidhura mirë të dhënat. Temat e trajtuara, sidomos ato të konferencave të organizuara nga Akademia e Sigurisë, kanë pasur rëndësi kombëtare, dhe jam i mendimit se do t’i rezistojnë kohës. Arsyet për rëndësinë e tyre janë paraqitur dhe shtjelluar mirë në botimet përkatëse. Duke qenë se në këto raste kemi zhvilluar hulumtime të fokusuara, kjo gjë ka sjellë risi me rëndësi shkencore. Përcaktimi i problemeve të trajtuara në punimet e këtyre konferencave ka qenë një i një niveli të lartë dhe risi në këtë fushë.

Nuk mund të thuhet për të gjitha punimet se kanë sjellë risi apo kanë realizuar hulumtime të qëndrueshme në kohë. Por kjo gjë nuk e ul vlerën e shumë punimeve të cilat kanë qenë të vlefshme. Në tërësi kemi të bëjmë me punime origjinale dhe herë-

Hitoallaj, A.
 « Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

²⁸ Në fund të revistës, si shtojcë, do të gjeni të bashkëlidhur një model të “thirrjes për botim” që përdorim para çdo numri reviste.

herë të dobishme pasi kanë trajtuar tema të parrahura, si të fushës së sigurisë publike, edhe të fushave të tjera që kanë lidhje me sigurinë në kontekstin më të gjerë të saj. Janë paraqitur punime të cilat kanë realizuar metoda të grumbullimit së të dhënave në mënyrë kompetente. Përdorimi i këtyre është përshtatur me përpikëri në përmbushje të nevojave të hulumtimit, përfshirë këtu edhe zhvillimin metodologjik. Duke qenë se të dhënat e mbledhura në mënyrë të kujdesshme, dhe burimet në tërësi, mundësojnë përfundime dhe dëshmi të besueshme shkencore, mund të themi se vihet re një nevojë e orientimit të shkrimeve kërkimore drejt përpunimit statistikor.

Nuk kanë munguar në këto numra reviste analizat sistematike dhe të orientuara në qëllime; përdorimi i metodave të përshtatshme e të avancuara të analizës; zhvillimi i analizave të nivelit të lartë metodologjik, të matura, përmes shfrytëzimit të të dhënave në mënyra të ndryshme. Në këto punime detajet e të dhënave që ofrohen janë të shumta.

Prezantimi i rezultateve dhe përgjigjet ndaj pyetjeve hulumtuese, në një pjesë të madhe të punimeve janë paraqitur saktë dhe shfaqet qartë korrelacioni i synuar. Por jo gjithmonë, rezultatet e arritura nga studime të caktuara, u përgjigjen pyetjeve kërkimore në mënyrë logjike dhe nuk shfaqet mirë modeli teorik që trajtojnë.

Për sa i përket interpretimit të rezultateve ose diskutimit që zhvillohet në punimet e publikuara, mund të themi se në tërësi respektohet stili shkencor i të shkruarit. Mangësitë janë të pranishme, por e parë në kornizën e përgjithshme, duhet pranuar se ka angazhim nga autorët, për qasje sa më shkencore në trajtimin e çështjeve që ata ngrenë.

Një element shumë i rëndësishëm që lidhet me punimet shkencore, është edhe përdorimi sa më i saktë i gjuhës së shkruar shqipe. Problemi i parë qëndron të përkthimet e burimeve. Një pjesë shumë e madhe e punimeve që botohen në Shqipëri përdorim burime të huaja. Në këtë mënyrë, autori, nga njëra anë duhet të ketë njohuri të mira mbi gjuhën e huaj që përkthen dhe nga ana tjetër, duhet të zotërojë mirë gjuhën shqipe dhe të ketë një fjalor të larmishëm e të pasur. Rastet kur përkthimet kanë probleme janë prezent edhe në punimet e revistës sonë. Problematika e sjellë këtu është kombëtare dhe i përket një periudhe kohore që zgjat me dekada. Vështirësisë së njohjes së gjuhës, i shtohet edhe mungesa e fjalorëve profesionalë terminologjikë në gjuhën shqipe, për fusha të caktuara. Këta fjalorë do të përcaktonin se cilat janë termat e saktë që duhet të përdoren apo të huazohen etj. Mungesa e tyre, në njëfarë mënyrë, u ka falur liri dhe hapësirë të madhe veprimi autorëve, të cilët, shpeshherë, bëjnë transformime në shqip të fjalëve në gjuhë të ndryshme të huaja. Teknologjia, jurisprudenca, siguria, shkencat politike e sociale etj., nevojitet që të kenë një pasurim me terma të reja shqip. Kjo gjë, ndihet si nevojë, për shkak të zgjerimit të përdorimit të burimeve të huaja dhe të ndikimeve që kanë gjuhët e huaja te shqipja. Rregullimin e kësaj situatë mund do të mund ta bënte një ndërhyrje gjuhëtarësh profesionistë dhe një strategji shtetërore që ka të bëjë me problemin që flasim. Punimet e botuara në revistën "Policimi dhe siguria" ruajnë një nivel përgjithësisht të mirë gjuhësor, por mund të gjesh te to gabime gramatikore ose edhe sintaksore. Trysnia e kohës në raste të ndryshme ka çuar drejt përpunimit të shpejtë të materialeve për botim. Nga ana tjetër, ekziston një problematikë, e cila lidhet sa me shkrimin akademik aq edhe me lidhjen dialektike të gjuhës me mendimin. Kjo lidhje, reflektohet të sintaksa e shkrimeve.

Ka raste artikujsh, ku individë të caktuar, kanë prirje, zotësi dhe njohje të thellë të profesionit e tyre, por nuk arrijnë të ndërtojnë një strukturë të saktë të shprehjes së

mendimit përmes shkrimit. Në cakun tjetër, ka pasur raste, jo të pakta, ku artikujshkruesit zotërojnë në mënyrë të lakmueshme shkrimin dhe mendimin profesional.

6. Përfundime

Në përfundim të kësaj analize, jo shumë të gjatë, mbi ecurinë e botimit të revistës “Policimi dhe siguria”, do të përmend disa në mënyrë shumë të përmbledhur rëndësinë dhe problematikën e punës që ka botimi i saj:

- revista “Policimi dhe siguria” është e vetmja revistë shkencore institucionale që trajton çështjet e sigurisë në rrafshin publik dhe të sigurisë kombëtare në vendin tonë;

- nuk ka asnjë revistë tjetër shkencore në Shqipëri, që të analizojë në mënyrë shkencore punën dhe problematikën saj në Policinë e Shtetit;

- nuk ka asnjë institucion sigurie në Shqipëri, që të ketë një revistë shkencore të tillë, të ngjashme ose edhe thjesht shkencore;

- Akademia e Sigurisë, përmes botimeve të saja i ka siguruar Policisë së Shtetit fillimin e një procesi botues afatgjatë, që mund të shndërrohet në traditë të botimeve shkencore në polici;

- standardizimi i botimeve të AS-së me ISBN dhe ISSN, përbën ngritjen e në një stad të ri të përfaqësimit të kërkimit dhe të mendimit brenda radhëve të autorëve të policisë e më gjerë: të fushës së sigurisë;

- të qenit thuajse unik në këtë drejtim, nuk përlij me doemos cilësinë e shkrimeve, por përlij vazhdimësinë e krijimit të një hapësire ku të zhvillohet mendimi kritik shkencor në fushën e sigurisë;

- interesi i vazhdueshëm për të shkruar në faqet e kësaj reviste është tregues se botime të tilla nuk janë të tepërta;

- reformimi i institucionit të Akademisë së Sigurisë, si institucion i arsimit të lartë, sjell nevojën e pandashme, të padiskutueshme dhe të këshillueshme, të zhvillimit të kërkimit shkencor në një rrafsh më të lartë;

- nuk mund të konceptohet kërkimi shkencor pa pasur botime shkencore;

- revista shkencore “Policimi dhe siguria” e krahasuar me revista të ngjashme, të mëparshme apo edhe aktuale, qëndron në pozita serioze dhe reflekton një angazhim dhe një punë e cila motivon kërkimin shkencor;

- shpërndarja e botimit fizik të kësaj reviste shkencore në një sërë institucioneve kombëtare dhe rajonale, ka prodhuar një përshtypje tejet pozitive për punën e AS-së dhe të Policisë së Shtetit në tërësi;

- nisur nga shkëmbimi i mendimeve me kolegë të stafëve pedagogjike të institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, në konferenca e aktivitete të ndryshme të realizuara nga AS-ja, mund të thuhet me siguri, se vlerësimi për revistën ka qenë me tonet më pozitive dhe përgëzimet nuk kanë munguar;

- vështirësitë e botimit të kësaj reviste nuk kanë munguar dhe duke ruajtur me korrektësi datat e thirrjeve e të botimit, është punuar shpeshherë në skajet më të shtyra kohore, e kjo gjë ka sjellë tek-tuk probleme të caktuara teknike;

- revista “Policimi dhe siguria” e ka përmbushur misionin e saj me sukses dhe ka lënë pas një prodhim të dallueshëm i cili është krijuar falë punës së palodhur të sektorit të botimeve, të drejtorit të QKSH-së dhe falë vizionit e mbështetjes së rektorit të AS-së;

- gjatë periudhës pesëvjeçare 2015-2020, revista “Policimi dhe siguria” e Qendrës

Hitoaliaj, A.

« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

Kërkimore Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ka lënë një gjurmë historike serioze që ka lidhje me botimet dhe kërkimin shkencor, brenda Policisë së Shtetit e më gjerë.

7. Rekomandime

Vijimësia. Për të pasur një kërkim shkencor të përparuar, nevojitet që botimet shkencore, si mjedisi natyral i zhvillimit të mendimit shkencor, të jenë në lartësinë e duhur. Për këtë arsye, duhet të ketë një strategji afatgjatë për botimet shkencore, qofshin ato periodike, d.m.th. revista, qofshin studime voluminoze, të botuara si libra. Po flasim për një strategji të kërkimit shkencor e cila të lidhet në mënyrë të pandashme me zhvillimin e Akademisë së Sigurisë si institucion i arsimit të lartë. Raporti arsim-kërkim shkencor do të mund të garantonte edhe ngritjen e cilësisë së mendimit kritik, të produktit shkencor në fushën e sigurisë, të analizave profesionale shkencore mbi aktivitetin e policisë, të kërkimeve shkencore mbi fenomene sociale që kanë lidhje me natyrën e punës së policisë etj. Në këtë këndvështrim, vijimësia e botimit të revistës “Policimi dhe siguria” duhet jo vetëm të ruhet, por të përmirësohet dhe të mbështetet me çdo mënyrë. Ajo është një vlerë që i përket jo vetëm Akademisë së Sigurisë, por edhe Policisë së Shtetit.

Shpërndarja. Në të ardhmen, duhet që punimet e kësaj reviste të kenë një shpërndarje sa më të gjerë elektronike dhe të bëhen pjesë e rrjeteve të ndryshme të literaturës shkencore. Deri më sot ka pasur një mbulim të mirë të hedhjes në internet të së gjithë numrave të revistës “Policimi dhe siguria”. Nevojitet që të krijohet një faqe interneti më profesionale për Akademinë e Sigurisë, ku të ketë të integruara më mirë përmbajtjen e aktiviteteve, botimeve etj. Një faqe e tillë do të mundësonte edhe hedhjen e partikujve të veçantë, shfletimeve përmes internetit etj., të literaturës shkencore të botuar nga AS-ja. Me pak fjalë, nevojitet përmirësimi i paraqitjes elektronike; nevojitet edhe një shpërndarje më e gjerë.

Cilësia. Rekomandohet që të kërkohet rritja e cilësisë së punimeve, sidomos e përmirësimit të strukturës, e punës me burimet dhe të kërkohet me insistim zbatimi i një disipline të rreptë të mënyra e citimit dhe ndërtimi i bibliografisë.

Zgjerimi i botimeve. Botimi i revistës duhet të shoqërohet edhe me botime të tjera dhe fusha e sigurisë publike duhet të jetë e pasur dhe pajisur me literaturë shkencore. Kjo literaturë mund të jetë e natyrës studimore dhe e realizuar nga autorë të ndryshëm, por mund të ketë edhe natyrën e përkthimeve apo të teksteve mësimore. Nevojitet shtimi i botimeve dhe i punës botuese si në mjedisin akademik të AS-së edhe në atë të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Botime në anglisht. Në të ardhmen duhet të synohet që botimet shkencore të AS-së të jenë edhe në gjuhë të huaj; kryesisht në anglisht ose ndoshta në ndonjë gjuhë tjetër specifike, po qe se ka botime të veçanta. Një revistë shkencore në anglisht, për sigurinë publike, policimin dhe çështjet që lidhen me aktivitetin e policisë në rajon, mund të ishte e arritshme. Për hir të së vërtetës, ideja e krijimit të një reviste me bashkëpunimin e akademive të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, është diskutuar nga QKSH-ja me rektorin e AS-së. Në parim ideja është pranuar dhe mbështetur, por nuk kemi arritur që të hedhim hapa të mëtejshëm. Për të pasur zhvillime të reja, të kësaj natyre, nevojiten burime njerëzore dhe financiare. Këto duhet të ishin të gërshetuara më një strategji afatgjatë të kërkimit dhe të botimeve. Por, e theksoj, botimet shkencore në anglisht ose gjuhë të tjetër të huaj, janë shumë të pakta në gjithë hapësirën shqiptare. Kjo që sapa nënvizova, duhet nënvizuar me një vijë të dytë të dytë të kuqe, sepse botimet e pakta

Hitoallaj, A.
« Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë »

Policimi dhe siguria
nr.20, 2020

shkencore në gjuhë të huaj, janë akoma dhe me të pakta kur bëhet fjalë për fushën e sigurisë. Gjendemi kësisoj, përballë detyrimit të plotësismit të këtij boshllëku.

Botimet fizike. Bazuar në eksperiencën që kam në fushën e botimeve, jam i bindur se botimet fizike janë të pazëvendësueshme. Për këtë arsye, do të rekomandoja që revista “Policimi dhe siguria” të mos ketë cungime ekstreme të prodhimit e paskëta të shpërndarjes së kopjeve fizike. Në fund të fundit, Akademia e Sigurisë, duke u bërë e pranishme në çdo institucion ku shpërndahet revista “Policimi dhe siguria”, bën të pranishme njëkohësisht edhe punën e Policisë së Shtetit. Të gjitha reagimet që kemi pasur nga personat dhe institucionet që u është dërguar revista jonë, kanë qenë shumë inkurajuese, vlerësuese dhe me nota të pakursyera lëvdatash për cilësinë e revistës dhe të punimeve të saja. Në vetvete, ky është një vlerësim pozitiv i cili u nderon punën e Akademisë së Sigurisë e padyshim edhe të Policisë së Shtetit.

Shqipëria është një vend me boshllëqe të mëdha në fushën e botimeve. Duhet mbajtur ndezur procesi i botimeve, pavarësisht defekteve, pamundësive, mungesës së vazhdimësisë etj. Një botim fizik, mbetet: *Verba volant, scripta manent!*

Burimet e shfrytëzuara

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë” (f. 1566-1567), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2015 - numri 34*, Tiranë: 12 mars 2015.
2. Ministri i Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, *Urdhër nr. 294 datë 5.6.2015 “Mbi miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria Punëve të Brendshme, Tiranë: 2015.
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015.
4. *Statuti i Akademisë së Sigurisë*, miratuar me Urdhër nr. 490, dt. 21.9.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri dhe të ministrit të Arsimit dhe Sporteve, Lindita Nikolla “Për miratimin e statutit të Akademisë së Sigurisë”, Ministria e Brendshme nr. 6732 prot., Ministria e Arsimit dhe Sporteve nr. 7014 prot.
5. Drejtori i përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë Bilbil Mema, *Urdhër nr. 639, datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, Tiranë: 2015.
6. Drejtori i përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë Bilbil Mema, *Urdhër nr. 236, datë 26.1.2017, “Mbi disa shtesa e ndryshime në Urdhrin nr. 639, dt. 23.7.2015, Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”*, Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, Tiranë: 2015.
7. Luan Veliqioti, “Parathënie”, në: *Buletini shkencor: Kriminaliteti, rendi dhe siguria*, nr. 1 (gusht, 2000): 6.
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 11.2.2009, “Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Policisë së Shtetit” (fq. 1453), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2009 - numri 24*, Tiranë: 10 mars 2009.
9. Haki Çako, “Fjalë përshëndetëse për fillimin e botimit të revistës ‘Policimi dhe siguria’”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 9.
10. The International Centre for the registration of serial publications – CIEPS, “What is an ISSN?”, ISSN International Centre, Paris.
<https://www.issn.org/understanding-the-issn/what-is-an-issn/>
11. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.2.2018, “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” (f. 2042), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2018 - numri 27*, Tiranë: 2 mars 2018.
12. International ISBN Agency, “ISBN Standard”, <https://www.isbn-international.org/content/isbn-standard>.
13. “Krijohet Agjencia Kombëtare e ISBN-së në vendin tonë”, *Buletini i Bibliotekave*, nr. 1 (1998), Tiranë.
14. Majlinda Toçi, përk., *Manuali i përdoruesve të ISBN-së*, (Londër: Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, 2012), 6.
<http://www.bksh.al/ISBN/ManualISBN.pdf>
15. Neni 3 “Përkufizime”, ligj nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, (f. 4384), *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, viti 2006, numri 112*, Tiranë: 25 tetor 2006.
16. Wayne W. LaMorte, “What is a Scientific Article?” në: *Overview of Critical Reading. How to Critically Review an Article* (Boston: Boston University, 2016).
http://sphweb.bumc.bu.edu/otlt/MPH-Modules/EP/EP713_CriticalReview/EP713_CriticalReview2.html
17. APA, *What Are Scientific Journals?*, në:
<https://www.apa.org/advocacy/research/defending-research/scientific-journals>

Hitoallaj, A.
 ❖ Botimet shkencore të Akademisë së Sigurisë, kontribut i qenësishëm akademik në fushën e sigurisë ➤

Policimi dhe siguria
 nr.20, 2020



B O R D E T S H K E N C O R E

BORDET SHKENCORE TË KONFERENCAVE NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE
TË ORGANIZUARA NGA QENDRA E KËRKIMEVE SHKENCORE,
AKADEMIA E SIGURISË, 2015-2020

Bordi shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet **ELEZI**, Kriminolog

Anëtarët/Members

Prof. Dr. Mynyr **KONI**, Rektor i Universitetit të Tiranës
Prof. Dr. Dhori **KULE**, Dekan i Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës
Prof. Dr. Irakli **KOCOLLARI**, Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit"
Prof. Dr. Giovanni **ARCUDI**, Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata"
Prof. Dr. Emiliano **GIARDINA**, Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata"
Prof. Asc. Dr. Rauf **DIMNAJ**, Zëvendësministër i Arsimit dhe Sporteve
Prof. Asc. Dr. Bejtush **GASHI**, Pedagog, Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Prof. Asc. Dr. Snezana **MOJOSKA**, Zv. Dekane, Universiteti "St. Kliment Ohridski-Manastir", Fakulteti i Sigurisë, Shkup
Prof. Asc. Dr. Qetsor **ORHAN**, Pedagog, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Frank **HARRIS**, Këshilltar i Engility për "ICITAP" në Shqipëri
Dr. Sandër **LLESHI**, Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave
Dr. Bilbil **MEMAJ**, Rektor/Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
Dr. Xhavit **SHALA**, Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Z. Ismail **SMAKIQI**, Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike
Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Komiteti organizator/Organizational committee

Drejtues i Lartë Dr. Bilbil **MEMAJ**, Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
Drejtues Dr. Xhavit **SHALA**, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO**, Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Prof. Asoc. Dr. Pandeli **TAÇI** - Shef i Sektorit të Botimeve, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Drejtues Mehdi **ÇANGA**, Drejtor i Drejtorisë së Administratës, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Drejtuese Laura **TOTRAKU**, Shefe e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Policisë së Shtetit

Sekretariati dhe koordinimi/secretariat and coordination

Msc. Anisa AGASTRA, (koordinatore e konferencës) Sektori i Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Andi OSMANI, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Redaktor shkencor

Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi Osmani

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë
© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2016

KONFERENCA II SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë"

Bordi shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i bordit/Chair

Prof. Dr. Giovanni **ARCUDI**, Universiteti i Romës "Tor Vergata"

Anëtarët/Members

Prof. Dr. Ismet **ELEZI**, Kriminolog
Prof. Ali **CHADLY**, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Monastir (Tunizi)
Prof. Dr. Irakli **KOCOLLARI**, Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit"
Prof. Dr. Sebastiano **TAFARO**, Universiteti i Barit
Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO**, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Prof. Asc. Rauf **DIMNAJ**, Zëvendësministër i Arsimit dhe Sporteve
Prof. Asc. Ferdinand **ELEZI**, Prokuroria e Apelit Durrës
Prof. Asc. Nikola **DUJOVSKI**, Fakulteti i Sigurisë, Shkup
Prof. Asc. Luan **VELICOTI**, Kolegji Universitar "Luarasi" Tiranë
Dr. Blerim **OLLURI**, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë
Dr. Frenk **HARIS**, MSc, D.Crim.J., University of Portsmouth
Dr. Sandër **LLESHI**, Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave
Dr. Bilbil **MEMAJ**, Rektor/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
Dr. Xhavit **SHALA**, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Artur **BEU**, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Dr. Admir **SINAMATI**, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Tiranë
z. Ismail **SMAKIQI**, Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Kosovë

Komiteti organizator/Organizational committee

Drejtuës i Lartë Dr. Bilbil **MEMAJ**, Drejtori i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
Drejtuës Dr. Xhavit **SHALA**, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Drejtuës Msc. Xhevahir **ÇELOALIAJ**, Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore
Kryekomisar Msc. Bilbil **DERVISHI**, QKSH, Akademia e Sigurisë
Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Redaktor shkencor, Akademia e Sigurisë Tiranë.

Sekretariati dhe koordinimi/secretariat and coordination

Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë Tiranë, (përgjegjës)
Msc. Anisa AGASTRA, Sektori i Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (koordinatore e konferencës)
Andi OSMANI, Sektori i Botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (anëtar)

Redaktor shkencor

Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi Osmani

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë
© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2017

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI
Kriminolog

Anëtarët/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI
Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali

Prof. Dr. Vasilika HYSI
Kriminologe, ligjvënëse

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO
Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI
Rektor i Kolegjit të Lartë Universitar “Akademia Profesionale e Biznesit”

Prof. Dr. Laura TAFARO
Profesor, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI
Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA
Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali

Prof. Dr. Ethem RUKA
Rektor i Kolegjit të Lartë Universitar “Luarasi”

Gen. (ret.) Volker HELBAUER
Kryetar i Këshillit të Kolegjit Universitar ISPE-Kosovë

Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ
Zëvendëseshë i Misionit të Shqipërisë në NATO, Bruksel

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI
Prokuroria e Apelit, Durrës - Anëtar

Dr. Vilma TOMÇO
Drejtoreshë e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Dr. Bilbil MEMAJ
Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Dr. Xhavit SHALA
Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Sandër LLESHI
Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave

Dr. Frank HARRIS
MSc, D. Crim. J., University of Portsmouth

Z. Ismail SMAIQLI
Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

Dr. Albert HITOALIAJ
Redaktor shkencor/Lektor, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetari/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë.

Zëvendëskryetari

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Anëtarët/Members

Prof. Asc. Dr. Sokol SADUSHI, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

Z. Brian THIESSEN, OSCE, Law Enforcement Development Officer Security Cooperation Department

Prof. Asc. Dr. Elton NOTI, Zëvendësrektor, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Znj. Anna MARINELI, Team Leader Project “Countering Serious Crime in the Western Balkans”, Ministria e Brendshme

MSc. Arjan MUÇAJ, Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, Tiranë

Prof. Dr. Laura TAFARO, Profesor, Universiteti i Barit, Itali

MSc. Edlira BEJKO, Drejtore drejtorie në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Magjistër Dr. (Proc.) Armando GURAKUQI, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA, Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali

Dr. Bajram IBRAJ, Ushtrues detyre, Drejtor/Rektor i Kolegjit ISPE

Prof. Asc. Dr. Gaqo TANKU, Lektor, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Dr. Artur BEU, Oficer Kontakti i Policisë së Shtetit, Itali

Z. Giovanni PASQUA, Ekspert afatgjatë për burimet njerëzore pranë Projektit Pameca V.

MSc. Dashamir ÇALI, Shef i sektorit të hetimit të krimeve kompjuterike, departamenti i policisë kriminale në Policinë e Shtetit

MSc. Bilbil DERVISHI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Koordinatorët / Coordination

MSc. Anisa AGASTRA, Koordinatorë e Përgjithshme, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Irvin FANIKO, Koordinator, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

MSc. Qetësor GURRA, Koordinator, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Punimet grafike

MSc. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Realizimi teknik: Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2018

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI
Kriminolog

Anëtarët/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI

Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali.

Prof. Dr. Vasilika HYSI

Kriminologe, ligjvënëse.

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesor, Universiteti i Barit, Itali.

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali.

Prof. Dr. Ethem RUKA

Rektor, Kolegji i Lartë Universitar “Luarasi”.

Prof. Asc. Dr. Odhise KOÇA

Shef Departamenti, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ

Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Rendit e Sigurisë Publike, Ministria e Brendshme.

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI

Prokuroria e Apelit, Durrës, Anëtar.

Dr. Bilbil MEMAJ

Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë.

Dr. Xhavit SHALA

Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Dr. Frank HARRIS, MSc, D. Crim. J.

University of Portsmouth.

Z. Ismail SMAKIQI

Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Dr. Albert HITOALIAJ

Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Dekan i Fakultetit të Sigurisë, Akademia e Kosovës Për Siguri Publike.

Prof. Asc. Dr. Shkëlqim GJEVORI

Drejtor i Institutit të Transporteve.

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetari/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë.

Zëvendëskryetari

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Anëtarët/Members

Prof. Asc. Dr. Elton NOTI

Zëvendësrektor, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Z. Rohan D'SOUZA

Drejtor për Shqipërinë i SHELL, përfaqësues ligjor

Z. Malfor NURI

Drejtor për Shqipërinë i Trans Adriatic Pipeline (TAP)

Dr. Artur BEU

Oficer Kontakti i Policisë së Shtetit në Itali

Msc. Drejtues Mitat TOLA

Drejtori i Policisë Rrugore

Msc. Gazmend BEJTJA

Përfaqësues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Tiranë

Msc. Artur KATUÇI

Kryqi i Kuq Shqiptar

MSc. Bilbil DERVISHI

Akademia e Sigurisë, Tiranë

Msc.Ing. Shkëlqim GRUDA

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, DPSHTRR

Koordinatorët / Coordination

Msc. Anisa AGASTRA

Koordinatore e përgjithshme, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. (proc.) Gjon VORFI

Koordinator, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

MP. Andi OSMANI

Koordinator, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Punimet grafike

MP. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI
Kriminolog

Anëtarë/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI
Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata", Itali.

Prof. Dr. Vasilika HYSI
Kriminologe, ligjvënëse.

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO
Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Prof. Dr. Laura TAFARO
Profesor, Universiteti i Barit, Itali.

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI
Rektore e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA
Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata", Itali.

Prof. Dr. Ethem RUKA
Rektor, Kolegji i Lartë Universitar "Luarasi".

Prof. Dr. Orinda MALLTEZI
Shefe e Departamentit të Shkencave Politike,
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ
Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive
të Rendit e Sigurisë Publike, Ministria e Brendshme.

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI
Prokuroria e Apelit, Durrës, Anëtar.

Dr. Elton QENDRO
Prezenca e OSBE-së Tiranë.

Dr. Bilbil MEMAJ
Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë.

Dr. Xhavit SHALA
Drejtor/Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Dr. Frank HARRIS
University of Portsmouth.

Z. Ismail SMAKIQI
Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Dr. Albert HITOALIAJ
Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetar/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Zëvendëskryetarë

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Elton QENDRO, Prezenca e OSBE-së, Tiranë

Anëtarë/Members

Prof. Asc. Dr. Elton NOTI

Zëvendësrektor, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

MSc. Mehdi ÇANGA

Drejtor i administratës dhe shërbimeve mbështetëse, Akademia e Sigurisë

MSc. Arjan MUÇAJ

Prokuror, Prokuroria e Përgjithshme, Tiranë

MSc. Redian DENGËRI

Drejtor, Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesor, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Asc. Dr. Rezana KONOMI

Dekane e Fakultetit Juridik, Universiteti "Luarasi"

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali.

MSc. Diana MILE

Drejtoreshë e politikave dhe edukimit mjedisor, Bashkia Tiranë.

Dr. Artur BEU

Oficer kontakti i Policisë së Shtetit, në Itali.

MSc. Bilbil DERVISHI

Shefi i sektorit të burimeve njerëzore, Akademia e Sigurisë

Koordinatorët / Coordination

Dr. (proc.) Gjon VORFI, Koordinator i përgjithshëm, QKSH, Akademia e Sigurisë

Dr. (proc.) Anisa HYESANI, Koordinatore, QKSH, Akademia e Sigurisë

MSc. Anisa AGASTRA, Koordinatore, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MSc. Qetësor GURRA, Koordinator, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MP. Andi OSMANI, Koordinator, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Punimet grafike

MP. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Realizimi teknik: Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2020

KONFERENCA SHKENCORE KOMBËTARE "Depresioni dhe Vetëvrasja"

Bordi shkencor i konferencës

Kryetar i bordit

Dr. Bilbil **MEMAJ**, Rektori/Drejtori i Akademisë së Sigurisë

Bordi

Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO**, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, anëtar.
Dr. Frank **HARRIS**, MSc, D.Crim.J., University of Portsmouth, anëtar.
Prof. Asc. Dr. Bejtush **GASHI**, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, anëtar.
Prof. Asc. Dr. Pandeli **TAÇI**, QKSHN, Akademia e Sigurisë, anëtar.
Prof. Asc. Zihni **SULAJ**, Shërbimi i Toksikologjisë Klinike, QSUT, anëtar.
Dr. Bledi **CEKA**, Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, anëtar.
Dr. Xhavit **SHALA**, QKSHN, Akademia e Sigurisë, anëtar.
Dr. Alban **YLLI**, Instituti i Shëndetit Publik, anëtar.
Dr. Admir **SINAMATI**, Instituti i Mjekësisë Ligjore, anëtar.
Dr. Irvin **FANIKO**, QKSHN, Akademia e Sigurisë, anëtar.
Msc. Gazmend **BEJTJA**, Organizata Botërore e Shëndetësisë, anëtar.
Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ**, QKSHN, Akademia e Sigurisë, anëtar.

Komiteti organizator

Dr. Bilbil **MEMAJ** - Rektori/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë.
Dr. Xhavit **SHALA** - Drejtori i QKSHN, Akademia e Sigurisë, Tiranë.
Dr. Alban **YLLI** - Instituti i Shëndetit Publik.
Msc. Gazmend **BEJTJA** - Organizata Botërore e Shëndetësisë.
Msc. Bilbil **DERVISHI** - QKSHN, Akademia e Sigurisë.

Sekretariati dhe koordinimi

Msc. Anisa AGASTRA, (koordinatore e konferencës) Sektori i Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr.(proc.) Albert HITOALIAJ, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Andi OSMANI, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Redaktor Shkencor

Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

KONFERENCA II SHKENCORE KOMBËTARE

"Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare"

Bordi shkencor i konferencës

Prof. Dr. Ismet	ELEZI , kriminolog, kryetar i bordit.
Prof. Dr. Irakli	KOÇOLLARI , Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit", anëtar.
Dr. Bilbil	MEMAJ , Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë, anëtar.
Prof. Dr. Ilirjan	MANDRO , Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, AS, anëtar.
Prof. Asc. Ferdinand	ELEZI , Prokuroria e Apelit, Durrës, anëtar.
Dr. Xhavit	SHALA , Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë, anëtar.
Prof. Asc. Dr. Stavri	SINJARI , Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë, anëtar.
Dr. Bledi	CEKA , Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, anëtar.
Dr. Sandër	LLESHI , Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave, anëtar.
Dr. Frank	HARRIS , MSc, D.Crim. J., University of Portsmouth, anëtar.
Av. Sajmir	VISHAJ , Kryetar i Avokatëve Penalistë Shqiptarë, anëtar.
Dr.(proc.) Albert	HITOALIAJ - QKSH, Akademia e Sigurisë, anëtar.

Komiteti organizator

Dr. Bilbil	MEMAJ , Rektori/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë.
Dr. Xhavit	SHALA , Drejtori i QKSHN, Akademia e Sigurisë, Tiranë.
MSc. Bilbil	DERVISHI , QKSHN, Akademia e Sigurisë.

Sekretariati dhe koordinimi

MSc. Anisa AGASTRA, (koordinatore e konferencës) Sektori i Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Redaktor Shkencor

Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Bibliografi e shkrimeve të botuara në revistën “Policimi dhe siguria”, gjatë viteve 2015-2020



Dr. Albert HITOALIAJ

Shefi i sektorit të botimeve,
Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë
albert.hitoaliaj@asp.gov.al

Abstrakt

Ndërtimi i bibliografive të karakterit kombëtar apo ndërkombëtar, për fusha të ndryshme, lloje të ndryshme botimesh dhe tipa të ndryshëm shkruarësish, është një pasuri e veçantë. Këto bibliografi mund të përgatiten nga biblioteka, institute ose qendra kërkimore shkencore, institucione të arsimit të lartë apo edhe studiues të ndryshëm. Botime të tilla nuk kanë munguar në Shqipëri. Ato përbëjnë një udhërrëfyes të vyer për çdo studiues që kërkon të informohet lidhur me botimet e një fushe të caktuar. Krahas lehtësisë së dukshme të punës, botime të tilla arrijnë të jenë edhe një dëshmitar besnik i botimeve ndër vite. Një ndër botimet më të rralla të këtij karakteri që flasim, është projekti i realizuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Bibliografia e librit shqip. Dy vëllimet, “Libri shqip 1555-1912” (vëllimi I) i autorit Ramazan Vozga dhe “Bibliografi e librit shqip 1913-1944” (vëllimi II), me autorë Maksim Gjinaj, Margarita Mele dhe Myrvete Elmazi, përbëjnë një ngjarje madhore të botimeve. Këto vëllime përfaqësojnë një informacion bibliografik për librin në gjuhën shqipe, që rrok një periudhë botimesh pothuajse 500 vjeçare, duke u bërë një monument për kulturën shqiptare. Kjo pra, është vlera e botimeve bibliografike.

Në këtë numër jubilar të revistës së njëzetë “Policimi dhe siguria”, po botojmë bibliografinë e 20 numrave të kësaj reviste. Kjo është një përmbledhje bibliografike e të gjitha punimeve shkencore të botuara në revistën “Policimi dhe siguria”, për periudhën 2015-2020. Në këtë përmbledhje jepen edhe botimet e konferencave, të cilat janë pajisura me kodin ISBN krahas kodit ISSN të revistës. Shpresojmë që në të ardhmen kjo bibliografi të pasurohet e të zgjerohet duke marrë trajtën e një botimi bibliografik që të përmbledhë të gjithë punimet shkencore, studimet e monografite që janë bërë në fushën e sigurisë publike e që trajtojnë aktivitetin e policisë në tërësi. Ky botim do të ishte një kontribut shumë i rëndësishëm për të gjithë komunitetin e kërkimit shkencor të policisë e jo vetëm. Urojmë që kjo bibliografi që botojmë të gjejë të nesërmen vend në një botim të tillë gjithëpërfshirës.

Hitoaliaj, A.
« Bibliografi
e shkrimeve
të botuara
në revistën
“Policimi
dhe siguria”,
gjatë viteve
2015-2020 »

Fjalëkyçe:

revistë shkencore, botime, “Policimi dhe siguria”, botime për sigurinë, Policia e Shtetit, bibliografi.

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

Policimi dhe siguria nr. 1 (dhjetor 2015), 142 faqe, 10 autorë.

1. Haki Çako,

“Fjalë përshëndetëse për fillimin e botimit të revistës ‘Policimi dhe siguria’”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 9.

2. Bilbil Memaj,

“Lidershipi policor”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 10-19.

3. Ilir Mandro,

“Histori dhe progres në arsimimin policor - progres drejt një policie evropiane”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 20-38.

4. Pandeli Taçi,

“Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe rigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 39-51.

5. Qetësor Orhani,

“Shoqëria civile dhe Policia e Shtetit”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 52-61.

6. Xhavit Shala,

“Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 62-75.

7. Mimoza Xharo,

“Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 76-95.

8. Sofokli Duka, Stavri Sinjari,

“Hetimi i vetëvrasjes”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 96-107.

9. Myzafer Elezi,

“Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efencë në luftën

Hitoallaj, A.

« Bibliografi e shkrimeve të botuara në revistën “Policimi dhe siguria”, gjatë viteve 2015-2020 »

Policimi
dhe
siguria
nr.20, 2020

kundër krimit”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 108-117.

10. Pëllumb Nako,

“Migracioni i parregullt si sfidë ndërmjet humanizmit dhe sigurisë Kombëtare”, *Policimi dhe siguria* nr. 1 (dhjetor 2015): 118-130.

Policimi dhe siguria nr. 2 (prill 2016), 170 faqe, 14 autorë.

11. Stavri Sinjari, Sofokli Duka (post mortem),

“August Uollmer – ‘babai’ i policisë moderne amerikane”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 8-19.

12. Vladimir Ikonomi,

“Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 20-29.

13. Ilo Këçka,

“Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA –s”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 30-35.

14. Ruzhdi Kuçi,

“Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 36-43.

15. Adriatik Duqi,

“Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dh Akademia e Sigurisë”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 44-53.

16. Qetësor Gurra,

“Krimi kibernetik, efektet e sigurisë dhe strategjitë kundër tij”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 54-68.

17. Anisa Agastra,

“Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit, parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 69-79.

18. Ilia Nasi,

“Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 80-93.

19. Tonin Vocaj,

“Hetimi i krimeve kundër jetës”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 94-111.

20. Arben Ibro, Bora Selmani,

“Menaxhimi i policisë pas viteve ‘90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe rritjen e sigurisë publike”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 112-128.

21. Zihni Goxhaj,

“Inteligenca dhe balanca midis lirisë dhe sigurisë”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 129-139.

22. Artur Beu,

“Policimi në komunitet dhe terrorizmi”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 140-151.

23. Fran Kaçorri,

“Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 152-159.

24. Pandeli Taçi,

“In memoriam Sofo Duka”, *Policimi dhe siguria* nr. 2 (prill 2016): 168-170.

Policimi dhe siguria nr. 3 (gusht 2016), 114 faqe, 8 autorë.

25. Rauf Dimraj, Ervin Pepi,

“Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 8-19.

26. Bilbil Memaj, Adriatik Duqi,

“Siguria dhe antiterrorizmi”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 20-29.

27. Nikoll Rica,

“Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 30-41.

28. Pandeli Taçi, Jashar Vreka,

“Sfidat e migracionit dhe veprat penale që zhvillohen me këtë fenomen”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 42-53.

29. Arjan Muça,

“Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 54-69.

30. Edmond Braneshi,

“Kultura e organizatës dhe lidhshipi”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 70-80.

31. Adriatik Ago,

“Policia Gjyqësore të bëhet pjesë e reformës në drejtësi”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 80-87.

32. Lutfi Minxhozi,

“Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit”, *Policimi dhe siguria* nr. 3 (gusht 2016): 88-107.

Policimi dhe siguria nr. 4 (nëntor 2016), 390 faqe, 32 autorë.

Konferenca I shkencore ndërkombëtare: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit, red. Albert Hitoaliaj (Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016).

33. Bilbil Memaj,

